



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 274 Akti

Nr. 334 Vendimi  
Tiranë, më 14.1.2021

### V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

|                      |           |
|----------------------|-----------|
| <b>Xhensila Pine</b> | Kryesuese |
| <b>Etleda Çiftja</b> | Relatore  |
| <b>Pamela Qirko</b>  | Anëtare   |

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në datën 12.1.2021, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Arben Allajbeu**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë, të Aneksit të Kushtetutës;**

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

### **TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, z. Arben Allajbeu, dhe pasi

shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, i cili në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I. RRETHANAT PROCEDURALE

1. Z. Arben Allajbeu është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në momentin e shortimit, bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, ‘Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar” dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016).

2. Z. Arben Allajbeu, bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit duke u shortuar në datën 15.1.2019, me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët: Xhensila Pine, Etleda Çiftja dhe Pamela Qirko.

3. Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31–33 të ligjit nr. 84/2016, nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), sipas neneve 34 – 39 të ligjit nr. 84/2016, si dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP), sipas neneve 40 – 44 të ligjit nr. 84/2016.

4. Trupi gjykues i shortuar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni) me vendimin nr. 1, datë 22.1.2019, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thellë dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesues të trupit gjykues, komisioneren Xhensila Pine. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

5. Në datën 14.10.2019, me anë të postës elektronike<sup>1</sup>, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) fillimin e procesit të rivlerësimit; (ii) anëtarët e trupit gjykues të shortuar për të zhvilluar procesin e rivlerësimit; (iii) deklarin nëse ishte në kushtet e konfliktit të interesit me ndonjë nga anëtarët e trupit gjykues; si dhe (iv) përgjigjet e pyetjeve të pyetësorit standard, me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave, që kanë lidhje me procedurat e rivlerësimit.

6. Trupi gjykues, me vendimin nr. 2, në datën 17.11.2020, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Arben Allajbeu, bazuar në relatimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitur nga relatori i çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit se i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit, referuar nenit 52 të ligjit nr. 84/2016; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 45 – 47 dhe 35 – 40, të Kodit të

---

<sup>1</sup> E-mail datë 14.10.2019, ora 2:14, “Komisioni – njoftim për fillimin e procesit të rivlerësimit dhe kërkesë për informacion shtesë”.

Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji në lidhje me deklarin e konfliktit të interesit, me të drejtën për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si dhe me afatin brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta.

7. Në datën 17.11.2020, përmes postës elektronike<sup>2</sup>, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe të sjellë prova për të provuar të kundërtën, brenda datës 30.11.2020; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 45 – 47 dhe 35 – 40, të Kodit të Procedurave Administrative. Subjekti i rivlerësimit nuk u paraqit për t'u njohur me dosjen e hetimit.

8. Në datën 18.11.2020, subjekti i rivlerësimit, përmes postës elektronike, kërkoi kohë shtesë për të paraqitur shpjegimet dhe provat në mbështetje të barrës së provës, kaluar me relacionin mbi rezultatet e hetimit kryesisht, pra, më shumë kohë se data e përcaktuar më 30.11.2020, për arsye shëndetësore. Komisioni, bazuar në kërkesën e subjektit të rivlerësimit, i dha 14 ditë shtesë për dërgimin e rezultateve të hetimit, deri më 14.12.2020.

9. Në datën 11.12.2020, subjekti i rivlerësimit, me anë të postës elektronike, paraqiti raport të paaftësisë së përkohshme në punë, lëshuar nga Qendra Shëndetësore Nr. \*\*\*, me nr. regjistri \*\*\*, në të cilin i jepej pushim nga data 9 dhjetor – 23 dhjetor. Bazuar në këtë raport të paraqitur nga subjekti, Komisioni njoftoi<sup>3</sup> subjektin se mund të sillte shpjegimet e tij në përgjigje të barrës së provës në datën 28.12.2020.

10. Në datën 28.12.2020, subjekti i rivlerësimit, përmes postës elektronike<sup>4</sup>, paraqiti shpjegimet kaluar me relacionin mbi rezultatet e hetimit kryesisht, bashkë me prova të reja në mbështetje të barrës së provës.

11. Në vendimin nr. 3, datë 7.1.2021, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Arben Allajbeu, në seancë dëgjimore në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit u njoftua përmes postës elektronike se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 12.1.2021, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, kati 0, Tiranë.

12. Bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Arben Allajbeu, bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës, si dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

13. Në datën 12.1.2021, ora 10:00, u zhvillua seanca dëgjimore në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

14. Subjekti i rivlerësimit nuk ishte i pranishëm në seancë dhe u përfaqësua nga av. A.S., përfaqësuese me prokurën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 11.1.2021, lëshuar nga z. Arben Allajbeu, para noterit publik I.L I.

<sup>2</sup> E-mail, datë 17.11.2020, ora 2:30, "Komisioni – njoftim mbi përfundimin e hetimit kryesisht për procesin e rivlerësimit".

<sup>3</sup> E-mail datë 11.12.2020, ora 8:41 subjekti përcjell raportin për paaftësi në punë dhe Komisioni me e-mail datë 11.12.2020 , ora 13:41 njoftoi subjektin për afatin e shtyrjes së përgjigjeve të rezultateve të hetimit.

<sup>4</sup> E-mail datë 28.12.2020, "Relacioni përfundimtar dhe përgjigjet për subjektin e rivlerësimit, z. Arben Allajbeu".

15. Relatori i çështjes paraqiti rezultatet e arritura nga Komisioni përgjatë fazës së hetimit administrativ, të kryer mbi të tria kriteret e rivlerësimit dhe të kaluara si barrë prove apo për shpjegime.

16. Përfaqësuesi ligjor i subjektit, av. A.S., shprehu qëndrimin e saj pasi dëgjoji relacionin, duke parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj subjektit.

17. Në seancën dëgjimore të datës 12.1.2021, përfaqësuesja ligjore e subjektit të rivlerësimit, av. A.S., kërkoi konfirmimin në detyrë. Seanca për pretendimin e subjektit u ndërpre për të rifilluar në datën 14.1.2021.

18. Në përfundim të seancës së datës 14.1.2020, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues, në prani të përfaqësuesit ligjor, av. A.S., vendosi ta konsiderojë të përfunduar procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Arben Allajbeu, si dhe shpalli vendimin e trupit gjykues.

### **III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

19. Subjekti i rivlerësimit, z. Arben Allajbeu, ka qenë bashkëpunues gjatë procesit në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

### **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

20. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” sipas kreut IV, V dhe VI të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”: (i) ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror; (ii) DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit; (iii) KLP-ja është organi përkatës i vlerësimit profesional, i cili përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pasi përfundon shqyrtimi i dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe përzgjedhja e pesë dokumenteve sipas një sistemi objektiv dhe rastësor.

21. Referuar vendimit nr. 2/2017<sup>5</sup> të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli

---

<sup>5</sup> Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5, të nenit 179/b, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2, të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016,

dhe rivlerësimi, i cili nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

## **A. RIVLERËSIMI I PASURISË**

### **A/1 Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja**

22. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Arben Allajbeu, e cila është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2004 për herë të parë (me funksion Oficer i Policisë Gjyqësore), më tej nuk ka qenë subjekt deklarues, duke rifilluar deklarinin në vitin 2014 (vit kur është dekretuar si prokuror) dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarinin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

23. Subjekti ka dorëzuar deklaratat e interesave private për vitet 2004, 2014, 2015 dhe 2016 dhe në datën 25.1.2017, referuar ligjit nr. 84/2016 ka dorëzuar deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar, *Vetting*. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja, për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personave të lidhur, është konstatuar:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor për burimin e pasurive në pronësi dhe në përdorim nga subjekti;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarinin të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

### **A/2 Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni**

24. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, *Vetting*, të vitit 2017; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratat vjetore të deklarimit të pasurisë në ILDKPKI për vitet 2004, 2014, 2015, 2016, 2017 dhe 2018; (ç) provat shkrese/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (d) deklarinimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (dh) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit dhe, në vijim, deri ditën e seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit; (e) deklarinimet e përfaqësueses ligjore me prokurë në seancë dëgjimore.

25. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në

---

rezulton se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar në pikën 5, të nenit 33, ligjit nr. 84/2016.

## **Në lidhje me pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në deklaratën e pasurisë *Vetting* të vitit 2017 nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur**

### **1. Apartament me sip. 64 m<sup>2</sup>, në Durrës, në vlerën 15.000 euro**

**1.1. Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se zotëron apartament banimi 1+1, me sip. 64 m<sup>2</sup>, lagjja nr. \*\*\*, Durrës. Vlera: 15.000 euro (kontratë sipërmarrjeje nr. \*\*\*, datë 12.9.2007). Pjesa takuese: 50%.**

**1.2. Si burim krijimi subjekti deklaron kredinë në “Alpha Bank” në shumën 15.000 euro, sipas kontratës së huas nr. \*\*\*, datë 17.10.2007.**

**1.3. Subjekti, për vërtetimin e deklarimeve të tij, ka paraqitur dokumentacion ligjor provues<sup>6</sup>.**

**1.4. Nga hetimi i Komisionit konstatohet se referuar dokumentacionit të administruar nga ASHK-ja Durrës<sup>7</sup>, kjo pasuri nuk rezulton e regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të.**

**1.5. Në deklaratën para fillimit të detyrës, vitit 2014, subjekti ka deklaruar: “... apartament banimi 1+1, me sip. 64 m<sup>2</sup>, lagjja nr. \*\*\*, Durrës (kontratë sipërmarrjeje nr. \*\*\*, datë 12.9.2007). Burimi: kredi pranë ‘Alpha Bank’, në shumën 15.000 euro, sipas kontratës së huas nr. \*\*\*, datë 17.10.2017. Pjesa takuese: 50%”.**

**1.6. Sipas dokumentacionit të dorëzuar në deklaratën *Vetting*, rezulton se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e palës blerëse, ka nënshkruar kontratën e sipërmarrjes nr. \*\*\*, datë 12.9.2007, me shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k., për blerjen e apartamentit me sipërfaqe totale 64 m<sup>2</sup>, të ndodhur në lagjen \*\*\*, Plazh, Durrës, në shumën 15.000 euro, vlerë e cila është likuiduar tërësisht nga porositësi.**

**1.7. Për të vërtetuar burimin e krijimit, subjekti ka paraqitur kontratën e huas nr. \*\*\*, datë 17.10.2007, shtesën e kontratës për kufi kredie shumë qëllimore nr. \*\*\*, datë 17.10.2007, nënshkruar ndërmjet “Alpha Bank”, palës kredimarrëse Arben Allajbeu dhe E.A., dorëzanës B.A., dhe Sh.A. Këta të fundit kanë nënshkruar kontratën e hipotekimit nr. \*\*\*<sup>8</sup>, datë 17.10.2007, me objekt hipotekimi pasurinë e regjistruar në ZVRPP-në Berat në regjistrin hipotekor me vol. \*\*\*, f. \*\*\*, datë 24.2.1998, nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*. Në pikën 2.1 të kontratës kjo pronë është përshkruar si truall+ndërtesë, me sipërfaqe totale trualli prej 131 m<sup>2</sup>, si dhe ndërtesa dykatëshe me sipërfaqe totale ndërtimore prej 90 m<sup>2</sup>, e ndodhur në lagjen “\*\*\*”, Berat.**

<sup>6</sup> Kontratë sipërmarrjeje nr. \*\*\*, datë 12.9.2007, kontratë huaje nr. \*\*\*, datë 17.10.2007, shtesë e kontratës për kufi kredie shumëqëllimore nr. \*\*\*, datë 17.10.2007.

<sup>7</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 3.12.2019.

<sup>8</sup>Vënë në dispozicion nga “Alpha Bank”, shkresë nr. \*\*\*, datë 2.7.2020.

**1.8.** Referuar kontratës së huas, “Alpha Bank” ka çelur në favor të kredimarrësit një kufi kredie në vlerën 18.300 euro. Nga ky kufi kredie është përdorur shuma 15.000 euro me qëllim blerje dhe rikonstruksion të apartamentit të ndodhur në zonën Plazh, Durrës, sipas kontratës shtesë nr. \*\*\*, datë 17.10.2007. Me anë të kësaj kontrate, palët bien dakord që një pjesë e kufirit të kredisë do të përdoret si hua për financim të kredimarrësit. Banka jep hua me afat të mesëm në shumën 15.000 euro, me afat 10 vjet.

**1.9.** Në kontratën e huas nr. \*\*\*, datë 17.10.2007, shtesë e kontratës për kufi kredie shumë qëllimore nr. \*\*\*, datë 17.10.2007, në pikën 1.1, shprehet se kufiri i kredisë mund të përdoret tërësisht ose pjesërisht për nevoja të kredimarrësit për hua, avanca, garanci, dorëzani etj. Ndërsa në pikën 1.2 shprehet se nga kufiri i kredisë është përdorur shuma prej 15.000 euro për blerje dhe rikonstruksion të apartamentit të ndodhur në zonën Plazh Durrës. Më tej, në pikën 2 shprehet se kredimarrësi ka paraqitur në bankë projektin e blerjes dhe rikonstruksionit të apartamentit të ndodhur në zonën Plazh, Durrës, projekti ka një kosto të përgjithshme në vlerën 20.000 euro dhe se kontributi i kredimarrësit në financimin e projektit është në vlerën 5.000 euro.

### **Lidhur me burimin e krijimit**

**1.10.** “Alpha Bank” konfirmon kredi në emër të z. Arben Allajbeu dhe detyrim në vlerën euro. Komisioni vëren se kjo kredi është marrë rreth një muaj më vonë (datë 17.10.2007) se kontrata e sipërmarrjes dhe nuk mund të ketë shërbyer si burim për apartamentin duke qenë se sipas kontratës vlera është likuiduar tërësisht në momentin e nënshkrimit (datë 12.9.2007). Me anë të pyetësorit nr. 2<sup>9</sup>, subjekti është pyetur për sa konstatohet edhe lidhur me mënyrën e pagesës së apartamentit.

**1.11.** Në përgjigje<sup>10</sup>, subjekti deklaron se procedurat e kredisë i ka filluar në fillim të shtatorit të vitit 2007, kjo provohet edhe në dokumentet e depozituara në dosjen e kredisë në “Alpha Bank”. Për efekt kohe dhe i nxitur nga kërkesa e shitësit për përmbylljen e marrëveshjes ka gjetur zgjidhje në datën 5.9.2007, duke e siguruar vlerën prej 15.000 euro nëpërmjet z. E.K., (mik dhe fqinjit të tij). Në këtë mënyrë ka mundur të paguajë shitësin dhe të lidhë me të kontratën e sipërmarrjes para noterit në datën 12.9.2007. Gjatë procedurës për marrjen e kredisë, subjektit i është kërkuar nga specialisti i kredisë ta formalizojë marrëdhënien me shtetasin E.K., veprim të cilin e ka kryer para noterit, nëpërmjet një deklarate noteriale në datën 5.10.2007<sup>11</sup>. Pas miratimit të kredisë është tërhequr shuma e kredituar dhe i është kthyer shtetasit E.K., duke iu përmbajtur kështu marrëveshjes së formalizuar në deklaratën noteriale. Subjekti shprehet se ky veprim nuk është pasqyruar në deklaratimet e kryera në ILDKPKI, pasi në atë periudhën nuk ka qenë subjekt i ligjit për deklarimin e pasurisë. Subjekti, më tej, deklaron se me shtetasin E.K., nuk ka konflikt interesi dhe gjatë ushtrimit të detyrës nuk ka trajtuar asnjë çështje me palë këtë shtetas.

**1.12.** Në dokumentacionin e përcjellë nga “Alpha Bank”<sup>12</sup> konstatohet se kredia në shumën 15.000 euro është disbursuar më 18.10.2007 dhe në të njëjtën datë subjekti ka transferuar

<sup>9</sup> E-mail datë 28.1.2020, ora 16:41.

<sup>10</sup> E-mail datë 31.1.2020, ora 14:42.

<sup>11</sup> Nr. \*\*\* rep. (pa nr. kol).

<sup>12</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 2.7.2020.

shumën 14.810 euro<sup>13</sup> në favor të shtetasit E.K., me përshkrim “kalim nga Arben Allajbeu për E., kthim borxhi”.

**1.13.** Me anë të pyetësorit nr. 2, Komisioni, më tej, e ka pyetur subjektin lidhur me faktin e negociimit të çmimit preferencial prej 234 euro/m<sup>2</sup> dhe nëse ka pasur ndonjë lidhje me shoqërinë porositëse “\*\*\*\*” sh.p.k. apo administratorin/aksionerin (ët) e saj përveç blerjes së këtij apartamenti.

**1.14.** Në përgjigje, subjekti deklaroi se përveç faktit që kjo banesë është reklamuar si një rast okazion, në çmimin e blerjes së apartamentit është marrë në konsideratë vendndodhja jo shumë e favorshme, në një pozicion jo të preferuar, larg detit, në krahun e kundërt të rrugës së plazhit. Apartamenti ndodhet në katin e parë të pallatit, seksioni II, sistem dhomë-paradhomë dhe pagesa për blerjen e tij është rënë dakord që do të kryhej njëherësh, ndërkohë që objekti ishte në ndërtim e sipër (është marrë në dorëzim në dhjetor të vitit 2010). Apartamenti, në momentin e blerjes, nuk ka qenë i hipotekuar dhe aktualisht gjendet në po të njëjtën situatë. Të gjithë faktorët e renditur më sipër, si dhe raporti kërkesë - ofertë në periudhën e blerjes kanë ndikuar në çmimin e apartamentit. Subjekti shprehet se nuk ka asnjë njohje dhe marrëdhënie me administratorin apo shoqërinë deri në momentin që ka treguar interes për blerjen e këtij apartamenti, duke mos pasur kështu asnjë konflikt interesi.

**1.15.** Në pyetësin standard, subjekti deklaroi se nuk ka pasur shpenzime për mobilimin e apartamentit. Me anë të pyetësorit nr. 2, subjekti u pyet përsëri lidhur me këtë fakt dhe deklaroi se nuk ka shpenzuar për mobilim pasi ky apartament nuk është përdorur për banim. Sipas subjektit, në këtë apartament nuk është banuar dhe nuk është përfituar apo marrë asnjë kompensim. Në pyetësin nr. 3<sup>14</sup>, subjekti u pyet lidhur me qëllimin e blerjes së apartamentit duke qenë se nuk e ka mobiluar, përdorur dhe nuk ka pasur asnjë përfitim apo kompensim. Gjithashtu, subjektit iu kërkua të paraqesë dokumentacion justifikues ligjor në lidhje me të ardhurat e ligjshme të shtetasit E.K., numrin e personave të përbërjes familjare, si dhe shpenzimet e kryera për jetesë apo dhe të tjera, nëse ka investuar në pasuri (të luajtshme, të paluajtshme, llogari bankare etj.), me qëllim përlllogaritjen e mundësisë së këtij shtetasi për të dhënë hua.

**1.16.** Nga hetimi i Komisionit<sup>15</sup> nuk u provua qenia e subjektit të rivlerësimit në kushtet e konfliktit të interesit<sup>16</sup> me shitësit/ndërtuesit e këtij apartamenti.

**1.17.** Në përgjigje<sup>17</sup> subjekti deklaroi se kjo banesë është vlerësuar si një rast okazion, si dhe një mundësi për të kursyer dhe pasur një shtëpi pushimi. Qëllimi ka qenë përdorimi i saj nga prindërit pas daljes në pension, por aktualisht ata, edhe pse kanë dalë në pension, vazhdojnë të jenë në marrëdhënie pune private në Berat.

**1.18.** Subjekti paraqiti certifikatën familjare të shtetasit E.K., datë 8.7.2020; deklaratën noteriale, datë 5.10.2007; si dhe kopje të pasaportave të shtetasve E., dhe R.K.

---

<sup>13</sup> Shuma 190 euro është mbajtur për shpenzime për kredinë.

<sup>14</sup> E-mail datë 6.7.2020, ora 10:26.

<sup>15</sup> Shkresë nr. \*\*\*, datë 21.9.2020 dhe shkresa nr. \*\*\*, datë 21.9.2020.

<sup>16</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 22.9.2020 dhe shkresa nr. \*\*\* prot., datë 12.10.2020.

<sup>17</sup> E-mail datë 15.7.2020, ora 10:47.



**1.19.** Gjithashtu, subjekti ka dorëzuar dy vërtetime nga Sigurimet Shoqërore lidhur me të ardhurat e shtetasve R., dhe Z.K., për periudhën 1994 – 2005, ku rezulton se këta shtetas kanë pasur të ardhura në shumën totale 4.046.711 lekë. Për të njëjtën periudhë, Komisioni përlloraritë shpenzime jetese në shumën 3.149.109 lekë<sup>18</sup> dhe, për rrjedhojë, diferenca e mundshme për kursim rezulton në vlerën 897.602 lekë. Subjekti nuk ka dorëzuar dokumentacion ligjor justifikues për të ardhurat e përfituara në SHBA nga shtetasit R., dhe Z.K.

**1.20. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës,** Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se *personi tjetër i lidhur, z. E.K., nuk ka pasur të ardhura financiare të mjaftueshme për të dhënë huan në shumën prej 15.000 euro në vitin 2007.*

**1.21.** Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet dhe provat me shkrim dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës, deklaroi se: *“Referuar edhe hetimit të kryer nga Komisioni, konstatohet se kam lidhur kontratë sipërmarrjeje nr. \*\*\*, me shoqërinë ‘\*\*\*’ sh.p.k. në datën 12.9.2007, për blerjen e një apartamenti banimi me sip. totale 64 m<sup>2</sup> kundrejt çmimit 15.000 euro. Ndërkohë, procedurat e marrjes së kredisë i kam nisur që në fillim të muajit shtator 2007. Disbursimi i kredisë është në të njëjtën ditë me kthimin e huas. Familja K., ka emigruar në SHBA. Vetë shtetasi E.K., ka deklaruar me deklaratën noteriale të datës 13.7.2020 se shuma prej 15.000 euro e dhënë hua ka si burim kursimet e familjarëve të tij nga puna në Shqipëri dhe emigracioni në SHBA”.*

#### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**1.22.** Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

**1.23.** Pretendimi i subjektit, se pavarësisht përpjekjeve që ka bërë nuk ka mundur të sigurojë dokumentacion shtesë për shkak të emigrimit të familjes K., në SHBA dhe se ai nuk legjitimohet si palë për të kërkuar mbi depozitat, interesat e marra apo për të ardhurat që familja K., ka pasur në atë kohë në Shqipëri, nuk qëndron pasi subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti dokumentacion për të provuar këto përpjekje të tij.

**1.24.** Në lidhje me pretendimin se deklarata noteriale e datës 13.7.2020, e lëshuar nga huadhënësi E.K., duhet të jetë e mjaftueshme për të provuar burimin e krijimit, Komisioni vlerëson se kjo deklaratë nuk ka efekt provues në këtë proces, pasi është kryer gjatë procesit të rivlerësimit, çka të krijon bindjen se është konceptuar në favor të deklaratimeve të subjektit të

---

<sup>18</sup> Shpenzimet jetike u përlloraritën: (1) 66% të të ardhurave për periudhën 1994-1999; (2) bazuar në shkresën nr. \*\*\*, datë 4.3.2019, nga ILDKPKI-ja për periudhën 2000-2005.

rivlerësimit dhe se nuk mbështetet nga provat e tjera të administruara në procesin e rivlerësimit, si rrjedhojë nuk mund të ketë vlerë provuese bindëse.

**1.25.** Sipas pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016: “[...] *Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive. [...]*”. Referuar në këtë nen, subjekti i rivlerësimit ka detyrimin ligjor për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj shume të dhënë hua.

**1.26.** Nga hetimi, Komisioni vëren se personi tjetër i lidhur nuk ka pasur mjaftueshëm të ardhura për të dhënë 15.000 euro në datën që pretendon subjekti i rivlerësimit, bazuar në të dhënat e vëna në dispozicion nga subjekti.

**1.27.** Më tej, subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar huan nga shtetasi E.K., si burim për krijimin e kësaj pasurie në deklaratën *Vetting*, çka e bën deklarinimin jo të saktë dhe në kundërshtim me udhëzimin nr. 4095/2016, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, pika 7, sipas të cilit: “... për çdo pasuri në pronësi të paluajtshme, të luajtshme, likuiditete, vlerën e aksioneve, letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim etj., subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, duhet të deklarojë burimin, në momentin e krijimit për secilën prej tyre, duke bashkëlidhur dokumentacionin ligjor për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit për secilën pasuri në momentin e fitimit të tyre”.

**1.28.** Në këto kushte, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e krijimit të pagesës së kryer në lidhje me këtë apartament duke mos deklaruar saktë burimin e krijimit në deklaratën *Vetting*. Gjithsesi, edhe po të merret në konsideratë burimi i deklaruar nga subjekti gjatë hetimit administrativ, huaja nga shtetasi E.K., personi tjetër i lidhur rezulton se ky i fundit ka mungesë financiare nga burime të ligjshme për t’i dhënë hua subjektit shumën prej 15.000 euro në kohën e blerjes së këtij apartamenti në datën 12.9.2007.

**1.29. Si përfundim,** Komisioni konkludon se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklarinimit të pasaktë të burimit të krijimit të kësaj pasurie në deklaratën *Vetting* 2017, brenda parashikimeve të germës “a”, të pikës 5, të nenit 33 dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për blerjen e këtij apartamenti në datën 12.9.2007, duke u gjendur brenda parashikimeve të germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

## **2. Huadhënie motrës A.P., në vlerën 10.000 euro**

**2.1. Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017,** subjekti i rivlerësimit deklaroi: “... *huadhënie motrës sime A.P., pa interes dhe pa afat, me marrëveshje verbale, në shumën 10.000 euro. Pjesa takuese: 50%*”.

**2.2.** Si burim krijimi, subjekti deklaroi: kursime nga paga.

**2.3.** Subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor lidhur me huadhënien në vlerë 10.000 euro, me anë të të cilit shtetasja A.P., të mund të konfirmonte këtë marrëdhënie.

**2.4. Nga hetimi i Komisionit konstatohet se në DPV-në e vitit 2014,** subjekti ka deklaruar: “*Huadhënie motrës sime A.P., pa interes dhe pa afat me marrëveshje verbale, shuma 10.000 euro. Burimi: tërheqje nga depozita pranë BKT-së*”.

**2.5.** Subjekti, në shpjegimet e dhëna në ILDKPKI, në datën 17.3.2016, ka deklaruar se në vitin 2014, vlerën prej 10.000 euro ia ka dhënë hua motrës A.P., pa afat dhe pa interes për arsye të nevojave familjare (këtë fakt e ka deklaruar në DPV-në e vitit 2014). Burimet e krijimit janë të ardhurat nga paga e tij në funksionin e OPGJ-së nga viti 2005 deri më 20.6.2014, kur u është dekretuar si prokuror, si dhe nga paga e bashkëshortes si mësuese në shkollën “M.”, Berat, që nga viti 2002.

**2.6.** Në dokumentacionin e përcjellë nga BKT-ja<sup>19</sup> konstatohet se në datën 7.7.2014 është kryer një depozitim në shumën 10.000 euro me përshkrimin “arkëton në llogari depozite Arben Allajbeu”, shumë e cila është kaluar në depozitë me afat në datën 8.7.2014 dhe është maturuar më 1.9.2014. Kjo depozitë është deklaruar nga subjekti në deklaratën përpara fillimit të detyrës, datë 14.7.2014, dhe për të cilën është deklaruar si burim kursimet nga paga në 13 vjet punë.

**2.7.** Më tej, subjekti ka kryer këto tërheqje: (1) më 1.9.2014 shumën 1.999,29 euro; (2) më 17.9.2014 shumën 4.000 euro; (3) më 24.10.2014 shumën 4.001,42 euro, pra, në total shumën 10.000,71 euro.

**2.8.** Komisioni, lidhur me ligjshmërinë e burimit të krijimit të depozitës prej 10.000 euro, që ka shërbyer si burim për shumën e dhënë hua, kreu analizën financiare për periudhën 1.1.2005 – 14.7.2014.

**2.9. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës,** Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: *Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për dhënien e huas në shumën 10.000 euro, pasi nga analiza financiare për subjektin dhe personat e lidhur për periudhën 1.1.2005 – 14.7.2014, duket se ka mungesë burimesh të ligjshme në vlerën 2.411.610 lekë për blerjen e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve.*

**2.10.** Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet dhe provat me shkrim dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës, deklaroi se:

**2.11.** Për sa i përket moskonfirmimit të marrëdhënies së huas me motrën, subjekti shpjegoi se duke qenë një marrëdhënie motër/vëlla nuk ka vlerësuar se nevojitet një dokument i tillë dhe se gjatë deklarimit të kryer në ILDKPKI nuk i është kërkuar që ta formalizojë këtë marrëdhënie me motrën.

**2.12.** Lidhur me analizën financiare, periudha e marrë në analizë nga Komisioni (vitet 2005 – 2014) është gabim pasi duhej të shtrihej edhe në periudhat e mëhershme. Subjekti ka deklaruar burim krijimi të ardhurat nga viti 2005 dhe në vazhdim, por kjo nuk do të thotë që analiza duhet të shtrihet që nga data 1.1.2005, pasi për shtimin e pasurive të tjera kanë shërbyer edhe kursimet përpara vitit 2005. Në zërin të ardhura nga paga e subjektit duhet të përfshihen të ardhurat e realizuara nga paga e tij nga muaji korrik 2001 deri në dhjetor 2004. Bazuar në dokumentacionin e depozituar në ILDKPKI, shuma e pagave *neto* për këtë periudhë është në vlerën 1.009.119 lekë. Gjithashtu, duhet të përfshihen të ardhurat e realizuara në Njësinë

---

<sup>19</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 28.10.2019.

Administrative \*\*\*, Bashkia Kuçovë, në periudhën 2003 – 2005, në vlerën 71.195 lekë, sipas vërtetimit nr. \*\*\* prot., datë 17.1.2017, depozituar në dosje.

**2.13.** Në observacionet e dorëzuara gjatë seancës dëgjimore, subjekti deklaroi se në deklaratën përpara fillimit të detyrës, i është referuar të ardhurave nga paga e tij dhe e bashkëshortes duke cituar periudhën më të gjatë të punësimit dhe se vetëm mosdeklarimi i detyrës së kryer nga ana e tij përpara vitit 2005 nuk mund të përbëjë shkak për mospërlllogaritjen e të ardhurave përpara kësaj periudhe. Qëllimi i deklaramit ka qenë për të theksuar se burimi janë të ardhurat nga paga dhe në analizën e kryer nga Komisioni paraqiten edhe pasuri të tjera të krijuara gjatë kësaj periudhe që kanë si burim kursimet përpara vitit 2005.

**2.14.** Në zërin të ardhura nga paga e bashkëshortes, duhet të përfshihen të ardhurat nga paga për periudhën tetor 2002 – dhjetor 2004. Bazuar në dokumentacionin e depozituar në ILDKPKI, shuma e pagave *neto* për këtë periudhë është në shumën 408.358 lekë.

**2.15.** Po kështu, subjekti shpjegon se gjatë kohës që ka pasur ekonomi të përbashkët me prindërit, edhe në vijim, në shumë raste pagesat mujore të kredisë për blerjen e apartamentit në Durrës janë përballuar nga prindërit nga të ardhurat e realizuara prej tyre, fakt i cili provohet nga përshkrimi i bërë në statementin bankar. Ashtu sikurse subjekti ka deklaruar edhe në përgjigje të pyetësorit, ky apartament është blerë gjatë kohës që pasur një ekonomi të përbashkët me prindërit dhe një ndër arsyet që është blerë apartamenti ka qenë qëllimi për frekuentimin e tij nga prindërit pas daljes në pension të tyre, pra, një pjesë e konsiderueshme e kredisë që nga çelja deri në vitin 2014 është shlyer edhe nga prindërit.

**2.16.** Në analizën financiare janë konsideruar si shpenzim punime në apartamentin në Durrës në shumën 629.250 lekë ose 5.000 euro. Ky shpenzim ka qenë i preventivuar sipas projektit të blerjes dhe rikonstruksionit të apartamentit në zonën Plazh, Durrës, por nuk është kryer asnjëherë nga ana e tij. Subjekti nuk ka deklaruar as në deklaratën *Vetting*, por as në deklaratat periodike vjetore kryerjen e një zëri të tillë, shpenzime për punimet në këtë apartament. Projekti dhe plani ishte që subjekti do të kryente punime pas blerjes së apartamentit, punime të cilat nuk janë kryer asnjëherë dhe nuk ka pasur asnjë fluks dalës monetar.

**2.17.** Shpenzimet e jetesës sipas ILDKPKI-së, referuar edhe vendimeve që kanë marrë formë të prerë në Komision, nuk duhet të përlllogariten deri sa fëmijët të mbushin 1 vjeç. Për efekt të analizës financiare duhet të përfshihen shpenzimet jetike në vlerën 93,864 lekë/vit sipas shkresës nr. \*\*\* prot., datë 4.3.2019, të ILDKPKI-së, për periudhën tetor 2002 – dhjetor 2004 për bashkëshorten dhe 15 korrik 2001 – 31 dhjetor 2004 për subjektin.

**2.18.** Komisioni duhet të marrë në konsideratë faktin se shpenzimet jetike për një ekonomi të përbashkët familjare dhe për rrethin e Beratit paraqiten më të larta nga ato që kanë qenë në fakt. Subjekti kërkon të korrektohet shpenzimi jetik për frymë për vitin 2007 në shumën 235.968 lekë, krahasuar me atë të vitit 2008 në shumën 136.620 lekë.

**2.19.** Në konsideratë të kontestimeve të subjektit, analiza financiare e paraqitur në seancën dëgjimore për periudhën korrik 2001 – 14 korrik 2014, rezulton me një balancë pozitive prej 35.973 lekësh<sup>20</sup>.

---

<sup>20</sup> Referuar analizës financiare të paraqitur nga subjekti në observacionet e dorëzuara në seancë dëgjimore.

**2.20.** Subjekti thekson se balanca është pozitive pavarësisht se në analizë: (i) nuk janë ndryshuar shpenzimet e udhëtimit, të cilat nuk kanë qenë në këtë periudhë në vlerën 1.317.739 lekë, por relativisht më pak; (ii) nuk është zbritur një pjesë e kredisë së shlyer nga prindërit e tij për periudhën 2007 – 2014; (iii) nuk janë marrë në konsideratë dhuratat në të holla për martesë viti 2005 dhe lindje të fëmijëve viti 2006 dhe 2010; (iv) fitimi në vlerën 56.000 lekë, i realizuar nga shitja e automjetit tip “Fiat Punto” me targa \*\*\*.

### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**2.21.** Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*; (ii) raportin e hollësishtëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

**2.22.** Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se në analizën financiare duhen përfshirë pagat e subjektit gjatë periudhës 2001 – 2004, Komisioni thekson se të ardhurat nga pagat e subjektit gjatë vitit 2004<sup>21</sup> janë përfshirë në analizën financiare të vitit 2004, analizë kjo e pasqyruar në paragrafin 10.26 të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht dhe në aneksin 01 – *analiza financiare e detajuar*. Për sa i përket pagave të përfituara nga subjekti gjatë periudhës 2001 – 2003, Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka qenë subjekt i deklaratimit në ILDKPKI në vitin 2004, kohë kur ka filluar punë si Oficer i Policisë Gjyqësore dhe nuk ka deklaruar kursime *cash* nga punësimi i tij, për këtë arsye këto të ardhura nuk janë marrë në konsideratë në analizë financiare, sipas pikës 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, deklaratimet e interesave private dhe pasurore të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni.

**2.23.** Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për të përfshirë të ardhurat e realizuara në Njësinë Administrative \*\*\*, Bashkia Kuçovë, në periudhën 2003 – 2005, në vlerën 71.195 lekë, sipas vërtetimit nr. \*\*\* prot., datë 17.1.2017 depozituar në dosje, Komisioni thekson që këto të ardhura janë të përfshira në analizën financiare, konkretisht shuma 29.648 lekë është përfshirë në të ardhurat e vitit 2004 dhe shuma 18.147 lekë është përfshirë në të ardhurat e periudhës 1.1.2005 – 14.7.2014, ndërsa shuma 23.400 lekë, e cila i përket të ardhurave të vitit 2003 nuk është konsideruar referuar arsyetimit në paragrafin e mësipërm.

**2.24.** Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se në analizën financiare duhen përlllogaritur pagat e bashkëshortes për periudhën tetor 2002 – dhjetor 2004 në shumën 408.358 lekë, Komisioni vlerëson se ky pretendim duhet të merret në konsideratë përderisa bashkëshortja e subjektit është bërë pjesë e familjes në vitin 2005<sup>22</sup>, vit në të cilin subjekti i rivlerësimit nuk kishte detyrimin për deklarimin e pasurisë në ILDKPKI dhe, si rrjedhojë, nuk kishte se si t'i deklaronte kursimet *cash* të bashkëshortes përpara kësaj periudhe. Në vijim, Komisioni përfshiu në analizën financiare të periudhës 1.1.2005 – 14.7.2014 një shumë të

---

<sup>21</sup> Të ardhurat e subjektit nga paga janë paraqitur në shumën 335.000 lekë, bazuar në vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 13.10.2016, të lëshuar nga ISSH (për vitin 2004 në vlerën 305.352 lekë) dhe në vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 13.10.2016, të lëshuar nga Bashkia Kuçovë, nj.adm. \*\*\* (për vitin 2004 në vlerën 29.648 lekë).

<sup>22</sup> Referojuni pyetësorit nr. 3.

ardhurash prej 146.596 lekësh si diferencë midis të ardhurave nga paga në shumën 412.544 lekë<sup>23</sup> për periudhën tetor 2002 – dhjetor 2004 dhe shpenzimeve jetike në shumën 265.948 lekë për të njëjtën periudhë.

**2.25.** Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit mbi shpenzimet jetike për vitin 2007, Komisioni vë në dukje që në aneks 02 – *metodika e analizës financiare* është shpjeguar se shpenzimet jetike janë përlllogaritur bazuar në shkresën nr. \*\*\*<sup>24</sup>, datë 4.3.2019, të ILDKPKI-së me dhe vlera për vitin 2007 është saktësuar sipas shkresës nr. \*\*, datë 27.5.2008, të INSTAT-it, drejtuar ILDKPKI-së (174.072 lekë/vit për person).

**2.26.** Komisioni nuk e mori në konsideratë pretendimin e subjektit për mosllogaritjen e shpenzimeve jetike derisa fëmijët të mbushin 1 vjeç, për sa kohë që në analizën financiare është konsideruar si bazë për përlllogaritjen e shpenzimeve jetike vetëm periudha që nga muaji i lindjes deri në fund të vitit.

**2.27.** Lidhur me pretendimin se shpenzimi i punimeve në apartamentin në Durrës në shumën 629.250 lekë ose 5.000 euro ka qenë i preventivuar sipas projektit të blerjes dhe rikonstruksionit të apartamentit në zonën Plazh, Durrës, por nuk është kryer asnjëherë prej tij, Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit nuk bëri përpjekje për të shpjeguar bindshëm të kundërtën e dokumentacionit të administruar nga “Alpha Bank”<sup>25</sup> në lidhje me këto punime. Më tej, Komisioni vlerëson se ky është një shpenzim i arsyeshëm në kushtet kur çmimi i këtij apartamenti është i ulët duke marrë në konsideratë faktin se kostoja mesatare e ndërtimit për vitin 2007, në Durrës ka qenë 25.141 lekë/m<sup>2</sup> për sipërfaqe ndërtimi<sup>26</sup>.

**2.28.** Lidhur me pretendimin se në shumë raste pagesat mujore të kredisë për blerjen e apartamentit në Durrës janë përballuar nga prindërit e tij nga të ardhurat e realizuara, Komisioni thekson se paraqitja si shpenzim e pagesës së kredisë në analizën financiare të subjektit deri në datën 14.7.2014 është bazuar në faktin që këstet paguhen nga llogaria në emër të subjektit, i cili së bashku dhe bashkëshorten janë në cilësinë e kredimarrësve dhe në pyetësorin standard subjekti ka deklaruar që kjo kredi është shlyer me të ardhurat nga pagat. Nga ana tjetër, Komisioni ka kryer analizën financiare të periudhës 1.1.2005 – 14.7.2014, si për subjektin dhe personat e lidhur, ashtu edhe për prindërit e tij, duke e paraqitur edhe si ekonomi të përbashkët, referuar tabelës në litera (ii) dhe (iii), të paragrafit 10.26 të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht dhe, për pasojë, edhe sikur ky zë shpenzimesh të zbritet nga analiza e subjektit, do t’i shtohet analizës së prindërve. Ndërsa, lidhur me pagesën e kësteve nga babai pas datës 14.7.2014, Komisioni vlerëson që pretendimi i subjektit nuk qëndron, për sa kohë që kryerja e kësaj pagese nuk është deklaruar prej subjektit të rivlerësimit në deklaratën periodike vjetore përkatëse, në rubrikën “dhurata dhe trajtime preferenciale” dhe, për rrjedhojë, zëri i shpenzimit për pagesën e kësteve të kredisë mbeti i pandryshuar në analizën financiare.

<sup>23</sup>Të ardhurat *neto* në këtë vlerë u bazuan në vërtetimin e lëshuar nga ISSH, Drejtoria Rajonale Berat dhe u përlllogaritën duke zbritur nga paga *bruto*: (1) ndalesat për sigurimet të paraqitura në tabelë dhe (2) ndalesat për tatimin mbi të ardhurat të llogaritura sipas legjislacionit në fuqi për secilin vit.

<sup>24</sup> Bashkëlidhur shkresës ndodhet e gjithë korrespondenca zyrtare ndërmjet ILDKPKI-së dhe INSTAT-it.

<sup>25</sup> Në pikën 1.2 të kontratës së huas, parashikohet se nga kufiri i kredisë është përdorur shuma prej 15.000 euro për blerje dhe rikonstruksion të apartamentit të ndodhur në Plazh-Durrës. Më tej, në pikën 2 shprehet se kredimarrësi ka paraqitur në bankë projektin e blerjes dhe rikonstruksionit të apartamentit të ndodhur në Plazh-Durrës, projekti ka një kosto të përgjithshme prej 20.000 euro dhe se kontributi i kredimarrësit në financimin e projektit është 5.000 euro.

<sup>26</sup> Udhëzimi nr. 2 datë 4.4.2007, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave..”.

**2.29.** Pretendimi i subjektit lidhur me shpenzimet e udhëtimit nuk u mor në konsideratë nga Komisioni, pasi subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti asnjë shpjegim specifik apo provë për të vërtetuar këtë pretendim, i cili mbeti në nivel deklarativ. Për këtë arsye, vlera e shpenzimeve të udhëtimeve e pasqyruar në analizën financiare të Komisionit mbetet e pandryshuar.

**2.30.** Lidhur me pretendimin e subjektit për të konsideruar dhuratat në të holla për martesë në vitin 2005 dhe lindje të fëmijëve në vitet 2006 dhe 2010, Komisioni vëren që këto të ardhura nuk janë deklaruar as në deklaratën *Vetting* dhe as gjatë hetimit, por për herë të parë pas kalimit të barrës së provës dhe, për rrjedhojë, nuk mund të konsiderohen në analizën financiare.

**2.31.** Lidhur me pretendimin e subjektit për të konsideruar fitimin nga shitja e automjetit tip “Fiat Punto”, Komisioni nuk i mori në konsideratë sipas arsyetimit në paragrafët 9.22-9.25 të këtij vendimi.

**2.32.** Më tej, Komisioni saktësoi analizën financiare me dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti për blerjen e automjetit me targa \*\*\*, konkretisht me shpenzimet për blerjen e këtij automjeti në shumën 990.000 lekë, referuar kontratës së shitblerjes nr. \*\*\*, datë 7.8.2009, dhe të ardhurat nga shitja e këtij automjeti në shumën 900.000 lekë, referuar kontratës së shitblerjes nr. \*\*\*, datë 18.1.2010.

**2.33.** Në vijim të arsyetimit më lart, subjekti dhe personat e lidhur rezultojnë me një mungesë burimesh të ligjshme në vlerën -2.355.014 lekë, për periudhën 1.1.2005-14.7.2014.

**2.34.** Në konkluzion të analizimit të pretendimeve të subjektit, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për krijimin e shumës 10.000 euro, dhënë hua motrës në vitin 2014, duke u gjendur në parashikimet e germës “b”, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

### **3. Huadhënie prindërve në vlerën 7.000 euro**

**3.1.** Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit deklaroi: “*Huadhënie prindërve të mi B., dhe Sh.A., pa interes dhe pa afat me marrëveshje verbale, në shumën 7.000 euro. Pjesa takuese: 50%*”.

**3.2.** Burimi i krijimit: kursime nga paga.

**3.3.** Subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor lidhur me huadhënien në vlerën 7.000 euro, me anë të të cilit prindërit e subjektit të mund të konfirmonin këtë marrëdhënie.

#### **Nga hetimi i Komisionit konstatohet se:**

**3.4.** Në DPV-në e vitit 2016 subjekti ka deklaruar huadhënie prindërve B., dhe Sh.A., pa interes dhe pa afat me marrëveshje verbale, në shumën 7.000 euro. Pjesa takuese: 100%. Burimi nga shitja e automjetit sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 29.9.2016.

**3.5.** Në pyetësorin standard<sup>27</sup> subjekti ka deklaruar se nga momenti i marrjes së detyrës ka blerë automjetin tip “BMW” me targa \*\*\*, në shumën 800.000 lekë (me të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targa \*\*\*, në pronësi që para marrjes së detyrës). Më tej,

---

<sup>27</sup>E-mail datë 27.10.2019, ora: 18:26.

ky automjet është shitur në datën 29.9.2016 në shumën 7.000 euro, shumë e cila në këtë periudhë i është dhënë hua prindërve të subjektit, pa interes.

**Lidhur me automjetin tip “BMW” me targa \*\*\*<sup>28</sup> dhe të ardhurat e siguruara nga shitja e tij:**

**3.6.** Sipas dokumentacionit të administruar nga DRSHTRR-ja Tiranë<sup>29</sup>, konfirmohet se në emër të subjektit ka qenë i regjistruar automjeti me targa \*\*\*. Nga kontrolli i kryer në AMF, ky automjet nuk figuron i regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit.

**3.7. Në DPV-në e vitit 2016**, subjekti ka deklaruar blerjen e automjetit tip “BMW”, viti 2006, me anë të kontratës nr. \*\*\*, datë 20.1.2016, me çmim 800.000 lekë (si burim për blerjen deklaroi shitjen e automjetit sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 20.1.2016). Më tej, subjekti deklaroi shitjen e këtij automjeti nëpërmjet kontratës nr. \*\*\*, datë 29.9.2016, në vlerë 7.000 euro<sup>30</sup>.

**3.8.** Nga këqyrja e AMF-së rezultoi që subjekti të ketë prerë një policë sigurimi për periudhën 22.7.2016 – 21.7.2017.

**3.9.** Komisioni konstaton se ky automjet është shitur pas rreth 8 muajsh me një vlerë më të lartë nga sa është blerë, konkretisht 161.310 lekë<sup>31</sup> më shumë.

**3.10.** Në përgjigjen e përcjellë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë<sup>32</sup>, nuk evidentohet pagesa e detyrimeve tatimore për vlerën e fitimit të realizuar nga shitja e këtyre automjeteve dhe, për këtë arsye, vlera e fitimit të realizuar prej 161.310 lekësh vlerësohet si e ardhur e paligjshme në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016 dhe kjo vlerë i zbritet të ardhurës së arkëtuar për efekt të analizës financiare.

**3.11.** Bazuar në deklaratimet periodike të subjektit rezultoi se gjendja e likuiditeteve *cash* në fund të vitit 2015 ka qenë në vlerën 970.000 lekë, për këtë arsye, Komisioni kreu analizën financiare për pasuritë, detyrimet, shpenzimet dhe të ardhurat e subjektit dhe personave të lidhur në datën 31.12.2016, nga ku rezultoi një balancë negative prej 436.577 lekësh.

**3.12. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës**, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: *Subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për dhënien e huas në shumën 7.000 euro, pasi për fitimin në vlerën 161.310 lekë të realizuar nga shitja e automjetit nuk janë paguar detyrimet tatimore dhe nga analiza e vitit 2016 duket se ka mungesë burimesh të ligjshme në shumën 436.577 lekë.*

---

<sup>28</sup>Targa të tjera \*\*\*, \*\*\*, numër të njëjtë shasie.

<sup>29</sup> Shkresat nr. \*\*\* prot., datë 11.11.2019 dhe nr. \*\*\*, datë 5.11.2019.

<sup>30</sup>Dokumentacioni i administruar me shkresat nr. \*\*\* prot., datë 11.11.2019 dhe nr. \*\*\*, datë 5.11.2019, si dhe dokumentet e paraqitura nga subjekti në përgjigje të pyetësorit standard.

<sup>31</sup>Diferenca midis çmimit të shitjes në vlerën 961.310 lekë (7.000 euro x 137.33, kursi zyrtar i Bankës së Shqipërisë) me çmimin e blerjes prej 800.000 lekë.

<sup>32</sup> Shkresë nr. \*\*\*, datë 28.10.2019.



### **3.13. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet dhe provat me shkrim dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës, deklaroi se:**

**3.14.** Për sa i përket moskonfirmimit të marrëdhënies së huas me babain, subjekti shpjegoi se duke qenë një marrëdhënie prind/fëmijë nuk ka vlerësuar se nevojitet një dokument i tillë dhe se gjatë deklarimit të kryer në ILDKPKI nuk i është kërkuar që ta formalizojë këtë marrëdhënie me babain.

**3.15.** Së pari – lidhur me analizën financiare, Komisioni duhet të konsiderojë si të ardhur të ligjshme fitimin në vlerën 161.310 lekë, të realizuar nga shitja e automjetit tip “BMW”. Fitimi nga shitja e automjetit nuk mund të trajtohet referuar germës “g”, të nenit 8, “Të ardhurat e tatueshme”, për sa kohë një gjë e tillë nuk është përcaktuar në mënyrë eksplicite në ligj.

**3.16.** Në nenin 155 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë përcaktohet se: *“Taksat, tatimet dhe detyrimet financiare kombëtare e vendore, lehtësimi ose përjashtimi prej tyre i kategorive të caktuara të pagesve, si dhe mënyra e mbledhjes së tyre caktohen me ligj”*. Pra, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë përcakton mjaft qartë se taksat dhe tatimet vendosen me ligj dhe asnjë organ shtetëror apo publik nuk mund të përcaktojë se cilat janë të ardhurat e tatueshme.

**3.17.** Në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat personale”, nuk parashikohet se fitimi i realizuar nga individët nga shitja e automjeteve është një e ardhur e tatueshme. Në këtë kuadër nuk është e drejtë që Komisioni ta kategorizojë këtë të ardhur si të ardhur të tatueshme. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe KPA-ja në vendimin nr. 12/2018 ndaj subjektit të rivlerësimit B. D., në të cilin arsyeton se: *“... Kushtetuta nuk e ka lënë në diskrecionin e organeve ligjzbatuese përcaktimin e të ardhurave ‘të tatueshme’, por ia ka njohur vetëm ligjit. Për këtë arsye, pjesa e shkëputur e fjalisë ‘të ardhura të tjera që nuk identifikohen në format e parashikuara në këtë nen’ mund të gjejë zbatim vetëm brenda një norme pozitive ligjore, jo akti nënligjor dhe as diskrecional të organeve publike...”*. Në këto kushte, konkluzioni i arritur nga Komisioni për këtë automjet nuk qëndron.

**3.18.** Neni 13 në pikën (d), trajton fitimin kapital *neto*, të krijuar nga investimet në tituj apo në pasuri të paluajtshme dhe jo fitimin e krijuar nga pasuritë e luajtshme. Ndonëse për pasuritë e paluajtshme ka një çmim dysheme, për efekt të përlllogaritjes së vlerës së shitjes dhe vlerës së pagesës së tatimit, kjo nuk ndodh me pasuritë e luajtshme. Ligjvënësi nuk ka parashikuar raste kur një individ nuk rezulton me fitim, por me humbje nga shitja e një automjeti. Në këto raste, humbja nuk konsiderohet si shpenzim i njohur për efekt të përlllogaritjes së detyrimit tatimor referuar nenit 13/3 të ligjit. Nëse me termin të ardhura të tjera do të kuptohej çdo e ardhur, atëherë nuk kishte pse në ligj të specifikohet lloji i të ardhurave të tatueshme.

**3.19.** Përveç sa më sipër, në kuptim të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat personale”, neni 13, “Deklarata individuale vjetore e të ardhurave”, përjashtohen nga detyrimi për plotësimin dhe dorëzimin e deklaratës individuale vjetore të të ardhurave të gjithë individët që realizojnë të ardhura *bruto* vjetore nga të gjitha burimet në shumën e përgjithshme më pak se 2.000.000 (dy milionë) lekë. Për pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme nuk paraqitet vlera e të ardhurave, por fitimi kapital realizuar nga shitja e pasurive. Në këtë kuptim, nuk ka pasur detyrimin për të plotësuar deklaratën dhe në të njëjtën kohë nuk ka pasur detyrimin për të paguar tatimin për fitimin e realizuar nga shitja e automjetit.

**3.20.** Së dyti – analiza financiare kryer nga Komisioni në pikën 3.11 duhet korrigjuar me të ardhurat nga shitja e autoveturës dhe shpenzimet sipas ILDKPKI-së. Shpenzimet e ILDKPKI-së janë përlllogaritur në shumën 940.368 lekë për 4 persona. Fëmijët, T., dhe I., janë nxënës të shkollës jopublike “\*\*\*”, ku babai i subjektit B.A., është drejtor në këtë shkollë. Fëmijët kanë transportin falas, konsumojnë dy vakte në shkollë dhe vetëm darkën konsumojnë në shtëpi. Përlllogaritja e shpenzimeve të jetesës për qytetin e Beratit është e lartë. Shpenzimet e jetesës për fëmijët duhet të jenë sa 1/3 e shpenzimit mujor për frymë e llogaritur për 9-muaj që është viti akademik i shkollës. Nga përlllogaritjet, shpenzimet e jetesës për dy fëmijët duhet të jenë 235.092 lekë/vit dhe shpenzimet e jetesës gjithsej 705.276 lekë.

**3.21.** Në konsideratë të kontestimeve të subjektit, analiza financiare për vitin 2016, e paraqitur në prapësime dhe në seancën dëgjimore, rezulton me një balancë negative prej 40.175 lekësh.

### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**3.22.** Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

**3.23.** Në lidhje me pretendimin e subjektit për të konsideruar në analizën financiare të ardhurat nga shitja e automjetit, pasi nuk mund të kategorizohet si e ardhur e tatueshme, Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka realizuar fitim nga shitja e këtij automjeti dhe në vlerësim të parashikimeve të germës “g”, të pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, i cili përcakton se: “*Për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale merren si të ardhura të tatueshme të ardhura të tjera që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen, të realizuara nga individë rezidentë ose nga persona jorezidentë, por me burim në Republikën e Shqipërisë*”.

**3.24.** Nën dritën e sa më sipër, të ardhurat e realizuara nga shitja me fitim e pasurive të luajtshme nuk bëjnë pjesë në të ardhurat e përjashtuara nga neni 8/1 i të njëjtit ligj. Për vlerën e fitimit të realizuar nga shitja e automjeteve (diferenca mes çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes së automjetit), nuk u provua pagimi i detyrimit tatimor mbi këtë fitim. Për rrjedhojë, vlera e fitimit të realizuar rezulton të jetë e ardhur e paligjshme, në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016.

**3.25.** Lidhur me pretendimin e subjektit se referuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar neni 13, “Deklarata individuale vjetore e të ardhurave”, përjashtohen nga detyrimi për plotësimin dhe dorëzimin e deklaratës individuale vjetore të të ardhurave të gjithë individët që realizojnë të ardhura *bruto* vjetore nga të gjitha burimet në shumën e përgjithshme më pak se 2.000.000 lekë, Komisioni vëren se kjo kërkesë ligjore ka të bëjë me detyrimin për deklarim dhe dorëzim të deklaratës individuale të të ardhurave, por nuk e përjashton individin nga pagesa e detyrimit tatimor në momentin që lind një i tillë, pavarësisht nga vlera e tij.

**3.26.** Vendimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit tek i cili referohet subjekti në mbështetje të pretendimit të tij, ka të bëjë me një rrethanë të ndryshme nga rasti konkret. Tashmë në jurisprudencën e Kolegjit<sup>33</sup> është konsoliduar qëndrimi për të ardhurat e realizuara nga shitja e automjeteve, duke e konsideruar fitimin e realizuar nga shitja e automjeteve për të cilin nuk provohet pagimi i detyrimit tatimor, si të ardhur të paligjshme, në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016.

**3.27.** Më tej, lidhur me pretendimin e subjektit se shpenzimet e jetesës për fëmijët duhet të jenë sa 1/3 e shpenzimit mujor për frymë e llogaritur për 9-muaj që është viti akademik i shkollës, pasi janë nxënës të shkollës jopublike “\*\*\*\*”, ku babai i subjektit B.A., është drejtor dhe fëmijët kanë transportin falas, konsumojnë dy vakte në shkollë dhe vetëm darkën konsumojnë në shtëpi, Komisioni konstaton se në vërtetimet nr. \*\*\* dhe nr. \*\*, datë 22.10.2019, lëshuar nga shkolla 9-vjeçare jopublike “\*\*\*\*”, dorëzuar nga subjekti në pyetësorin standard, specifikohet qartazi vetëm përjashtimi nga pagesa e shkollimit për fëmijët e subjektit. Subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti dokumentacion tjetër provues dhe, për rrjedhojë, pretendimi i tij për reduktimin e shpenzimeve të jetesës për fëmijët nuk u mor në konsideratë nga Komisioni.

**3.28.** Në vijim të arsytimit më lart, subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për kryerjen e shpenzimeve, blerjen e pasurive dhe për dhënien e huas, duke rezultuar me një mungesë burimesh të ligjshme në vlerën -436.577 lekë për vitin 2016.

**3.29. Në përfundim të analizës së pretendimeve të subjektit,** Komisioni konkludon se subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për dhënien e huas në shumën 7.000 euro në vitin 2016, duke u gjendur në këto kushte në parashikimet e germës “b”, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar dhënien e huas prej 7.000 euro në vitin 2016.

#### **4. Gjendje cash në vlerën 900.000 lekë**

**4.1. Në deklaratën Vetting të vitit 2017,** subjekti i rivlerësimit deklaroi: “*Të ardhura në lekë (cash) 900.000 lekë. Pjesa takuese: 50%*”.

**4.2. Burimi i krijimit:** kursime nga paga.

**Nga hetimi i Komisionit konstatohet se:**

**4.3. Në deklaratën para fillimit të detyrës, të vitit 2014,** subjekti ka deklaruar të ardhura *cash* në vlerën 400.000 lekë. Burimi i krijimit: kursime nga paga në 13 vjet punë. Pjesa takuese: 50%. Në DPV-në e vitit 2014, subjekti ka deklaruar të ardhura *cash* në vlerën 120.000 lekë. Burimi i krijimit: kursime nga paga. Pjesa takuese: 50%. Në DPV-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar shtesë të ardhurash *cash* në vlerën 450.000 lekë. Burimi i krijimit: kursime nga paga. Pjesa takuese: 50%. Në DPV-në e vitit 2016, subjekti ka deklaruar të ardhura *cash* në vlerën 400.000 lekë. Burimi i krijimit: kursime nga paga. Pjesa takuese: 50%. Në DPV-në e vitit 2017, subjekti ka deklaruar të ardhura *cash* në vlerën 900.000 lekë. Burimi i krijimit: nga kursimet dhe shitja e automjetit të tij dhe atë të bashkëshortes, sipas kontratave nr. \*\*\*, datë 26.12.2017 dhe nr. \*\*\*, datë 16.11.2017. Pjesa takuese: 50%. Gjithashtu, subjekti deklaroi blerjen e

<sup>33</sup> Vendim nr. 11-2019 (JR), datë 22.5.2019; vendim nr. 34-2019 (JR), datë 2.12.2019.

automjetit tip “Mercedes Benz”, me kontratë nr. \*\*\*, datë 13.9.2017, me çmim 5.000 euro. Më pas shitjen me kontratë nr. \*\*\*, datë 26.12.2017, me çmim 600.000 lekë. Ndërsa bashkëshortja e subjektit ka deklaruar shitjen e automjetit me kontratën nr. \*\*\*, datë 16.11.2017, me çmim 250.000 lekë dhe në DPV-në e vitit 2018, subjekti ka deklaruar të ardhura *cash* në vlerën 250.000 lekë. Burimi i krijimit: kursimet nga paga.

**4.4.** Me anë të pyetësorit nr. 3<sup>34</sup>, subjekti u pyet lidhur me deklaratimet e gjendjeve *cash* në DPV-të vjetore, për të saktësuar nëse janë shtesa apo gjendje në fund të vitit.

**4.5.** Në përgjigje<sup>35</sup>, subjekti deklaroi se në DPV-të vjetore ka deklaruar të ardhurat *cash* të shtuara, ndërkohë në deklaratën *Vetting* ka deklaruar gjendjen e të ardhurave *cash* të siguruara që nga koha e marrjes së detyrës.

**4.6.** Referuar deklaratave periodike vjetore dhe deklaratës *Vetting*, në pyetësin nr. 4, subjekti u pyet lidhur me diferencën prej 470.000 lekësh midis gjendjes së likuiditeteve *cash* në datën 31.12.2016 (1.370.000 lekë) dhe në datën 26.1.2017 (900.000 lekë). Në përgjigje, subjekti deklaroi se në deklaratën *Vetting*, plotësuar në datën 26.1.2017, i është referuar vetëm gjendjes së kursimeve të siguruara që nga momenti i marrjes së detyrës në datën 14.7.2014 dhe në vijim, por nuk ka shpjeguar se nga vjen diferenca prej 470.000 lekësh.

**4.7. Nga faktet e analizuar më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: *Duket se ka mospërputhje ndërmjet gjendjes së deklaruar në datën 31.12.2016 (1.370.000 lekë) e bazuar në deklaratat periodike vjetore dhe gjendjes së deklaruar në datën 25.1.2017 në deklaratën Vetting (900.000 lekë).***

**4.8. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet dhe provat me shkrim dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës, deklaroi se: “Konstatimi i Komisionit për diferencën në shumën prej 470.000 lekësh midis gjendjes së likuiditeteve *cash* në datën 31.12.2016, në shumën 1.370.000 lekë dhe në datën 26.01.2017 në shumën 900.000 lekë është pasi në deklaratën *Vetting* nuk është përfshirë shuma prej 400.000 lekësh deklaruar si gjendje *cash* në deklaratën para fillimit të detyrës. Kuptimi i ligjit nr. 84/2016 ka qenë për deklarimin e gjendjes *cash* të krijuar nga data e emërimit dhe në vazhdim duke mos përfshirë gjendjen *cash* deri në datën e fillimit të detyrës”.**

#### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**4.9.** Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

---

<sup>34</sup>E-mail datë 6.7.2020, ora 10:26.

<sup>35</sup>E-mail datë 15.7.2020, ora 10:47.

**4.10.** Në lidhje me pretendimin e subjektit se kuptimi i ligjit nr. 84/2016 ka qenë për deklarimin e gjendjes *cash* të krijuar nga data e emërimit dhe në vazhdim duke mos përfshirë gjendjen *cash* deri në datën e fillimit të detyrës, Komisioni vlerëson se kuptimi jo i saktë i ligjit nr. 84/2016 në lidhje me gjendjen *cash*, nuk e shkarkon subjektin nga detyrimi për të deklaruar saktë pasuritë në pronësi.

**4.11.** Referuar pikës 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, deklaratimet e interesave private dhe pasurore të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe në këtë rast çdo deklaram i subjektit në ILDKPKI në zbatim të ligjit “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë”.

**4.12.** Gjithashtu, vlen të theksohet se subjekti i rivlerësimit është udhëzuar nga ILDKPKI-ja për plotësimin e saktë të deklaratës me anë të udhëzimit nr. 4095, datë 10.10.2016, “Për mënyrën e deklarimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, i dalë në zbatim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016”.

**4.13. Në konkluzion,** Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka plotësuar saktë deklaratën *Vetting* 2017, në lidhje me gjendjen *cash* të deklaruar prej tij, duke u gjendur në kushtet e germës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

## **5. Apartament në përdorim në Tiranë**

**5.1. Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:** “*Banesë në përdorim (e paregjistruar ne regjistrat e pasurive të paluajtshme) me adresë Kompleksi \*\*\*, Rruga \*\*\*, Tiranë, në të cilën jetoj pa pagesë prej nëntorit të vitit 2016 dhe aktualisht, në pronësi të shtetasës H.K., (vjehrra)*”.

**5.2.** Subjekti, për vërtetimin e deklarimeve të tij, ka paraqitur dokumentacion ligjor provues<sup>36</sup>.

**5.3. Nga hetimi i Komisionit konstatohet se** referuar dokumentacionit të administruar nga ASHK-ja Tiranë<sup>37</sup>, kjo pasuri nuk rezulton e regjistruar në emër të znj. H.K., vjehrra e subjektit.

**5.4.** Sipas kontratës premtim shitje nr. \*\*\*, datë 19.7.2016, me palë premtues shitës F.A., premtues blerës H.K., pëlqimdhënës shoqëria “\*\*\*” sh.p.k, është nënshkruar marrëveshja për blerjen e apartamentit me nr. \*\*\*, sipërfaqe totale 82 m<sup>2</sup>, në strukturën \*\*\*, me çmim 52.000 euro. Vlera 42.000 euro do të paguhet në llogarinë e shitësit nëpërmjet transfertës bankare, brenda një jave nga data e nënshkrimit të kontratës, vlera 5.000 euro do të paguhet me dorëzimin e çelësave të pala blerëse dhe vlera 5.000 euro do të paguhet me realizimin e kontratës përfundimtare të shitjes.

**5.5. Në pyetësonin standard<sup>38</sup>** subjekti deklaroi se ka në përdorim banesën e vjehrrës së tij, znj. H.K., ap. nr. \*\*\*, struktura “\*\*\*”, Rr. “\*\*\*” Tiranë, pa qira, nga muaji nëntor 2016 e në vazhdim. Ndërsa në pyetësonin nr. 3, datë 14.7.2020, subjekti ka deklaruar se ka jetuar në këtë

---

<sup>36</sup>Kontratë premtim shitje nr. \*\*\*, datë 19.7.2016, të apartamentit nr. \*\*\*, sip. totale 82 m<sup>2</sup>, në strukturën “\*\*\*” me çmim 52.000 euro.

<sup>37</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 11.11.2019 dhe nr. \*\*\*, datë 5.11.2019.

<sup>38</sup>Përgjigje e-mail datë 27.10.2019.

banesë gjatë periudhës nëntor 2016 (momenti i transferimit nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Berat në atë të Tiranës) deri në maj 2018 (muaj në të cilën deklaroi se ka qenë i komanduar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës), duke udhëtuar dy herë në javë<sup>39</sup>. Gjatë periudhës maj 2018 – tetor 2019 ka banuar në banesën e prindërve të tij në Berat, duke e kryer vajtje – ardhje rrugën Berat-Durrës. Nga nëntori i vitit 2019 e në vijim deklaroi se nuk ka qëndruar në Tiranë, por e ka kryer vajtje-ardhje rrugën Berat-Tiranë.

**5.6.** Në pyetësin nr. 3<sup>40</sup>, subjekti u pyet se përse është porositur ky apartament nga personi tjetër i lidhur, znj. H.K., ndërkohë që nuk është përdorur asnjëherë prej saj.

**5.7. Në përgjigje të pyetësit nr. 3<sup>41</sup>,** subjekti deklaroi se ky apartament është porositur nga vjehrra H.K., për djalin e saj A.K., që aktualisht punon dhe jeton në Itali.

**5.8.** Komisioni hetoi lidhur me historikun e kësaj pasurie<sup>42</sup> dhe në përgjigjen e administruar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k.<sup>43</sup> rezultoi se pala premtuese shitëse F.A., e ka përfutur këtë apartament në cilësinë e pronarit të truallit dhe si rezultat i kontratës së shkëmbimit për pasuri të paluajtshme nr. \*\*\*, datë 11.6.2020, me shoqëritë ndërtuese “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe “\*\*\*\*” sh.p.k.

**5.9.** Në Komision, për subjektin e rivlerësimit, z. Arben Allajbeu, është administruar një denoncim nga publiku me nr. \*\*\* prot., datë 4.7.2019, i një shtetasi, i cili kërkon të mbetet anonim. Ky denoncues e akuzon subjektin për korrupsion dhe fshehje të pasurive, të regjistruara në emër të të afërmeve të tij, konkretisht për këtë apartament duke denoncuar se: “[...] Në vitin 2016 Arben ka marrë emërimin si prokuror në Tiranë dhe po atë vit ai ka blerë shtëpi me sip. 100 m<sup>2</sup> në emër të vjehrrës së tij në Tiranë, [...]”.

**5.10.** Nisur nga denoncimi më sipër, ku një shtetas ka dhënë informacion drejtpërdrejt në Komision dhe ky informacion përmban përshkrimin e të dhënave për pasuri të subjektit, por të vendosura në emër të personave të tjerë, duke i cilësuar si pasuri të fshehura të tij, sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni vlerësoi të kryente një hetim mbi këto informacione.

**5.11.** Komisioni kreu një hetim të gjithanshëm mbi pasuritë, të ardhurat dhe shpenzimet e vjehrrës së subjektit/H.K., si vijon:

**Lidhur me pasuritë e paluajtshme të vjehrrës së subjektit të rivlerësimit, znj. H.K., nga hetimi rezultoi se ka në pronësi këto pasuri:**

**5.12. Apartament i porositur në Tiranë, çmimi 52.000 euro** – sipas kontratës premtim shitje nr. \*\*\*, datë 19.7.2016 (trajtuar në pikat 4.18 - 4.22).

**5.13.** Më tej, në dokumentacionin e përcjellë nga “ABI Bank”<sup>44</sup>, konstatohet se në datën 20.7.2016, nga llogaria e shtetases H.K., janë kryer dy transfera në favor të shtetasis F.A., (premtues shitës i apartamentit) me përshkrim “*likuidim për blerje apartamenti sipas kontratës*”

<sup>39</sup>Subjekti ka deklaruar: “Zakonisht jam nisur nga qyteti i Beratit për në Tiranë ditën e hënë të çdo jave dhe jam kthyer nga Tirana në Berat ditën e mërkurë. Kam shkuar sërish nga Berati në Tiranë ditën e enjte për t’u kthyer nga Tirana në Berat ditën e premte”.

<sup>40</sup> E-mail datë 6.7.2020, ora 10:26.

<sup>41</sup> E-mail datë 15.7.2020, ora 10:47.

<sup>42</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 12.10.2020.

<sup>43</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 3.11.2020.

<sup>44</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 21.10.2019.

nr. \*\*\*, datë 19.7.2016”, konkretisht një transfertë në datën 20.7.2016 me vlerë 42.000 euro dhe një transfertë e dytë në datën 2.12.2016 me vlerë 5.000 euro.

**5.14.** Lidhur me burimin e shumave të transferuara konstatohet se transfertat e parë (42.000 euro) e ka burimin në dy depozitime *cash*, respektivisht 35.000 euro në datën 19.7.2016 dhe 7.000 euro në datën 20.7.2016, ndërsa transfertat e dytë në një depozitim në datën 2.12.2016.

**5.15.** Komisioni vëren se në përgjigjen e administruar nga “ABI Bank”<sup>45</sup>, lidhur me depozitim e vlerës prej 35.000 euro, në deklaratën për burimin e pasurisë, datë 19.7.2016, znj. H.K., deklaron se ky transaksion buron nga shitja e pronës dhe kursimet.

**5.16. Vendparkim i porositur në Tiranë, çmimi 19.000 euro** – në dokumentacionin e përcjellë nga “Union Bank”<sup>46</sup> është administruar një kontratë sipërmarrjeje (për prenotim vendparkimi) nr. \*\*\*, datë 15.8.2018, e lidhur midis shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe shtetas H.K., (jo përpara noterit), me objekt vendparkimi nr. \*\*\*, me sipërfaqe të përgjithshme 52.1 m<sup>2</sup>, me sipërfaqe individuale 26.6 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe të përbashkët 25.5 m<sup>2</sup>, çmimi 19.000 euro. Në lëvizjet e llogarisë bankare konstatohet se nga llogaria e shtetas H.K., janë kryer transfertat në vijim: (i) në datën 17.8.2018, në shumën 5.000 euro; (ii) në datën 23.11.2018, në shumën 7.000 euro; (iii) në datën 26.11.2018, në shumën 5.000 euro; (iv) në datën 14.12.2018, në shumën 2.000 euro. Në të gjitha rastet, depozitimi i shumës së transferuar është bërë ditën e kryerjes së transfertës.

**5.17. Apartament në pronësi në Berat, çmimi 5.500.000 lekë dhe vendparkim në pronësi në Berat, çmimi 800.000 lekë** – ASHK-ja<sup>47</sup> informon se shtetasja H.K., ka në pronësi pasurinë e llojit apartament me sipërfaqe totale 116.6 m<sup>2</sup>, nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, Berat dhe pasurinë e llojit garazh, me sipërfaqe totale 20.4 m<sup>2</sup>, nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, Berat. Në dokumentacionin e përcjellë është administruar kontratë shitblerje pasuri e paluajtshme nr. \*\*\*, datë 3.4.2015, me shitës shtetasit B., dhe M.Sh., dhe blerës shtetasen H.K.

**5.18.** Komisioni konstaton se pagesa e shumës totale prej 6.300.000 lekësh është kryer nëpërmjet një transfertë bankare nga llogaria e znj. H.K., në “Alpha Bank”<sup>48</sup> në datën 2.4.2015, në vlerën 6.300.000 lekë, me përshkrimin “*H.K., kalim në llogari H.B., P. F. për kontratë shitblerje*”. Kjo transfertë e ka burimin në dy depozitime nga shtetasja H.K., po në datën 2.4.2015, konkretisht shumat 3.000.000 lekë dhe 3.301.000 lekë. Referuar dokumentacionit të përcjellë nga “Alpha Bank”<sup>49</sup>, konkretisht deklaratës për burimin e pasurisë së plotësuar nga shtetasja H.K., në momentin e depozitimit të këtyre shumave, rezulton se si burim kanë shërbyer tërheqjet e kryera nga kjo shtetase nga llogaritë në bankën FIB dhe një pjesë nga kursimet e saj.

**5.19. Apartament me sip. 64.1 m<sup>2</sup>, në Berat, që ka shërbyer si burim për blerjen e apartamentit në kompleksin \*\*\*, Rr. “\*\*\*\*”, Tiranë.** Nga hetimi i Komisionit, znj. H.K., me kontratën e shitjes nr. \*\*\*, datë 22.11.1993, ka përfitur apartament 1+1 dhe truallin përkatës të këtij apartamenti me sip. 16.34 m<sup>2</sup>, në vlerën 8.762 lekë. Kjo banesë i është shitur shtetasve

<sup>45</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 17.9.2020.

<sup>46</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 29.10.2019.

<sup>47</sup>Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 4.12.2019.

<sup>48</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 19.12.2019.

<sup>49</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 22.10.2020.

I., dhe E.V., me kontratën nr. \*\*\*, datë 20.9.2016, në shumën 21.000 euro (vlerë e cila nga blerësit do të shlyhet me kredinë e marrë nga “NBG”). Me deklaratën nr. \*\*\*, datë 20.10.2016, znj. H.K., deklaroi likuidimin e plotë të kësaj vlere.

**5.20.** Komisioni kërkoi nga subjekti të deklarojë adresën e banimit të znj. H.K., gjatë periudhës 2014 – 2018 dhe në përgjigje subjekti sqaron se deri në maj të vitit 2015, vjehrra e tij ka jetuar në banesën e ndodhur në lagjen “\*\*\*”, p. nr. \*\*\*, shk. \*\*\*, k. \*\*\*, ap. \*\*\*, Berat, banesë të cilën e ka shitur në vitin 2016. Prej muajit maj të vitit 2015 dhe në vazhdim, ajo banon në apartamentin e blerë sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 3.4.2015, ndodhur në lagjen “\*\*\*”, ap. \*\*\*, shk. \*\*\*, k. \*\*\*, Berat.

**5.21.** Me kontratën e huapërdorjes nr. \*\*\*, datë 30.8.2016, znj. H.K., ua ka lënë në përdorim këtë apartament (me sip. 64.1 m<sup>2</sup>) shtetasve L., dhe L.B., për një periudhë 1-vjeçare (30.8.2016 – 30.8.2017), pa shpërblim.

**5.22.** Komisioni vëren se apartamenti është shitur rreth 1 muaj pasi është lëshuar deklarata për huapërdorje. Me anë të pyetësorit nr. 5<sup>50</sup>, subjektit iu kërkuan shpjegime lidhur me sa konstatohet. Në përgjigje<sup>51</sup> subjekti deklaroi se: *“Marrëveshja me blerësin e banesës është arritur disa kohë para kryerjes së veprimit të shitjes së kësaj pasurie. Blerësi ka aplikuar për marrjen e një kredie me qëllim blerjen e kësaj pasurie. Edhe pas miratimit të kredisë kontrata nuk është lidhur menjëherë pasi kjo pasuri ka qenë në proces rivlerësimi. Pas rivlerësimit të saj është kryer edhe shitja e apartamentit. Gjatë kësaj periudhe blerësi ka qëndruar në banesë me marrëveshje deri në përfundim të rivlerësimit dhe lidhjes së kontratës së shitjes.”*

**5.23.** Komisioni vëren se deklaratimet e subjektit nuk përputhen, pasi ky apartament i është lënë në përdorim pa kundërshpërblim shtetasve L., dhe L.B., dhe jo blerësve I., dhe E.V.

**5.24.** Nga hetimi i Komisionit, referuar përgjigjes së administruar të OSHEE-së<sup>52</sup>, rezultoi se në emër të znj. H.K., identifikohen dy kontrata furnizimi me energji elektrike në instancën e Beratit, me këto të dhëna: *“Rr. ‘\*\*\*’, \*\*\*, 1-7, instaluar në datën 26.5.2005 dhe adresa ‘\*\*\*’ instaluar në datën 25.5.2005, shënime”*, emri nga B.Sh., në H.K., datë 15.11.2015.

### **Lidhur me të ardhurat e vjehrrës së subjektit të rivlerësimit, znj. H.K.,**

**5.25.** Në përgjigje të pyetësorit nr. 2<sup>53</sup>, subjekti deklaroi se burimi financiar i blerjes së apartamentit në Tiranë janë të ardhurat personale të vjehrrës (pension dhe paga), të ardhurat e djalit të saj A.K., në emigracion që prej vitit 2001 dhe në vazhdim në Itali, si edhe të ardhurat nga shitja e një apartamenti në vlerën 21.000 euro, përfituar nga privatizimi pas vitit 1990. Ndërsa lidhur me burimin e blerjes së apartamentit dhe vendparkimit në Berat, subjekti deklaroi se burimi i të ardhurave kanë qenë kursimet e familjes, ndër vite, nga pagat, pensionet, punësimi në privat dhe të ardhurat nga emigracioni.

<sup>50</sup>E-mail datë 14.10.2020, ora 10:49.

<sup>51</sup>E-mail datë 18.10.2020, ora 23:41.

<sup>52</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 29.10.2020.

<sup>53</sup>E-mail datë 31.1.2020, ora 14:30.



**5.26.** Për sa i përket **të ardhurave të vjehrrës**, Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti<sup>54</sup> dhe atë të marrë gjatë hetimit<sup>55</sup> për periudhën 1994 – 2016, përllogariti të ardhura nga pensioni në shumën 2.515.400 lekë; të ardhura nga punësimi në shumën 475.080 lekë; të ardhura nga interesat bankare në shumën 252.845 lekë dhe të ardhura nga investimi në fondin Raiffeisen Invest në shumën 32.408 lekë. Për këtë periudhë shpenzimet jetike për një person përllogariten në shumën 2.551.902 lekë<sup>56</sup>.

**5.27.** Për sa i përket **të ardhurave të shtetasit A.K.**, në përgjigje të pyetësorit nr. 2 subjekti dorëzoi dokumentacion justifikues mbi të ardhurat *bruto* të këtij shtetasi, dokumentacion i cili nuk është sipas formës së kërkuar nga ligji (fotokopje, në gjuhën italiane, i papërkthyer dhe pa vulë apostile).

**5.28.** Më tej, në pyetësorin nr. 4, subjektit iu kërkua të dorëzojë dokumentacion justifikues mbi të ardhurat *neto* të z. A.K., dhe nëse kanë pasur të ardhura të tjera, përveç atyre të dorëzuara në pyetësorin nr. 2 dhe në përgjigje subjekti deklaroi: Sa i përket të ardhurave të shtetasit A.K., ka mundur të sigurojë vetëm të dhënat të cilat i ka vënë në dispozicion të Komisionit. Sikurse edhe për shumë shtetas të tjerë emigrantë jashtë vendit, për shkaqe të njohura, të ardhurat e deklaruar nuk përputhen me të ardhurat reale, të cilat janë përgjithësisht më të larta. Pjesën e padeklaruar të të ardhurave që mund të jenë siguruar nga puna informale, subjekti nuk mund ta dokumentojë, duke mos dashur të ndërhyjë dhe të cenojë marrëdhëniet me kunatin e tij A.K. Për periudhën para largimit në Itali, pra, para vitit 2001, kunati i tij ka qenë në marrëdhënie pune private, si agjent shitjeje në shoqërinë “\*\*\*”, dega Berat. Deklaroi se nuk ka mundur të sigurojë dokumentacion shoqëruar. Ndërkohë për bashkëshorten e kunatit, shtetasen A.K., subjekti ka paraqitur një vërtetim page nga Sigurimet Shoqërore Dega Berat, ku rezultoi se kjo shtetase ka qenë e punësuar për periudhën janar 2013 – dhjetor 2013 dhe nga marsi i vitit 2018 e në vijim. Komisioni konstaton se shtetasja A.K., për periudhën shtator 2018 e në vijim, ka qenë e punësuar në Berat. Referuar informacionit të përcjellë nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile<sup>57</sup> rezultoi se shtetasja A.K., dhe shtetasja A.K., janë lidhur në martesë në datën 8.6.2015 dhe figurojnë të regjistruar si banorë në Bashkinë Berat. Për rrjedhojë, të ardhurat e kësaj shtetaseje, për vitin 2013 (përpara martesë), nuk u morën në konsideratë në analizën financiare. Gjithashtu, nuk u morën në konsideratë të ardhurat e viteve 2018 dhe 2019, për sa kohë ato janë realizuar pas kryerjes së pagesave për apartamentin.

**5.29.** Komisioni analizoi dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti lidhur me të ardhurat e shtetasit A.K., në shtetin italian, nga ku rezultoi se për periudhën 2006 – 2016, të ardhurat *bruto* kanë qenë në shumën 104.472 euro, ndërkohë që shpenzimet jetike për një person për të njëjtën periudhë përllogariten të jenë 92.326 euro<sup>58</sup> dhe, për rrjedhojë, duke konsideruar se të ardhurat e përllogaritura janë në shumën *bruto*, nuk duket të ketë pasur mundësi për të krijuar kursime me burime të ligjshme.

<sup>54</sup>Në pyetësorin nr. 2, subjekti dorëzoi vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 29.1.2020, nga ISSH, Drejtoria Rajonale Berat.

<sup>55</sup>(1) Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 1.6.2020, nga ISSH, Drejtoria Rajonale Berat, për të ardhurat nga pensioni; (2) shkresë nr. \*\*\*, datë 22.10.2019, nga ISSH për të ardhurat nga punësimi (përllogaritur shuma *neto*).

<sup>56</sup>Për periudhën 1994 – 1999 shpenzimet jetike janë përllogaritur si 66% e të ardhurave, ndërkohë që për periudhën 2000 – 2014 janë përllogaritur sipas shkresës nr. \*\*\*, datë 4.3.2019, të ILDKPKI-së.

<sup>57</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2020.

<sup>58</sup><https://www.istat.it/it/dati-analisi-e-prodotti/contenuti-interattivi/soglia-di-poverta>, me kritere kritere kërkimi: veri; 1 person i moshës 18-59; komunë nën 50.000 banorë.

**5.30.** Për sa i përket të ardhurave nga shitja e apartamentit të përfitur nga privatizimi, pas analizimit të dokumentacionit të përcjellë nga ASHK-ja Berat<sup>59</sup> dhe të dorëzuar nga subjekti<sup>60</sup>, Komisioni vëren se me anë të kontratës së shitjes nr. \*\*\*, datë 22.11.1993, znj. H.K., ka përfitur apartament 1+1 dhe truallin përkatës të këtij apartamenti me sip. 16.34 m<sup>2</sup>, në vlerën 8.762 lekë. Kjo banesë i është shitur shtetasve I., dhe E.V., me anë të kontratës nr. \*\*\*, datë 20.9.2016, në shumën 21.000 euro.

**5.31.** Komisioni konstaton se në datën 18.10.2016, në llogarinë e shtetas H.K., në “ABI Bank” është transferuar shuma prej 20.999,50 euro nga shtetasja K.M., me përshkrimin “*çmim shitje sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 20.9.2016, nga I.V., te H.K.,*”.

**5.32.** Sa më sipër, duke qenë se të ardhurat nga shitja e apartamentit të përfitur nga privatizimi janë transferuar pas kryerjes së pagesës për apartamentin në Tiranë, subjekti u ftua të japë shpjegime në pyetësin nr. 4, dhe në përgjigje, shpjegoi se marrëveshja për shitjen e apartamentit është arritur para datës 18.10.2016, por kontrata është lidhur në këtë datë (20.9.2016), në pritje të përfundimit të procedurës së rivlerësimit të pronës. Subjekti shpjegon se shuma e depozituar në datën 19.7.2016, është mundur të sigurohet nga kursimet dhe një pjesë e siguar nga të afërmit e tyre, detyrim i cili është likuiduar pas shitjes së pasurisë.

**5.33.** Në pyetësin nr. 4<sup>61</sup>, subjektit iu kërkua të deklarojë vlerën e shpenzimeve të kryera për mobilimin e apartamentit në Tiranë nga vjehrra e tij dhe shtetasi A.K., si dhe për apartamentin e blerë në Berat dhe, në përgjigje, subjekti shpjegoi se mobilimi në shtëpinë në Tiranë arrin në vlerën 3.000 euro, ndërsa për shtëpinë në Berat deklaroi vlerën 1.000 euro<sup>62</sup>.

**5.34.** Sa më lart, Komisioni kreu analizën financiare për pasuritë, të ardhurat dhe shpenzimet e vjehrrës së subjektit, nga ku rezultoi se për periudhën 1994 – 2016, të ardhurat kanë qenë në shumën 6.116.403 lekë<sup>63</sup>, shpenzimet jetike në shumën 2.551.902 lekë<sup>64</sup>, shpenzime të tjera në shumën 543.460 lekë<sup>65</sup>, shtim i llogarive bankare në shumën 201.753 lekë<sup>66</sup>, shpenzim për blerje apartamenti dhe garazhi në Berat në shumën 6.300.000 lekë (rreth një vit përpara blerjes së apartamentit në Tiranë) dhe shpenzim për blerje apartamenti në Tiranë në shumën 6.357.690 lekë.

**5.35.** Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 9.11.2020, Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit, bazuar në paragrafin 3/b, të nenit B, të Aneksit të Kushtetutës dhe në paragrafin 11, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016, ka paraqitur mendim lidhur me përdorimin e këtij apartamenti nga subjekti dhe mundësitë financiare të vjehrrës së tij për të blerë këtë pasuri. Referuar opinionit të përcjellë, vëzhguesi ndërkombëtar shprehet se ekzistojnë arsye të bazuara për të besuar se subjekti i rivlerësimit është përpjekur të fshehtë këtë pasuri nën emrin e vjehrrës së tij. Nga

---

<sup>59</sup>Shkresë nr. \*\*\*, datë 7.6.2020.

<sup>60</sup>Pyetësi nr. 4.

<sup>61</sup>E-mail datë 18.9.2020, ora 11:41.

<sup>62</sup>Viti i kryerjes së shpenzimeve u përcaktua bazuar në deklarin lidhur me fillimin e jetesës në apartamentin përkatës.

<sup>63</sup>Për periudhën 1994-2004 në shumën 2.407.894 lekë, për vitin 2015 në shumën 437.724 lekë; për vitin 2016 në shumën 430.115 lekë nga pagat e pensionet dhe 2.840.670 lekë nga shitja e apartamentit të përfitur nga privatizimi.

<sup>64</sup>Për periudhën 1994-2004 në shumën 2.092.534 lekë, për vitin 2015 në shumën 224.276 lekë; për vitin 2016 në shumën 235.092 lekë.

<sup>65</sup>Për vitin 2015 në shumën 137.650 lekë dhe për vitin 2016 në shumën 405.810 lekë.

<sup>66</sup>Për periudhën 1994-2004 shtuar në shumën 3.842.663 lekë, për vitin 2015 pakësuar në shumën 3.499.613 lekë; për vitin 2016 pakësuar në shumën 141.296 lekë.

hetimi i Komisionit lidhur me apartamentin në Rr. “\*\*\*”, Tiranë, rezultoi se vjehrra e subjektit nuk ka pasur të ardhura nga burime të ligjshme financiare në periudhat 1994 – 2014, 2015 dhe 2016.

**5.36.** Në këto kushte, Komisioni, bazuar edhe në jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, mund të hetojë mbi pasuritë dhe burimin krijimit të tyre në rastet kur ka *indicie* apo elemente që të çojnë në dyshime për fshehje të këtyre pasurive.

**5.37. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës,** Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: *Ka dyshime të arsyeshme se subjekti i rivlerësimit është përpjekur të fshehtë pasurinë apartament në Rr. “\*\*\*” në Tiranë, \*\*\*, në emër të vjehrrës së tij, për arsye se: (i) subjekti ka përdorur këtë apartament që nga nëntori i vitit 2016 deri në prill 2018, pa kundërshtim dhe pa ndërprerje nga momenti i blerjes; (ii) vjehrra e subjektit, njëkohësisht dhe pronare e këtij apartamenti, nuk ka jetuar asnjëherë vetë në këtë apartament, sipas deklarimeve të subjektit<sup>67</sup>; (iii) ky apartament është porositur rreth 2 muaj para transferimit të subjektit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; (iv) vjehrra e subjektit ka dalë në pension që në vitin 1994 dhe ka qenë e punësuar nga muaji dhjetor 2014 e në vijim me pagë minimale, ndërkohë investimet në pasuri të paluajtshme i ka kryer nga viti 2015 e në vijim; (v) sipas deklaramentit të subjektit, vjehrra e ka blerë apartamentin në Tiranë për djalin e saj A.K., ku për këtë të fundit subjekti deklaroi se ka kontribuar financiarisht në këtë apartament, por ky shtetas nuk figuron si palë në kontratën e porosisë; (vi) fakti që vjehrra ka në pronësi dy vendparkimi, njërin në Tiranë dhe tjetrin në Berat, ndërkohë që nuk disponon automjet; (vii) vjehrra e subjektit nuk ka pasur burime të ligjshme financiare për blerjen e apartamentit në Tiranë; (viii) shtetasi A.K., nuk ka pasur burime të ligjshme financiare për të kontribuar në blerjen e apartamentit në Tiranë.*

**5.38. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet dhe provat me shkrim dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës, deklaroi se:**

**5.39.** Në seancën dëgjimore të datës 12.1.2021, përfaqësuesja me prokurë e subjektit, av. A.S., deklaroi se gjetjet e Komisionit në lidhje me këto pasuri të vjehrrës nuk qëndrojnë, pasi: **së pari** - bazohen në një kallëzim anonim të pavërtetë, i cili mund të jetë bërë prej një shtetasi interesat e të cilit janë përplasur në punën e prokurorit; **së dyti** – bazohen në *indicie* të parëndësishme, të cilat mund të vërtetojnë ekzistencën e faktit të aluduar nga Komisioni. Subjekti, në shpjegimet e tij, deklaroi se dyshimi për fshehje të pasurisë nuk mund të lind kurrësi nga një letër apo ankesë anonime, autori apo autorja e së cilës me qëllim ka deformuar të dhëna, të cilat janë publike dhe mund të verifikohen nga kushdo. Nëse gjatë 20 vjetëve emigracion në Itali, kunati i subjektit ka punuar dhe ka realizuar të ardhura edhe nga puna në

---

<sup>67</sup> Në pyetësin nr. 4, në përgjigje të pyetjes nr. 4 subjekti ka deklaruar: “Deri në muajin maj 2015, vjehrra ime ka jetuar në banesën e ndodhur në lagjen ‘\*\*\*’, Berat, p. nr. \*\*\*, shk. \*\*\*, k. \*\*\*, ap. \*\*\*, banesë të cilën e ka shitur në vitin 2016. Prej muajit maj 2015 e në vazhdim, ajo është banuese në apartamentin e blerë sipas kontratës së shitblerjes nr. \*\*\*, datë 3.4.2015, ndodhur në lagjen ‘\*\*\*’, ap. \*\*\*, shk. \*\*\*, kat. \*\*\*Berat”.

informalitet dhe ai dhe vjehrra nuk justifikojnë pasurinë e blerë vetëm me të ardhurat e deklaruar, kjo nuk passjell domosdoshmërisht dyshimin që këto pasuri nuk janë blerë prej tyre.

**5.40.** Përdorimi i banesës së vjehrrës dhe kunatit të tij nuk është asgjë më shumë se një marrëdhënie mirëbesimi dhe kurrsesi kjo nuk përbën shkak apo arsye për të dyshuar mbi pronësinë e saj. Vjehrra nuk ka jetuar në banesën e saj në Tiranë pasi të jetosh në një banesë do të thotë të kalosh një pjesë të konsiderueshme të vitit dhe kjo realisht nuk ka ndodhur, por banesa është frekuentuar nga vjehrra aq kohë sa mund të frekuentohet një banesë e dytë. Pra, kjo banesë është frekuentuar nga ana e saj apo familjarëve të saj për aq kohë sa kanë pasur angazhime në Tiranë. Përfaqësuesi ligjor në seancë dëgjimore, prapësoi se fakti që vjehrra e subjektit nuk ka banuar asnjëherë në Tiranë është një fakt nga i cili nuk mund të nxirret ndonjë e dhënë apo të krijohet ndonjë dyshim.

**5.41.** Po kështu, fakti i përmendur në relacion se pikërisht porositja e këtij apartamenti dy muaj para transferimit të subjektit me detyrë në Tiranë të bën të mendosh apo dyshosh që kjo pasuri është e tij dhe është fshehur, është një absurditet. Subjekti shprehet se nuk ka pasur forcën dhe mundësinë kurrsesi për të parashikuar në kohë dhe vendosur transferimin e tij edhe pse e ka kërkuar një gjë të tillë dhe për transferimin në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë është ndjekur një procedurë zinxhir që kalon në disa institucione ku përfshihet këtu edhe Presidenti i Republikës së Shqipërisë.

**5.42.** Familja e subjektit asnjëherë nuk erdhi të banojë në Tiranë.

**5.43.** Koha e investimit të kryer nga familjarët e bashkëshortes së subjektit është një fakt për të cilin subjekti mendon se me tendencë lidhet me detyrën e tij dhe me transferimin në Tiranë, kur nuk ka asnjë provë të vetme që hedh dyshime që ka fshehur apo ka tjetërsuar pasurinë. Subjekti shprehet se “prova” që Komisioni i referohet është një “denoncim”, i cili qëllimisht është marrë në konsideratë nga Komisioni për të zgjeruar hetimin në persona që nuk janë të lidhur me të si subjekt. Vjehrra dhe kunati nuk janë përfshirë si persona të lidhur ose si persona të tjerë të lidhur as në tabelën e hartuar nga vetë Komisioni dhe që ndodhet në faqen e parë të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht”. Po kështu, në të ardhurat e kunatit të tij, z. A.K., qëllimisht nuk janë përllogaritur të ardhurat nga puna në informalitet për disa vite ashtu sikurse kanë përfituar pjesa dërrmuese e emigrantëve në çdo vend të botës, duke përfshirë këtu edhe Shqipërinë, ku aktualisht ekziston informaliteti. Në përllogaritjen e shpenzimeve për jetesë është marrë parasysh standardi i jetesës së një shtetasi italian<sup>68</sup> dhe jo i një emigranti, i cili ka pasur qëllim vetëm punën dhe sigurimin e të ardhurave.

**5.44.** Gjithashtu, paga e bashkëshortes së subjektit për vitet 2002 – 2005 nuk është marrë parasysh as në analizën financiare të familjes së saj dhe as në analizën financiare të familjes së subjektit.

**5.45.** Më tej, subjekti shprehet se kualifikimi i vjehrrës dhe kunatit të tij, si “persona të tjerë të lidhur” nuk është i drejtë, në raport me natyrën dhe objektin e marrëdhënies së tij me pasuritë në pronësi të tyre. Sipas përkufizimit të dhënë në pikën 14, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, që

---

<sup>68</sup> Referuar të dhënave statistikore nga “Eorldsalaries.org” lidhur me pagën në punë ndërtimore në shtetin Itali, rezulton se paga mesatare është 1.802 euro/ muaj. Po kështu, referuar të dhënave të Eurostat-it rezulton se pagat minimale në veri-përqendim të BE-së janë mbi 1.500 euro/muaj, ndërkohë që paga mesatare neto e përafërt në Itali është 1.736,18 euro.

një person fizik ose juridik të konsiderohet si “person tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit”, duhet që të provohet një lidhje interesi mes tyre, e cila duhet të rrjedhë nga: (i) një interes pasuror; ose (ii) çdo marrëdhënie tjetër biznesi.

**5.46.** Më tej, subjekti shpjegon se përkufizimi i marrëdhënies së biznesit gjendet në radhën e përkufizimeve të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, në pikën 9 të tij. Ndërsa lidhja e interesit që rrjedh nga një interes pasuror është trajtuar në pikën 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, ku përcaktohet në mënyrë specifike se cilat marrëdhënie do të përfshihen në sferën e interesit pasuror. Pra, interesi pasuror duhet të jetë një marrëdhënie dhurimi, huamarrjeje ose huadhënieje ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe një personi fizik ose juridik. Në zbatim të këtij kuadri ligjor, subjekti i rivlerësimit, për efekt të procesit të rivlerësimit, detyrohet të provojë burimin e ligjshëm të pasurisë së personit tjetër të lidhur, për pasurinë e përfshirë në marrëdhënien e konfirmuar të dhurimit apo huas. Fakti që ai për një periudhë të caktuar ka qëndruar në pasurinë e vjehrrës dhe kunatit të tij, nuk mjafton për të provuar që ai dhe vjehrra apo kunati i tij, janë në një marrëdhënie interesi pasuror. Në këto kushte, përdorimi i pasurisë së tyre nga ana e tij nuk përmbush kriteret e parashikuara nga dispozitat e sipërcituara, në kuptim të të cilave të mund të kualifikojë znj. H.K., apo z. A.K., si persona të tjerë të lidhur me të dhe, rrjedhimisht, t’i ngarkojë ata dhe subjektin me detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë së tyre.

**5.47.** Përfaqësuesi ligjor i subjektit në seancë dëgjimore shtoi se pavarësisht argumenteve për personin e lidhur, subjekti e ka deklaruar rregullisht këtë apartament dhe nuk ka asnjë të dhënë që kjo pasuri është fshehur. Në këto kushte, subjekti nuk ka pasur asnjë detyrim për justifikimin e të ardhurave të kunatit apo të vjehrrës së tij. Nëse Komisioni i ka konsideruar shtetasit K., si persona të tjerë të lidhur, duhet të analizonte vlerën e kësaj pasurie nën dritën e konceptit të dyfishit të pasurisë së ligjshme.

**5.48.** Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesja ligjore e subjektit kërkoi që Komisioni të konkludojë se nuk ka të dhëna që mbështesin dyshimin për fshehje të pasurisë dhe në vendimin përfundimtar që do të merret nga Komisioni të mos merren në analizë të dhënat për këtë pasuri për shkak se znj. H.K., dhe z. A.K., nuk janë persona të tjerë të lidhur, por dhe sikur të ishin nuk kalohet pragu i dyfishit të pasurisë së ligjshme.

### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**5.49.** Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

**5.50.** Lidhur me pretendimin e subjektit se denoncimi që Komisioni i referohet është një “denoncim”, i cili qëllimisht është marrë në konsideratë nga Komisioni për të zgjeruar hetimin në persona që nuk janë të lidhur me subjektin, Komisioni vlerëson se hetimi i vjehrrës së subjektit të rivlerësimit bazohet në ligjin nr. 84/2016, dhe më konkretisht bazuar në:

i) Nenet 30 dhe 45 të ligjit nr. 84/2016 që autorizojnë organet e rivlerësimit të hetojnë në drejtim të verifikimit e kontrollit të pasurisë çdo situatë, fakt apo cilësi, në funksion të realizimit të qëllimit të këtij procesi, autorizim i cili jo detyrimisht lidhet me cilësimin e personave të tretë si persona të tjerë të lidhur. Gjithashtu, në përputhje edhe me qëndrimin e Gjykatës Kushtetuese në vendimin nr. 2/2017, Komisioni ka tagrin që, të kryejë verifikime dhe hetime të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit për të vërtetuar çdo *indicie* apo të dhënë që rezulton nga dokumentacioni i mbledhur gjatë procesit hetimor të kryer në Komision.

ii) Faktin e përdorimit të këtij apartamenti nga subjekti i rivlerësimit për një periudhë të gjatë kohe, në mënyrë të pandërprerë dhe të qëndrueshme, duke e konsideruar si një marrëdhënie huapërdorje, sipas parashikimeve të nenit 901 e vijues të Kodit Civil, ku përfshihet huaja që parashikon pika 4, e nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, marrëdhënie e cila kategorizon vjehrrën e subjektit të rivlerësimit si person tjetër të lidhur për këtë pasuri dhe passjell detyrimin e subjektit të rivlerësimit për të provuar burimin e ligjshëm të kësaj pasurie.

iii) Nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, i cili autorizon Komisionin të hetojë mbi ligjshmërinë e burimit të krijimit të vjehrrës së subjektit në kuadër të verifikimit të dyshimeve të bëra prezent nga denoncimi i publikut, sipas të cilit kjo është pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit, por e regjistruar në emër të vjehrrës së tij. Vlen të theksohet se denoncuesi është një person me identitet të njohur, por ai ka kërkuar që të mbetet anonim. Në këto kushte, Komisioni vlerësoi se kërkesa e denoncuesit duhet pranuar dhe për këtë arsye nuk ia bëri me dije subjektit të rivlerësimit.

**5.51.** Në këtë kuptim, veprimtaria hetimore e Komisionit është e legjitimuar për më tepër edhe nga konkluzioni i nxjerrë prej analizës financiare të kryer në Komision, mbështetur në dokumentacionin ligjor të administruar gjatë hetimit për pasuritë, të ardhurat dhe shpenzimet e vjehrrës së subjektit të rivlerësimit dhe/ose personit tjetër të lidhur dhe/ose personi i tretë i lidhur me subjektin dhe/ose personi i denoncuar se fsheh një pronë në emër të subjektit, rezultoi se nuk ka pasur të ardhura nga burime të ligjshme financiare në periudhat 1994 – 2014, 2015 dhe 2016 për blerjen e apartamentit në Rr. “\*\*\*”, Tiranë. Referuar arsytimit më lart, subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin ligjor të provonte të kundërtën e rezultateve mbi mungesën e burimeve të ligjshme financiare të vjehrrës së tij, gjë të cilën ai nuk e provoi.

**5.52.** Komisioni çmon se edhe nëse konsiderohen në analizën financiare vetëm të ardhurat dhe shpenzimet për jetesë të vjehrrës (pra, duke mos përllogaritur shpenzimet për blerjen e apartamentit në Berat, për mobilimet e apartamenteve dhe shtesën e llogarive bankare, të detajuara në paragrafin 5.34), balanca pozitive do të ishte në vlerën 3.564.501 lekë, e pamjaftueshme për pagesën e shumës 47.000 euro (ose 6.357.690 lekë) në vitin 2016.

**5.53.** Komisioni çmon se faktet dhe provat e administruara gjatë hetimit dhe shqyrtimit të kësaj çështjeje provojnë se: (i) ekziston marrëdhënia e subjektit të rivlerësimit me apartamentin e vjehrrës për shkak të përdorimit pa kundërshtëpërblim, në mënyrë të pandërprerë, të qetë dhe për një kohë të gjatë të këtij apartamenti; (ii) vjehrra e subjektit të rivlerësimit nuk ka burime financiare të ligjshme për blerjen e këtij apartamenti, për një shumë të konsiderueshme; (iii) marrëdhënia e vjehrrës së subjektit me këtë apartament nuk krijon bindjen se ajo është pronari *de facto* i këtij apartamenti duke pasur parasysh se: (1) nuk ka jetuar asnjëherë vetë në këtë

apartament; (2) ka dalë në pension që në vitin 1994 dhe ka qenë e punësuar nga muaji dhjetor 2014 e në vijim me pagë minimale, ndërkohë investimet në pasuri të paluajtshme i ka kryer nga viti 2015 e në vijim; (3) sipas deklaramit të subjektit, ajo ka blerë apartamentin në Tiranë për djalin e saj A.K., i cili ka kontribuar financiarisht, por ky shtetas nuk figuron si palë në kontratën e porosisë dhe nuk ka burime financiare të ligjshme për blerjen e këtij apartamenti; si dhe (4) ka në pronësi dy vendparkime, njërin në Tiranë dhe tjetrin në Berat, ndërkohë që nuk zotëron automjet.

**5.54.** Më tej, Komisioni çmon se faktet dhe provat e administruara gjatë hetimit nuk japin informacion mbi marrëdhënien e shtetasit A.K., kunati i subjektit të rivlerësimit, me këtë apartament të blerë në Tiranë, duke pasur parasysh se: (i) ky shtetas jeton në Itali që nga viti 2001; (ii) nuk e ka përdorur ndonjëherë apartamentin në Tiranë ; (iii) nuk është blerës i këtij apartamenti dhe prezumohet që nuk ka të drejta pronësie mbi të (ky shtetas ka udhëtuar 2 herë drejt Shqipërisë në vitin 2016, kohë kur është blerë apartamenti), pra, kishte mundësi të nënshkruante kontratën e porosisë; si dhe (iv) ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për blerjen e këtij apartamenti. Pra, në analizë të sa më lart, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë marrëdhënien e kunatit të tij/A.K., me këtë apartament.

**5.55.** Në analizë të fakteve dhe rrethanave të referuara më lart, Komisioni çmon se sjellja/marrëdhënia e subjektit të rivlerësimit me apartamentin në Rr. “\*\*\*\*”, Tiranë, është si të ishte pronar i saj dhe në funksion të tij (duke pasur parasysh se do të ushtronte funksionin e prokurorit në Tiranë), ndërkohë që sjellja/marrëdhënia e vjehrrës së subjektit të rivlerësimit dhe e kunatit të subjektit/A.K., nuk duket aq e afërt dhe në funksion të tyre.

**5.56. Si konkluzion,** Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk arriti t’i provojë trupit gjykues të kundërtën e rezultateve të hetimit, duke pasur parasysh se subjekti i rivlerësimit nuk provoi: (i) marrëdhënien e vjehrrës dhe kunatit të tij me apartamentin; (ii) burimet e ligjshme financiare të vjehrrës dhe kunatit për blerjen e këtij apartamenti; si dhe (iii) nevojën e vjehrrës dhe kunatit për të kryer këtë investim në Tiranë, duke u gjendur në parashikimet e pikës 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

## **6. Përdorimi i katit të dytë të banesës së prindërve, në lagjen “\*\*\*\*”, Berat**

**6.1 Në pyetësorin standard,** subjekti ka deklaruar se ka në përdorim pa qira banesën e prindërve të tij, gjatë gjithë periudhës së deklaramit. Gjithashtu, në pyetësorin nr. 3, subjekti ka deklaruar se ka jetuar me prindërit e tij dhe që prej vitit 2005 pjesë e familjes është bërë edhe bashkëshortja e tij e më pas fëmijët T., dhe I.A., duke pasur ekonomi të përbashkët deri në vitin 2014.

**6.2** Në deklaratat periodike vjetore dhe në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar vetëm adresën e banimit në apartamentin e prindërve në Berat, ndërkohë që përdorimi i kësaj pasurie nuk është deklaruar as në deklaratat periodike vjetore dhe as në deklaratën *Vetting*.

**6.3** Nga hetimi i Komisionit, referuar përgjigjes së administruar nga OSHEE-ja<sup>69</sup>, në emër të z. B.A., identifikohen dy kontrata furnizimi me energji elektrike në instancën e Beratit, me këto të dhëna: adresa “\*\*\*\*”, instaluar në datat 13.4.2005 dhe 31.5.2005. Gjithashtu, rezulton se në emër të subjektit, identifikohet një kontratë furnizimi me energji elektrike në instancën e Beratit, me këto të dhëna: adresa “\*\*\*\*”, instaluar në datën 13.4.2005. Ky fakt është deklaruar dhe nga subjekti në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në datën 17.3.2016, duke specifikuar se në banesën në pronësi të babait janë lidhur dy matësa energjie dhe njëra kontratë është në emrin e subjektit, tjetra në emër të prindërve të tij.

**6.4** Në pyetësin nr. 5<sup>70</sup>, subjektit iu kërkua të paraqesë aktet mbi të cilat është regjistruar kjo kontratë furnizimi dhe në përgjigjet e tij<sup>71</sup> deklaroi se kjo kontratë energjie i përket të njëjtit objekt që kanë në pronësi prindërit e tij, me adresë lagjja “\*\*\*\*”, Berat dhe se FSHU-ja Berat nuk zotëron dokumentacion arkivor para vitit 2010.

**6.5** Komisioni, gjithashtu, kërkoi informacion në FSHU<sup>72</sup> lidhur me kontratën e furnizimit në emër të subjektit, aktet mbi të cilat është regjistruar, si dhe historiku i kontratave të furnizimit me energji elektrike. Në përgjigje<sup>73</sup>, FSHU-ja informon se nuk zotërojnë kopje të kontratave para vitit 2007, pasi furnizimi me energji elektrike mbulohej nga KESH-i.

**6.6** Në këto kushte, bazuar në: (i) jetesën e përbashkët të shpjeguar më lart; (ii) përdorimin pa kundërshtim nga subjekti të katit të dytë të banesës në pronësi të babait; (iii) denoncimin nga publiku; si dhe (iv) lidhjen e kontratës me OSHEE-në në emër të subjektit për njërin nga matësat; (v) jetesën e vazhdueshme dhe të pandërprerë të bashkëshortes dhe fëmijëve të tij në këtë banesë, Komisioni vlerësoi që analiza financiare për periudhën 1.1.2004 – 31.12.2014, të kryhet për pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit, personave të lidhur dhe prindërve të tij.

#### **a. Lidhur me pasuritë e paluajtshme të prindërve**

**6.7** Sipas dokumentacionit të administruar nga ASHK-ja Berat<sup>74</sup>, rezultoi se në emër të z. B.A., janë të regjistruara pasuritë: (i) nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, e llojit apartament, me sip. 90 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, Berat; (ii) nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, e llojit apartament, me sip. 124 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, Berat; (iii) nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, e llojit truall, me sip. 41.30 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, Berat.

**6.8** Sipas akteve bashkëlidhur, me kontratën nr. \*\*\*, datë 14.2.1998, z. B.A., ka blerë pasurinë banesë të përbërë nga tri dhoma të larta dhe korridor, dy dhoma poshtë, kuzhinë me oborr, e ndodhur në lagjen “\*\*\*\*”, Berat, në vlerën 1.200.000 lekë<sup>75</sup>. Komisioni konstaton se

<sup>69</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 29.10.2020.

<sup>70</sup>E-mail datë 14.10.2020, ora 10:49.

<sup>71</sup>E-mail datë 18.10.2020, ora 23:41.

<sup>72</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 7.10.2020.

<sup>73</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 16.10.2020.

<sup>74</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 4.12.2019.

<sup>75</sup>[...] nga të cilat blerësi ka dorëzuar shumën prej 1.000.000 lekë dhe pjesa e mbetur prej 200.000 lekë, do të paguhet në datën 31.10.1997. Me anë të deklaratës nr. \*\*\*, datë 12.9.1997, palët deklarojnë së me kontratën e shitjes nr. \*\*\*, datë 29.8. (nuk evidentohet saktë viti), është shitur banesa në shumën 1.200.000 lekë, prej të cilave ditën e lidhjes së kontratës, janë shlyer 1.000.000 lekë dhe diferenca prej 200.000 lekësh u likuidua në datën 12.9.1997, ditën e hartimit të kësaj deklaratë. Pas këtij momenti blerësi bëhet pronar i plotë i kësaj banese [...].



pasuria objekt shitje e ka origjinën ½ pjesë nga trashëgimia dhe ½ pjesë nga dhurim (kontratë dhurimi nr. \*\*\*, datë 6.4.1992).

**6.9** Më tej, nga hetimi i Komisionit<sup>76</sup> rezulton se z. B.A., është aplikues me nr. \*\*\*, datë 16.10.2014, për përfshirjen në procedurat e legalizimit lidhur me ndërtimin shtesë në lartësi, të ngritur në vitin 2013. Në deklaratën e plotësuar është deklaruar “shtesë në lartësi në ndërtim me leje”, nga fotot bashkëlidhur evidentohet një ndërtesë me tri kate. Sipas dokumentacionit të administruar, ky aplikues nuk është pajisur me leje legalizimi.

**6.10** Komisioni analizoi faktin e ndërtimit pa leje nga babai i subjektit dhe deklarin si të tillë në vitin 2013. Referuar ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, dhe ndryshimeve në vitin 2013, përcaktohet se: “... *ky ligj mund të zbatohet për objektet e ndërtuara pa leje, të ngritura pas hyrjes në fuqi të ligjit, vetëm në rast se për to procedura e legalizimit nuk kërkon kalim pronësie mbi truallin*”. Komisioni vëren se ndryshimet e bëra në Kodin Penal, në vitin 2008, me ligjin nr. 10 023, e konsiderojnë ndërtimin pa leje si ndërtim të paligjshëm, ku në përputhje me nenin 199/a të Kodit Penal ndëshkohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.

**6.11** Në pyetësin nr. 4, Komisioni i ka kërkuar subjektit të paraqesë dokumentacion në lidhje me fitimin e pronësisë së pasurive: apartament me sip. 90 m<sup>2</sup>, apartament me sip. 124 m<sup>2</sup>, truall me sip. 41.30 m<sup>2</sup>, koordinatat e objektit në *google maps*, nëse janë kryer investime (periudha, vlera) shoqëruar me dokumentacion justifikues ligjor lidhur me të ardhurat që kanë shërbyer si burim.

**6.12** Në përgjigje, subjekti deklaron se që nga blerja e kësaj pasurie në vitin 1997, dhe deri në vitin 2014, janë kryer investime në kohë të ndryshme me të ardhura nga pagat, biznesi dhe kredi bankare. Subjekti shpjegon se në vitin 2013 prindërit e tij kanë kryer rikonstruksion dhe shtesë në lartësi të objektit, punime të cilat arrijnë vlerën rreth 2.000.000 (dy milionë) lekë<sup>77</sup>.

**6.13** Bazuar në udhëzimin nr. 1, datë 8.5.2013, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave”, rezulton se në Berat, kostoja mesatare e ndërtimit ka qenë në vlerën 30.900 lekë/sipërfaqe ndërtimi dhe, për rrjedhojë, vlera e investimit do të ishte 3.831.600 lekë (124 m<sup>2</sup> x 30.900 lekë). Referuar këtij udhëzimi, në kushtet e mungesës së dokumentacionit ligjor justifikues (faturë apo situacion), si dhe duke vërejtur në fotot e vëna në dispozicion nga subjekti se banesa trikatëshe i kapërcen kufijtë e një ndërtimi modest, Komisioni mori në konsideratë për efekt të analizës financiare shumën 3.831.600 lekë.

**6.14** Në pyetësin standard, subjekti ka dorëzuar shkresën nr. \*\*\* prot., datë 1.12.2017, sipas së cilës, në përgjigje të kërkesës nr. \*\*\*, datë 1.12.2017, të z. B.A., citohet se objektet në lidhje me pasuritë e ndodhura në z. k. \*\*\* (ku ndodhet shtëpia e prindërve të subjektit) aktualisht nuk po kryhen veprime, pasi kjo zonë është në proces të regjistrimit fillestar dhe futjen e kësaj zone në sistem.

## **b. Në lidhje me të ardhurat**

<sup>76</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 23.9.2020, nga ASHK-ja Berat.

<sup>77</sup>Subjekti ka dorëzuar një listë me materiale në shumën totale 1.361.000 lekë, pa numër rendor (apo serial), nënshkruar nga \*\*\* sh.p.k.

**6.15** Subjekti deklaron se të ardhurat e prindërve për fitimin e pronësisë dhe investimet e kryera në vite në këtë pasuri përbëhen nga shitja e banesës së përfitur nga privatizimi në vitin 1993, pagat e punësimit në shtet për të dy prindërit, biznesi “kancelari”, në të cilin është vetëpunësuar nëna e tij prej vitit 2012 e në vazhdim, të ardhurat nga biznesi që kanë administruar prindërit në vitet 1995 – 1996, në shoqërinë “\*\*\*\*” me objekt veprimtarie “tregtim artikuj me shumicë”, pensionet e të dy prindërve njëkohësisht edhe punësimi privat aktual<sup>78</sup>. Gjithashtu, subjekti sqaron se nëna e tij, znj. Sh.A., prej vitit 1987 e deri në vitin 1994, ka ushtruar aktivitet tregtar, shitëse fruta-perime, me dyqan në Merkaton Qendrore Berat.

**6.16** Për sa i përket të ardhurave nga shitja e apartamentit të përfitur me privatizim, Komisioni vëren se me anë të kontratës për privatizimin e banesës, datë 8.7.1993 dhe kontratës së shites datë 22.9.1993, shtetasit B., Sh., dhe A.A., kanë përfitur banesën në vlerën 2.234 lekë. Kjo banesë është shitur me anë të kontratës nr. \*\*\*, datë 28.8.1997, në shumën 700.000 lekë.

**6.17** Për sa i përket të ardhurave përpara periudhës 1987 – 1993, në vijim të përgjigjes së pyetësorit nr. 4, në datën 30.9.2020, subjekti ka dorëzuar dosjen e pensionit dhe librezën e punës të nënës së tij, ku në këtë të fundit evidentohet se në datën 30.10.1991 është shënuar “*kalon në njësi private*”.

**6.18** Komisioni, duke u bazuar edhe në arsyetimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit<sup>79</sup>, vëren se mungesa e informacionit lidhur me shumën e të ardhurave të prindërve të subjektit të rivlerësimit përpara vitit 1992, nuk e ndikon analizën financiare.

**6.19** Për sa i përket të ardhurave të prindërve, në përgjigje të pyetësorit nr. 4, subjekti dorëzoi dokumentacion justifikues<sup>80</sup> nga ku rezulton se për periudhën 2004<sup>81</sup> – 2014<sup>82</sup> të ardhurat e babait nga punësimi kanë qenë në vlerën 4.716.368 lekë dhe të ardhurat e nënës nga pensioni kanë qenë në vlerën 1.494.050 lekë<sup>83</sup>.

---

<sup>78</sup>Vërtetim nga Sigurimet Shoqërore Dega Berat, vërtetim page për z. B.A., shkolla jopublike “\*\*\*\*”, kontratë privatizimi dhe shitje të banesës së përfitur në vitin 1993, kontratën e shitblerjes së pasurisë aktualisht në pronësi të z. B.A.

<sup>79</sup>Vendim nr. 19-2019 (JR), datë 26.7.2019, [...] *trupi gjykues vëren se të ardhurat e përfituara nga individët në Shqipëri deri në vitin 1992, për shkak të krizës drastike financiare që kaloi vendi atë vit për shkak të ndryshimeve të natyrës politike, janë të papërfillshme, për shkak të inflacionit deri në 400 për qind (%) që kaloi ekonomia shqiptare. Si rrjedhojë, shkresat e sjella nga subjekti i rivlerësimit për të vërtetuar kursime të konsiderueshme, përbëjnë prova të cilat ndonëse të rregullta dhe të besueshme, kërkojnë të provojnë një pretendim, i cili bie ndesh me fakte të njohura botërisht dhe informacionin zyrtar. Për pasojë, këto shkresa u çmuan me vlerë provuese të kufizuar në kontekstin e rivlerësimit dhe pa efekt në vendimmarrjen e trupit gjykues [...].*

<sup>80</sup>Dorëzuar në pyetësorin nr. 4: (1) të dhëna për bazën e vlerësuar të indeksuar në vite për z. B.M.A., periudha shtator 1968 – maj 2015; (2) vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 8.6.2020 për të ardhurat nga pensioni për znj. Sh.A., periudha 1.9.1992 – 30.6.2020; (3) vërtetim për vjetërsinë në punë për efekt pensioni nr. \*\*\* prot., datë 24.4.2020 për znj. Sh.Gj.; (4) vërtetim për bazën e vlerësuar nr. \*\*\* prot., datë 9.7.2020; (5) të dhëna nga ISSH, Drejtoria Rajonale Berat, datë 22.9.2020, mbi derdhjen e kontributeve për shtetasit Sh., dhe B.A., firma \*\*\*, dosje e mbyllur nr. \*\*\*; (6) vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 21.9.2020 për punësimin e z. B.A., si drejtor pranë shkollës “\*\*\*\*” për periudhën 2015-2020; (7) vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 8.6.2020 për të ardhurat nga pensioni për z. B.A., periudha 3.6.2015-30.6.2020. Dorëzuar në pyetësorin nr. 5:(1) të dhëna nga ISSH, Drejtoria Rajonale Berat, për të ardhurat *bruto* dhe ndalesat e sigurimeve shoqërore për z. B.M.A., për periudhën 1995-2012; (2) vërtetim i lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Berat për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shtetërore e shëndetësore për individin për periudhën 2013 – 2014. Të ardhurat *neto* u përlogaritën duke zbritur nga paga *bruto*: (1) ndalesat për sigurimet të paraqitura në tabelë dhe (2) ndalesat për tatimin mbi të ardhurat të llogaritura sipas legjislacionit në fuqi për secilin vit.

<sup>81</sup>Viti në të cilin subjekti ka filluar detyrën si Oficer i Policisë Gjyqësore.

<sup>82</sup>Viti i fundit gjatë të cilit subjekti ka pasur ekonomi të përbashkët me prindërit e tij.

<sup>83</sup>Shkresë nr. \*\*\*, datë 21.10.2020, nga ISSH Drejtoria Rajonale Berat, për të ardhurat për çdo vit kalendarik.

**6.20** Për sa i përket të ardhurave të prindërve nga aktiviteti tregtar, QKB-ja<sup>84</sup> informon se shtetasja Sh.K.A., e datëlindjes 1.9.1947, figuron e regjistruar si Person Fizik më 11.1.2012, e pajisur me NIPT \*\*\*. Më tej, Drejtoria Rajonale Tatimore Berat<sup>85</sup> informon lidhur me qarkullimin dhe fitimin e tatueshëm *neto* për periudhën 2014 – 2018, ku për vitin 2014 rezulton që fitimi *neto* të ketë qenë në vlerën 242.728 lekë. Lidhur me fitimin e mundshëm gjatë periudhës 2012-2013, Komisioni iu drejtua Bashkisë Berat, e cila në përgjigjen<sup>86</sup> e saj konfirmoi se Personi Fizik Sh.A., nuk ka bërë deklaram të qarkullimit për periudhën 2012 – 2013 dhe në mungesë të këtij informacioni, Bashkia Berat ka bërë parashikim të qarkullimit 0-2 milionë lekë. Në vijim, Komisioni përlllogariti shumën 242.728 lekë si fitim nga aktiviteti tregtar, duke e ndarë në mënyrë përpjesëtimore, konkretisht: shumën 131.478 lekë për periudhën 1.1.2005 – 14.7.2014; dhe shumën 111.250 lekë për periudhën 15.7.2014 – 31.12.2014.

Për sa i përket automjeteve në pronësi të babait të subjektit, referuar dokumentacionit të administruar nga DRSHTRR-ja Tiranë<sup>87</sup>, nuk ka të dhëna, ndërkohë nga hetimi i Komisionit, rezulton se z. B.A., ka pasur në pronësi këto automjete: (i) automjeti tip “BMW” me targa \*\*\*, blerë me anë të kontratës nr. \*\*\*, datë 25.6.2014, në vlerën 500.000 lekë (vlerë e cila u përfshi në analizën financiare) dhe më pas shitur me kontratën nr. \*\*\*, datë 7.11.2016, me çmim 7.000 euro. Nga kontrolli i kryer në AMF rezulton se ky automjet ka qenë i regjistruar në emër të z. B.A.; (ii) automjeti tip “NISSAN” me targa \*\*\*, blerë me anë të kontratës nr. \*\*\*, datë 10.12.2011, me çmim 400.000 lekë (vlerë e cila u përfshi në analizën financiare). Nga kontrolli i kryer në AMF nuk rezultojnë të dhëna për këtë automjet. Ndërkohë sipas dokumentacionit të administruar nga përgjigjet e noterëve<sup>88</sup>, rezultojnë dy kontrata shitjeje për këtë automjet: (1) kontrata nr. \*\*\*, datë 27.3.2012, sipas së cilës, shitësi B.A., ia ka shitur këtë automjet blerësit K.D., në shumën 300.000 lekë; (2) kontrata nr. \*\*\*, datë 3.6.2014, sipas së cilës, shitësi B.A., ia ka shitur këtë automjet blerësit A.N., në shumën 500.000 lekë.

**6.21** Për sa i përket **automjeteve në pronësi të babait të subjektit**, referuar dokumentacionit të administruar nga DRSHTRR-ja Tiranë<sup>89</sup>, nuk ka të dhëna, ndërkohë nga hetimi i Komisionit, rezulton se z. B.A., ka pasur në pronësi këto automjete: **(i) automjet tip “BMW” me targa \*\*\***, blerë me kontratën nr. \*\*\*, datë 25.6.2014, në vlerën 500.000 lekë (*vlerë e cila u përfshi në analizën financiare*) dhe më pas është shitur me kontratën nr. \*\*\*, datë 7.11.2016, me çmim 7.000 euro. Nga kontrolli i kryer në AMF, rezulton se ky automjet ka qenë i regjistruar në emër të B.A.; **(ii) automjet tip “Nissan” me targa \*\*\***, blerë me anë të kontratës nr. \*\*\*, datë 10.12.2011, me çmim 400.000 lekë (*vlerë e cila u përfshi në analizën financiare*). Nga kontrolli i kryer në AMF, nuk rezultojnë të dhëna për këtë automjet. Ndërkohë sipas dokumentacionit të administruar nga përgjigjet e noterëve<sup>90</sup>, rezultojnë dy kontrata

<sup>84</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., 28.10.2019.

<sup>85</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., 29.10.2019.

<sup>86</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., 22.10.2020.

<sup>87</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 11.11.2019 dhe nr. \*\*\* prot., datë 5.11.2019.

<sup>88</sup>Shkresë protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 20.5.2020 dhe shkresa protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 24.9.2020.

<sup>89</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 11.11.2019 dhe nr. \*\*\* prot., datë 5.11.2019.

<sup>90</sup>Shkresë protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 20.5.2020 dhe shkresa protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 24.9.2020.

shitjeje për këtë mjet: (1) kontrata nr. \*\*\*, datë 27.3.2012, sipas së cilës, shitësi B.A., ia ka shitur këtë mjet blerësit K.D., në shumën 300.000 lekë; (2) kontrata nr. \*\*\*, datë 3.6.2014, sipas së cilës, shitësi B.A., ia ka shitur këtë mjet blerësit A.N., në shumën 500.000 lekë; **(iii) automjet tip “BMW” me targa \*\*\*, blerë me kontratën nr. \*\*\*, datë 4.4.2017, në vlerën 2.500 euro dhe më pas shitur me kontratën nr. \*\*\*, datë 9.6.2017, me çmim 5.500 euro.** Nga kontrolli i kryer në AMF, ky automjet nuk rezulton të ketë qenë i regjistruar në emër të B.A., *(ky automjet rezulton të jetë blerë pas periudhës së jetesës së përbashkët me subjektin).*

**6.22 Sa më sipër,** Komisioni kreu analizën financiare për pasuritë, detyrimet, të ardhurat e shpenzimet e subjektit të rivlerësimit, personave të lidhur dhe prindërve të tij, për: (i) vitin 2004 (vit në të cilin subjekti ka kryer deklaram vjetor si Oficer i Policisë Gjyqësore); (ii) për periudhën 1.1.2005 – 14.7.2014 (duke qenë se deklarata para fillimit të detyrës mban datën 15.7.2014); dhe (iii) për periudhën 15.7.2014 – 31.12.2014 (për shkak se subjekti ka deklaruar se deri në vitin 2014 ka pasur ekonomi të përbashkët me prindërit).

**6.23** Për periudhën 1.1.2005 – 14.7.2014, rezultoi një balancë negative në shumën - 2.411.610 lekë për subjektin dhe personat e lidhur, në shumën -2.907.287 lekë për prindërit e subjektit, pra, në total në shumën -5.318.897 lekë

**6.24 Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës,** Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: (i) *subjekti nuk ka bërë deklaram të saktë lidhur me përdorimin e kësaj pasurie në DPV-të vjetore dhe në deklaratën Vetting; dhe (ii) duket se prindërit e subjektit kanë mungesë burimesh të ligjshme në vlerën 2.907.287 lekë, gjatë viteve 2005 – 2014, për investimin e kryer në banesën e përdorur nga subjekti.*

**6.25 Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet dhe provat me shkrim dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës, deklaroi se:** në lidhje me mosdeklarimin e kësaj banese në përdorim, nëse e ka deklaruar si adresë banimi atëherë është e kuptueshme që kjo banesë është në përdorim.

**6.26 Në lidhje me mungesën e burimit të ligjshëm nga prindërit e subjektit, u shpreh se:** për sa i përket investimit të kryer në banesë nga prindërit e tij, vlera të cilës i referohet Komisioni, është shumë më e lartë se vlera reale e investimit. Subjekti pretendon se prindërit e tij kanë ndërtuar një shtesë në lartësi dhe jo ndërtim të ri, pa themele, pa kolona mbajtëse, beton-arme etj.

**6.27** Gjithashtu, subjekti sqaron se deri në vitin 2014, viti në të cilin është kryer analiza financiare e prindërve të tij, ky ndërtim ka qenë i përfunduar si karabina por jo funksional pasi nuk kishin përfunduar instalime elektrike, hidraulike, shtrim dysheme, etj... Kjo provohet edhe nga tabela fotografike që gjendet në dosjen e ALUIZNI-t Berat, të cilat Komisioni i zotëron.

**6.28** Për këtë arsye, pretendon subjekti, në analizën financiare të kryer nga Komisioni për periudhën 2005 – 2014, duhet të ndryshohet shuma 3.831.600 lekë për investimin në banesën e prindërve dhe të zëvendësohet me shumën 2.000.000 lekë, që është investimi real deri në vitin 2014.

**6.29** Subjekti, më tej, pretendon se babai B.A., ka blerë pranë shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. materialet e listuara në shumën totale 1.361.000 lekë. Kjo përmbledhëse tregon sasinë e materialeve sipas përshkrimit me çmimin përkatës të blerjes. Nuk është një situacion, pasi situacioni ka furnizim vendosje, ka edhe vlerë pune të përfshirë, por është një dokument që tregon të gjithë materialet që babai i subjektit ka blerë pranë shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. që kanë shërbyer për ndërtimin e sipërfaqes 124 m<sup>2</sup>. Lista përmban data kur është bërë furnizimi me materialet përkatëse. Dy kolonat e para tregojnë datën dhe muajin, kurse në kokë të dokumentit është viti kur janë bërë furnizimet. Furnizimi i parë i kryer, mban datën 26.8.2013 dhe vazhdon në ditët në vazhdim deri në furnizimin e fundit që mban datën 11.12.2013.

**6.30** Gjendja e ndërtimit ka qenë në fazë karabina, vërtetuar edhe me fotografitë që disponohen në dosjen e ALUIZNI-t dhe në kërkesën e paraqitur me nr. \*\*\* prot., datë 16.10.2014, për përfshirjen në procedurat e legalizimit lidhur me ndërtimin në lartësi, ndërtuar në vitin 2013. Përputhen datat sipas listës së materialeve të blera me deklarin në ALUIZNI. Ndërtimi në karabina është 70% e kostos së ndërtimit. Kosto në vlerën 30.900 lekë sipas EKB-së përmban në strukturën e saj disa elementë, të cilat nuk mund të jenë pjesë përbërëse e kostos për ndërtime informale, si TVSH, fond rezervë, fitim, kosto krahut të punës, etj. Nëse Komisioni do të merrte në konsideratë që ndërtimi në fazën karabina zë një peshë sa 70% e kostos dhe duke zbritur nga çmimi për metër katror, sipas kostos së përcaktuar prej Entit Kombëtar të Banesave, shumatoren e vlerave që përfaqësojnë TVSH + Fitim + Fond rezerve 25%<sup>91</sup>, përllogaritjet do të ishin: 124 m<sup>2</sup> \* 30.900 lekë/metër \* 70% \* 75%, vlera që rezulton 2.011.590 lekë ; 70% është pesha specifike që zë faza karabina në koston e ndërtimit; 75% është kosto mbas zbritjes me 25 % të vlerave TVSH dhe fond rezervë. Neni 12/1, i ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin e disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, parashikon se: *“Karabina është objekti i ndërtuar plotësisht në volum dhe në formë, sipas kushteve urbanistike të miratuara për konstruksionin dhe muraturen e plotë të objektit”*. Duke mbajtur në konsideratë parashtrimet më lart, vlera e investimit deklaruar sipas subjektit në shumën 2.000.000 lekë përputhet me vlerën e përllogaritur me lartë dhe që në vlerësimin e tij Komisioni duhet ta mbajë në konsideratë.

**6.31 Në lidhje me të ardhurat e prindërve, subjekti pretendon se:** Në zërin “paga nga i ati” duhet të shtohen dhe 900.000 lekë (mesatarisht 18.000 lekë në muaj) të padeklaruara, që janë diferencë midis pagës reale dhe pagës së deklaruar për efekt të sigurimeve shoqërore për 50-muaj që ka punuar drejtor i shkollës së mesme, në shkollën private (dhjetor 2005 – janar 2010).

**6.32** Te zëri “të ardhura nga aktiviteti privat i nënës” duhet shtuar shuma prej 485.456 lekësh nga biznesi privat (kancelari) gjatë vitit 2012 dhe 2013, të cilat nuk janë përfshirë në llogarinë e Komisionit. Gjithashtu, duhet shtuar edhe shuma prej 1.512.000 lekësh të ardhurat të përfituara nga puna si shitëse në tregun e lirë për 7-vjet (2004 – 2011), me pagë minimale rreth 18.000 lekë/muaj.

**6.33** Për vitet 2012 – 2013, përllogaritja e fitimit duhet të kryhet referuar fitimit të realizuar në vitin 2014. Nga konfirmimi që DRT-ja Berat ka dhënë rezulton se fitimi *neto* më i ulët për të gjithë periudhën është në vitin 2016 në vlerën 209.101 lekë. Edhe pse Bashkia Berat deklaroi

---

<sup>91</sup> Vendimi nr.15, datë 17.7.2019, i KPA-së.

se nuk ka formular vetëdeklarimi për xhiron në periudhën 2012 dhe 2013, fitimi duhet të merret bazuar në fitimin e realizuar në vitin 2014. Personi fizik ka paguar detyrimet tatimore referuar nivelit të qarkullimit 0-2.000.000 lekë dhe si e tillë duhet të përlllogariten edhe fitimet e realizuara. Baza e vlerësimit duhet të jetë e njëjtë, për sa kohë janë përlllogaritur shpenzimet jetike duhet të përlllogariten edhe të ardhurat e realizuara. Vetë shkresa e DRT-së Berat tregon se subjekti person fizik ka një vazhdimësi të qëndrueshme në të gjitha periudhat vijuese dhe e njëjta situatë është edhe për periudhat 2012 – 2013.

**6.34** Gjithashtu, në bazë të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nga viti 2007 deri në vitin 2013 është zbatuar dispozita e nenit 11, pika 4, ku citohet: *“Niveli tregues i taksës, për çdo kategori biznesi, në varësi të qarkullimit vjetor, të ndarë sipas intervaleve prej 1 milion lekësh, duke filluar nga vlera minimale prej 2 milionë lekësh, jepen në aneksin 5, që i bashkëlidhet këtij ligji. Për bizneset me qarkullim deri në 2 milionë lekë, detyrimi fiskal tregues është i fiksuar për çdo kategori biznesi dhe nuk varet nga qarkullimi. Për bizneset me qarkullim më të madh se 2 milionë lekë deri në 8 milionë lekë në vit, detyrimi fiskal tregues është i barabartë me shumën e detyrimit për bizneset me qarkullim deri në 2 milionë lekë, shtuar me vlerën që del nga shumëzimi i madhësisë prej 1,5 për qind me vlerën në lekë të mesit të çdo intervali prej 1 milion lekësh, sipas të cilit ndahet intervali i qarkullimit 2-8 milionë lekë...”*. Referuar dispozitave ligjore për tatimpaguesit me xhiro faktike nën vlerën 2.000.000 lekë (jo xhiro e parashikuar, kërkesë e njëjtë me detyrimin për deklarim edhe për individët) nuk ishte e detyruar të dorëzonin deklaratë vjetore. Subjekti ka filluar të dorëzojë deklaratë vjetore për tatimin e thjeshtuar mbi fitimit vetëm në vitin 2014 kur ka filluar të funksionojë edhe sistemi tatimor C@TS.

**6.35 Shtëpia në Durrës** është blerë në kohën që subjekti ka pasur ekonomi të përbashkët me prindërit dhe detyrimi ndaj “Alpha Bank” duhet përfshirë në kolonën “prindërit”. Nëse në bilanc do të bëhen korrektime të mësipërme atëherë si subjekti ashtu dhe prindërit të marrë veç e veç apo edhe së bashku (gjë që do të ishte më e arsyeshme përderisa ekonomia ka qenë e përbashkët) nuk do të rezultojnë me bilanc negativ në periudhën 2005 – 2014.

**6.36** Gjithashtu, lidhur me automjetin me targa \*\*\*, për sa i përket kontratave të shitjes së tij, me sa është vënë në dijeni babai i subjektit, sqaron se kontrata e parë lidhur në datën 27.3.2012, nuk është vënë në ekzekutim, pasi blerësi ka ngritur pretendime më pas për gjendjen e automjetit. Në këtë situatë palët janë kthyer në gjendjen e mëparshme dhe automjeti është shitur përfundimisht në vitin 2014, në vlerën 500.000 lekë dhe diferenca e çmimit të blerjes me atë të shitjes prej 100.000 lekësh, duhet të llogaritet si e ardhur e ligjshme në analizën financiare.

#### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshë**

**6.37** Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në “Deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*”; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratave periodike dhe provave shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

**6.38** Përdorimi pa kundërshpërblim i kësaj banese në katin e dytë të një godite 3-katëshe në lagjen “\*\*\*\*”, Berat, në pronësi të prindërve, i përdorur nga subjekti dhe familja e tij në mënyrë të pandërprerë dhe të qëndrueshme, konsiderohet si një marrëdhënie huapërdorje, sipas parashikimeve të nenit 901 e vijues të Kodit Civil. Në këtë marrëdhënie huapërdorje përfshihet huaja që parashikon pika 4, e nenit 32, e ligjit nr. 84/2016, në të cilin parashikon se: “*Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive*”. Për rrjedhojë, kjo marrëdhënie e cila kategorizon prindërit e subjektit të rivlerësimit si persona të tjerë të lidhur për këtë pasuri dhe pasjell detyrimin e subjektit të rivlerësimit dhe personave të tjerë të lidhur për të provuar burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës, duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave, si dhe të paraqesë në mënyrë të saktë pasuritë në pronësi, zotërim ose në përdorim të tij.

**6.39** Referuar fakteve dhe provave të administruara gjatë hetimit, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar këtë banesë në deklaratën *Vetting* të vitit 2017 dhe në deklaratat periodike vjetore 2014 – 2016, detyrim ky që rrjedh nga neni D i Kushtetutës dhe neni 30 i ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në mënyrë të pasaktë pasuritë në përdorim, pasuri e cila duhet të ishte objekt i kontrollit të pasurive sipas pikës 1, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

**6.40** Pretendimi i subjektit, se fakti që e ka deklaruar si adresë banimi në DPV-të vjetore për vitet 2014, 2015, 2016 dhe në deklaratën *Vetting* të vitit 2017 atëherë është e kuptueshme që kjo banesë është në përdorim, nuk qëndron, për shkak se deklarimi i adresës së banimit në seksionin “*të dhënat personale të subjektit dhe personave të lidhur*”, ka për qëllim deklarimin e adresës së plotë të regjistruar në gjendjen civile të subjektit, adresë e cila jo gjithmonë është e njëjtë e adresën faktike ku subjekti banon. Ndërkohë që përdorimi për efekt të kontrollit, duhej të ishte deklaruar në seksionin “deklarimi i pasurisë”, duke përfshirë llojin, sipërfaqen, adresën ku ndodhet, vitin e krijimit, vlerën në lekë, [...] shumën e shpenzimeve të kryera, pjesën takuese që zotëron dhe burimet e krijimit të çdo lloj pasurie të regjistruar ose jo në regjistrat publikë në pronësi dhe në përdorim të subjektit të rivlerësimit.

**6.41** Për më tepër, nëse do të ndiqej logjika e subjektit se: “*Përderisa një adresë është deklaruar si adresë banimi është e kuptueshme se banesa është në përdorim*”, atëherë, duke iu referuar deklarimit të tij si adresë banimi të lagjes nr. \*\*\*\*, Durrës, në DIPP-në e vitit 2014 dhe të vitit 2015<sup>92</sup>, do të arrihej në konkluzionin se subjekti ka banuar pikërisht në këtë adresë. Gjithë kjo situatë do t’i bënte të pavërteta deklaratimet e subjektit gjatë hetimit dhe prapësimeve se apartamenti në Durrës nuk ka qenë në kushtet për banim.

**6.42** Në aspektin deklarativ, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në mënyrë të pasaktë pasurinë në përdorim të tij, duke u gjendur në kushtet e parashikuara në pikën 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

---

<sup>92</sup> Në pyetëtorin nr. 4, subjekti ka deklaruar se ky veprim ka qenë një lapsus i tij.

**6.43** Në lidhje me pretendimin e subjektit se kosto prej 30.900 lekë/m<sup>2</sup> për këtë ndërtim sipas EKB-së përmban në strukturën e saj disa elementë, të cilat nuk mund të jenë pjesë përbërëse e koston për ndërtime informale, si TVSH, fond rezervë, fitim, kosto krahut të punës, etj., Komisioni thekson se vlera e objektit, e përcaktuar në përfundim të hetimit administrativ, në shumën prej 3.831.600 lekësh (124 m<sup>2</sup> x 30.900 lekë), ka ardhur si pasojë e llogaritjes së kësaj vlere duke aplikuar tarifën e përcaktuara nga EKB-ja për koston mesatare të ndërtimit, e cila është aplikuar respektivisht për katin e dytë dhe të tretë. Komisioni ka ndjekur këtë metodologji për të përcaktuar vlerën e ndërtimit të këtij objekti, në kushtet kur është ndërtuar në mënyrë informale dhe subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të paraqesë dokumentacion të kohës për të provuar koston reale apo të përafërt të këtij objekti, përveç një fature furnizimi të materialeve.

**6.44** Në lidhje me pretendimin se 2 katet e shtuara kanë qenë karabina në momentin e aplikimit pranë ALUIZNI-t, Komisioni i nuk konsideroi si të zbritshme as diferencat që mund të vijnë për shkak të gjendjes së pretenduar si karabina për dy katet e fundit të banesës, duke qenë se nuk ka asnjë kriter ligjor, në referim të të cilit kjo diferencë bëhet e matshme dhe as subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur ndonjë dokumentacion ligjor që të përcaktojë këtë vlerë, për më tepër kur referuar kërkesës për legalizim për dy katet e shtuara të kësaj banese, ato nuk rezultojnë të deklaruara në statusin e karabinasë, si dhe subjekti ka deklaruar se ka jetuar me prindërit e tij dhe që prej vitit 2005 pjesë e familjes është bërë edhe bashkëshortja dhe më pas fëmijët T., dhe I.A., duke patur ekonomi të të përbashkët deri në vitin 2014. Kjo tregon se subjekti ka filluar të jetojë në katin e dytë në vitin 2014, pasi ka ndarë ekonominë familjare me prindërit.

**6.45** Në lidhje me pretendimin mbi të ardhurat e prindërve, subjekti nuk provoi me dokumentacion ligjor pretendimet e tij për të provuar të ardhura të ligjshme shtesë dhe për këtë arsye nuk u konsideruan të ardhurat e pretenduara për prindërit në përgjigje të barrës së provës.

**6.46** Në lidhje me pretendimin mbi të ardhurat gjatë periudhës 2012 – 2013 nga aktiviteti i nënës si person fizik, duke marrë në vlerësim shkresën e Bashkisë Berat<sup>93</sup>, Komisioni pasqyroj në analizën financiare të ardhura nga aktiviteti tregtar i nënës së subjektit në shumën 485.456 lekë.

**6.47** Lidhur me pretendimin për të ardhurat e tjera, si: (1) të ardhurat e babait në shumën 900.000 lekë (mesatarisht 18.000 lekë/muaj) të padeklaruara, si diferencë midis pagës reale dhe pagës së deklaruar për efekt të sigurimeve shoqërore për 50 muaj që ka punuar drejtor i shkollës së mesme, në shkollën private (dhjetor 2005 – janar 2010); dhe (2) të ardhurat e nënës në shumën 1.512.000 lekë të përfituara nga puna si shitëse në tregun e lirë për 7-vjet (2004 – 2011), me pagë minimale rreth 18.000 lekë/muaj, Komisioni vlerëson se ky pretendim nuk mund të merret në konsideratë, për sa kohë subjekti nuk paraqiti asnjë dokumentacion ligjor justifikues për të mbështetur deklaratimet e tij.

**6.48** Për sa i përket të ardhurave nga shitja e automjetit me targa \*\*\*, Komisioni mori në konsideratë kontratën nr. \*\*\*, datë 3.6.2014, me çmim shitje 500.000 lekë dhe paraqiti në analizën financiare vetëm vlerën e të ardhura të ligjshme në shumën prej 400.000 lekësh, për

---

<sup>93</sup> Referojuni, shkresës nr. \*\*\* prot., datë 12.7.2017, në dosjen e ILDKPKI-së.



sa kohë nuk u provua pagesa e detyrimeve tatimore për diferencën midis çmimit të shitjes me çmimin e blerjes.

**6.49** Në përfundim të analizës së të ardhurave të ligjshme, Komisioni konkludon se prindërit e subjektit të rivlerësimit në cilësinë e personave të tjerë të lidhur kanë mungesë burimesh të ligjshme në vlerën -2.021.831 lekë, për periudhën 2005 – 2014, për investimin e kryer në banesën e përdorur nga subjekti.

**6.50 Në konkluzion të kontrollit të kësaj pasurie**, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin, apartamentin në përdorim në katin e dytë të banesës së prindërve dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për ndërtimin e saj, duke u gjendur në parashikimet e germës “a” dhe “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

## **7. Automjet në përdorim “BMW tip X5”, me targa \*\*\* (\*\*\*)**

**7.1 Në deklaratën Vetting të vitit 2017**, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Automjet i marrë në përdorim nga shtetasi E.L., nëpërmjet aktit noterial prokurë e posaçme nr. \*\*\*, datë 29.9.2016*”.

**7.2** Subjekti për vërtetimin e deklarimeve të tij ka paraqitur dokumentacion ligjor provues<sup>94</sup>.

### **Nga hetimi i Komisionit konstatohet se:**

**7.3 Në pyetësorin standard**, subjekti deklaron se gjatë periudhës së deklaramit, për disa muaj, ka pasur në përdorim pa qira, me prokurë të posaçme nr. \*\*\*, datë 29.9.2016, automjetin me targa \*\*\*, pronë e mikut të tij, z. E.L., banues në \*\*\*/Berat.

**7.4** Referuar dokumentacionit të administruar nga DRSHTRr-ja Tiranë<sup>95</sup>, konfirmohet se në emër të shtetasit E.L., ka qenë i regjistruar automjeti me targa \*\*\* (\*\*\*). Gjithashtu, nga kontrolli i kryer në AMF, rezulton se ky automjet ka qenë në pronësi të këtij shtetasi. Blerë në datën 4.9.2016, në shumën (2.600 euro\* 136.18) 354.068 + 76.259 = 430.327 lekë. Më pas i është shitur me kontratën nr. \*\*\*, datë 9.10.2017, palës blerëse “\*\*\*\*” sh.p.k. në çmimin 17.400 euro<sup>96</sup>.

**7.5** Sipas prokurës së posaçme nr. \*\*\*, datë 29.9.2016, shtetasi E.L., cakton si përfaqësues të posaçëm të tij subjektin e rivlerësimit, të cilit i jep të drejta dhe kompetenca të plota që ta përfaqësojë në çdo zyrë noterie si palë shitëse ose dhuruese e automjetit në pronësi të tij, tipi X5, marka “BMW”, targa \*\*\*. Subjekti ka të drejtën që të kalojë këtë automjet edhe në pronësinë e tij. Më anë të kësaj deklarate në datën 29.9.2016, shtetasi E.L., i ka dorëzuar subjektit automjetin dhe dokumentacionin përkatës, si dhe e ka autorizuar ta përdorë brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, deri në shitjen e tij.

<sup>94</sup> Prokurë e posaçme nr. \*\*\*, datë 29.9.2016.

<sup>95</sup> Shkresat nr. \*\*\* prot., datë 11.11.2019 dhe nr. \*\*\*, datë 5.11.2019

<sup>96</sup> Sipas kontratës, likuidimi i çmimit do të bëhet nëpërmjet kontratës së sipërmarrjes për prenotim apartamenti nr. \*\*\*, datë 9.10.2017, nga shitësi E.L., te shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k.

**7.6** Në pyetësoin nr. 2<sup>97</sup>, subjekti është pyetur se cila është marrëdhënia e tij me shtetasin E.L., nëse e ka deklaruar përdorimin e automjetit si përfitim financiar, si dhe nëse ka trajtuar ndonjë çështje me palë këtë shtetas. Në përgjigje<sup>98</sup> subjekti deklaroi se nuk ka pasur asnjë përfitim financiar nga përdorimi i automjetit të shtetasit E.L. Ata janë shokë fëmijërie e më pas miq familje, miqësi të cilën vazhdojnë ta kenë edhe sot, si dhe nuk ka trajtuar asnjë çështje me palë këtë shtetas apo subjektin tregtar “\*\*\*” sh.p.k., të cilin e administron.

**7.7** Nga hetimi i Komisionit<sup>99</sup>, nuk u provua qenia e subjektit të rivlerësimit, në kushtet e konfliktit të interesit<sup>100</sup> me shtetasin E.L.

**7.8** Nga hetimit administrativ kryesisht në lidhje me këtë pasuri nuk u konstatuan problematika të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit të subjektit.

**7.9 Si konkluzion**, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin këtë automjet.

## **8. Libreze kursimi në emër të I.A., në vlerën 10.379,5 lekë**

**8.1 Në deklaratën Vetting të vitit 2017**, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar librezë kursimi në emër të I.A.A., hapur në datën 10.10.2013 dhe me gjendje aktuale në vlerën 10.379,5 lekë. Subjekti nuk ka deklaruar burim krijimi. Për vërtetimin e deklaramëve të tij, ka paraqitur dokumentacion ligjor provues<sup>101</sup>.

**8.2 Nga hetimi i Komisionit konstatohet se:** “Alpha Bank”<sup>102</sup> konfirmon se I.A., ka llogari bankare në “Alpha Child Dream”, me gjendje në vlerën 10.379,50 lekë në datën 26.1.2017

**8.3** Nga hetimit administrativ kryesisht në lidhje me këtë pasuri nuk u konstatuan problematika të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit të subjektit.

**8.4 Si konkluzion**, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin për këtë automjet.

## **9. Automjetet e bashkëshortes së subjektit**

**(i) Automjet tip “Ford Focus”, më targa \*\*\*, në emër të bashkëshortes (blerë në vitin 2014, shitur më 2017)**

**9.1 Në deklaratën Vetting të vitit 2017, bashkëshortja e subjektit deklaroi:** “Automjet veturë e markës “Ford Focus”, viti 2003, me vlerë 200.000 lekë. Pjesa takuese: 100%”.

**9.2 Si burim krijimi**, subjekti deklaroi kursime nga paga.

**9.3** Për të provuar deklaramet e tij, subjekti ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor.<sup>103</sup>

<sup>97</sup> E-mail datë 28.1.2020, ora 16:41.

<sup>98</sup> E-mail datë 31.1.2020, ora 14:42.

<sup>99</sup> Shkresat nr. \*\*\*, datë 21.9.2020; nr. \*\*\*, datë 21.9.2020; dhe shkresë nr. \*\*\*, datë 21.9.2020.

<sup>100</sup> Shkresat nr. \*\*\*, datë 22.9.2020; nr. \*\*\*, datë 12.10.2020; dhe nr. \*\*\*, datë 26.10.2020.

<sup>101</sup> Kopje e librezës së kursimeve të Arben Allajbeu, I.A., pranë Alpha Bank, çelur në datën 10.10.2013 me balancë 10.000 lekë.

<sup>102</sup> Shkresë nr. \*\*\*, datë 2.7.2020.

<sup>103</sup> Kontratë shitje makine nr. \*\*\*, datë 31.3.2014, deklarata e zhdoganimit të automjetit Ford Focus, datë 27.7.2012.

**9.4 Nga hetimi i Komisionit konstatohet se** në deklaratën para fillimit të detyrës vitit 2014, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar automjet tip “Ford Focus”, viti 2003, me vlerë 200.000 lekë, burimi i krijuar nga pagat në 12 vjet punë.

**9.5 Referuar dokumentacionit të administruar nga DRSHTRR-ja Tiranë<sup>104</sup>,** në emër të personit të lidhur ka qenë i regjistruar automjeti tip “Ford Focus,” me targa \*\*\*.

**9.6 Sipas kontratës së shitjes nr. \*\*\*,** datë 31.3.2014, personi i lidhur, znj. E.A., ka blerë këtë automjet në vlerën 200.000 lekë. Ky automjet është shitur me kontratën nr. \*\*\*, datë 16.11.2017, me çmim 250.000 lekë.

**9.7 Komisioni vëren se automjeti është shitur pas 3 vjet e gjysmë me një diferencë prej 50.000 lekësh më shumë nga çmimi i blerjes, duke llogaritur edhe koston e amortizimit të mjetit.** Me anë të pyetësorit nr. 5<sup>105</sup>, subjektit iu kërkuan shpjegime lidhur me sa konstatohet, në përgjigje<sup>106</sup> subjekti deklaroi se që nga momenti i blerjes dhe deri në shitjen e tij, ky automjet nuk ka pasur thuar fare amortizim. Në momentin e blerjes çmimi është vlerësuar si një rast okazion. Është blerë me qëllim përdorimin prej bashkëshortes, por, më pas, është vlerësuar të shitet, pasi vendi i punës së saj është shumë pranë banesës së prindërve të subjektit, ku aktualisht banojmë. Subjekti në pyetësor, u pyet nëse është paguar tatimi mbi të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit të shumës 50.000 lekë dhe u kërkua të vihet në dispozicion dokumentacion ligjor justifikues. Në përgjigje subjekti deklaroi se në periudhën e shitjes së këtij mjeti edhe pse nga zyra noteriale nuk i është komunikuar ndonjë detyrim tatimor, është interesuar pranë DRT-së Berat dhe është informuar verbalisht se për personat jo subjekt tregtar nuk kishte detyrim tatimor, veç rasteve kur përfitoheshin të ardhura nga pasuri të paluajtshme dhe se në deklarin vjetor të kryer në ILDKPKI, e ka deklaruar shitjen e mjetit dhe vlerën e tij.

**9.8 Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës,** Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se *ka mungesë të dokumentacionit ligjor justifikues për pagesën e tatimit mbi të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit, në këto kushte shuma prej 50.000 lekësh përbën diferencën mes çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes.*

**9.9 Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet dhe provat me shkrim dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës, deklaroi se gjatë shitjes së automjetit në zyrën noteriale nuk ju është bërë i ditur detyrimi dhe konkretisht tatimi mbi fitimin.**

**9.10 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklarinimet e subjektit të rivlerësimit në “Deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, Vetting”; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratave periodike dhe provave shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ,**

---

<sup>104</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 11.11.2019 dhe nr. \*\*\*, datë 5.11.2019.

<sup>105</sup>E-mail datë 14.10.2020, ora 10:49.

<sup>106</sup>E-mail datë 18.10.2020, ora 23:41.

prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

**9.11** Fakti që subjekti i rivlerësimit ka përfituar të ardhura nga shitja e automjetit, Komisioni në vlerësim të parashikimeve të germës “g”, të pikës , të të nenit 8, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar<sup>107</sup>, dhe për sa kohë nuk u provua pagimi i detyrimit tatimor mbi këtë fitim, vlera e fitimit të realizuar vlerësohet si e ardhur e paligjshme në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, bazuar kjo edhe në jurisprudencën e Kolegjit dhe si e tillë nuk është marrë në konsideratë si e ardhur e ligjshme për efekt të analizës financiare.

**9.12 Si konkluzion**, këto të ardhura në vitin 2017, nuk janë marrë në konsideratë si të ardhura të ligjshme për efekt të analizës financiare të vitit 2017.

**(ii) Automjet tip “Fiat Punto”, më targa \*\*\*, në emër të bashkëshortes (blerë në 2012, shitur në 2014)**

**9.13 Më tej**, nga dokumentacioni i administruar nga DRSHTRR-ja Tiranë, rezulton se në emër të bashkëshortes së subjektit ka qenë i regjistruar edhe automjeti me targa \*\*\*. Ky automjet është blerë në vlerën 144.000 lekë, sipas faturës tatimore nr. \*\*\*, datë 17.2.2012 dhe, më tej, ky automjet është shitur me kontratën nr. \*\*\*, datë 11.4.2014, me çmim 200.000 lekë.

**9.14** Nga kontrolli i kryer në AMF, rezulton se ky automjet nuk figuron në emër të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit.

**9.15** Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në datën 17.3.2016, subjekti lidhur me këtë mjet deklaron se është blerë nga bashkëshortja në vitin 2012 në vlerën 1.100 euro dhe është shitur po atë vit. Sipas këtij procesverbali, ka paraqitur prokurën e posaçme, datë 23.6.2012, dhe sqaron se në datën 26.6.2012 është bërë likuidimi prej blerësve ndërmjet “Alpha Bank”, në vlerën 240.000 lekë.

**9.16** Në dokumentacionin e përcjellë nga “Alpa Bank”, konstatohet se në datën 26.6.2012 është depozituar *cash* në llogarinë e subjektit dhe bashkëshortes shuma prej 240.000 lekësh me përshkrim “*derdhje nga B.L., në llogari të A.A.,*”.

**9.17** Komisioni vëren se ka mospërputhje lidhur me dokumentacion e administruar gjatë hetimit dhe deklaratimeve të subjektit, lidhur me pronësinë dhe çmimin e shitjes së këtij automjeti.

**9.18** Në përgjigjen e përcjellë nga DRT-ja Tiranë<sup>108</sup>, nuk evidentohet pagesa e detyrimeve tatimore për vlerën e fitimit të realizuar nga shitja e këtyre automjeteve dhe për këtë arsye vlera e fitimit të realizuar vlerësohet si e ardhur e paligjshme në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 30 të ligjit nr. 84/2016 dhe kjo vlerë i zbritet të ardhurës të arkëtuar.

---

<sup>107</sup> i cili përcakton se për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale merret si e ardhur e tatueshme çdo e ardhur tjetër e realizuar nga individë rezidentë, që nuk identifikohet në format e paraqitura në këtë nen dhe për sa kohë e ardhura e realizuar nga shitja me fitim e pasurive të luajtshme nuk bën pjesë në të ardhurat e përjashtuara nga neni 8/1 i të njëjtit ligj,

<sup>108</sup>Shkresë nr. \*\*\*, datë 28.10.2019.

**9.19 Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës,** Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: *(i) ka mospërputhje lidhur me dokumentacion e administruar gjatë hetimit dhe deklarimeve të subjektit, lidhur me pronësinë dhe çmimin e shitjes së automjetit me targa \*\*\*; (ii) ka mungesë të dokumentacionit ligjor justifikues për pagesën e tatimit mbi të ardhurat e përfituara nga shitje e këtij automjeti*

**9.20 Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet dhe provat me shkrim dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës, deklaroi** se automjeti është shitur në vlerën e parashikuar në kontratë, pra, në shumën 200.000 lekë. Ky automjet i është shitur shtetasit L.Q., (mik i subjektit) nga Pogradeci. Ky automjet i është dhënë me mirëbesim me prokurë me qëllim kalimin e pronësisë në emrin bashkëshortes, e cila nuk ka qenë e pranishme ndaj dhe nuk është lidhur menjëherë kontratë shitje. Diferenca në shumën prej 40.000 lekësh, tepër vlerës së parashikuar në kontratë ka të bëjë me pagesën e siguracionit dhe gomave nga subjekti, në momentin që L.Q., ka marrë mjetin (shpenzim jo i përfshirë në çmim), lekët janë kaluar me bankë disa ditë më pas dhe se nuk ka qenë në dijeni se cili është personi nëpërmjet të cilit kanë kaluar lekët, nëse është punonjës banke apo ndonjë i njohuri i tij.

**9.21** Në lidhje me diferencën e çmimit të blerjes me atë të shitjes së këtij automjeti, në vlerën 56.000 lekë, subjekti deklaroi se nuk kam pasur detyrimin për të plotësuar deklaratën dhe në të njëjtën kohë nuk kam pasur detyrimin për të paguar tatimin për fitimin e realizuar nga shitja e automjetit.

### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**9.22** Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në “Deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, Vetting”; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratave periodike dhe provave shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

**9.23** Subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm mospërputhjet që ekzistonin midis dokumentacionit të administruar nga hetimi dhe deklarimeve në ILDKPKI.

**9.24** Fakti që subjekti i rivlerësimit ka përfituar të ardhura nga shitja e këtij automjeti, Komisioni në vlerësim të parashikimeve të germës “g”, të pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar<sup>109</sup>, dhe për sa kohë nuk u provua pagimi i detyrimit tatimor mbi këtë fitim, vlera e fitimit të realizuar vlerësohet si e ardhur e paligjshme në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, bazuar kjo edhe në jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

---

<sup>109</sup> Ku përcaktohet se për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale merret si e ardhur e tatueshme çdo e ardhur tjetër e realizuar nga individë rezidentë, që nuk identifikohet në format e paraqitura në këtë nen dhe për sa kohë e ardhura e realizuar nga shitja me fitim e pasurive të luajtshme nuk bën pjesë në të ardhurat e përjashtuara nga neni 8/1 i të njëjtit ligj.

**9.25 Si konkluzion**, këto të ardhura nuk u morën në konsideratë si e ardhur e ligjshme për efekt të analizës financiare të viti 2014.

## **10. Analiza financiare**

**10.1.** Komisioni kreu analizën për periudhën 2014 – 2017, duke marrë në konsideratë pasuritë, të ardhurat, detyrimet dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur, nga ku përveç konkluzioneve të arritura në arsyetimin më lart, rezultoi se për vitin 2015 ka mungesë burimesh financiare të ligjshme në shumën 490.051 lekë për blerjen e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve

**10.2. Nga faktet e analizuara më lart bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës**, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: *për vitin 2015, ka mungesë burimesh financiare të ligjshme në shumën 490.051 lekë për blerjen e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve.*

**10.3. Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet dhe provat me shkrim dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës, deklaroi** se në kontekstin e analizës financiare, kundërshton metodologjinë e aplikuar nga Komisioni për sa i takon shpenzimeve, për shkak të llogaritjes së tyre dy herë. Konkretisht, Komisioni i klasifikon shpenzimet e jetesës duke iu referuar raportit të ILDKPKI-së, dhe në përlllogaritjen e këtyre shpenzimeve, ILDKPKI-ja i referohet të dhënave të INSTAT-it përmbledhur në Anketën e Buxhetit të Familjes dhe në Anketën e Matjes së Nivelit të Jetesës. Referimi në këto anketa i ka shërbyer ILDKPKI-së si e dhënë orientuese në përlllogaritjen e shpenzimeve mesatare për frymë, në kushtet e mosmiratimit të minimumit jetik. Në këtë aspekt duhet bërë dallimi ndërmjet minimumit jetik (që mungon në Shqipëri) me shpenzimet mesatare mujore për frymë të evidentuara në anketat e INSTAT-it. Në këto anketa, INSTAT përlllogarit shpenzime mesatare mujore për frymë, duke përfshirë shpenzime për ushqim, për veshje, për banesë, për ujë, për energji elektrike, për restorante dhe hotele, për qira, për mobilim, për pajisje shtëpiake, për mirëmbajtjen e zakonshme të banesës, për shëndet, për transport, për komunikim, për arsim, për argëtim etj. Pavarësisht përfshirjes së shpenzimeve për jetesë të përlllogaritura nga ILDKPKI-ja sipas zërave, të njëjta zëra Komisioni i llogarit edhe një herë më vete. Pavarësisht metodologjisë së Komisionit, që në vend të minimumit jetik referon në anketa, vërehet se marrja e mirëqenë e kësaj metodologjie konfirmon në rastin e subjektit të kundërtën e përfundimeve të Komisionit. Konkretisht, po të marrim si shembull vitin 2015, sipas metodologjisë së bazuar në anketa, shpenzimet e jetesës për familjen sipas anketave për një familje janë maksimalisht në vlerën 897.104 lekë. Shpenzimet e familjes së subjektit rezultojnë në vlerën 1.519.905 lekë, gati dy herë më të larta se të anketës. Në këtë kontekst, mbetet i paqartë përfundimi i Komisionit, mbi balancën negative të vitit 2015, edhe pse shpenzimet e përgjithshme dhe shpenzimet për frymë për këtë vit nuk rezultojnë më të ulëta se shpenzimi mesatar për frymë, ku referon ILDKPKI dhe Komisioni.

**Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**10.4.** Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në “Deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, Vetting”; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratave periodike dhe provave shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

**10.5.** Komisioni vë në dukje se, së bashku me relacionin mbi rezultatet e hetimit kryesisht, subjektit i është vënë në dispozicion edhe: (i) aneks 01 - *analiza financiare e detajuar*, ku janë paraqitur zërat e detajuar e të ardhurave, shpenzimeve, pasurive për secilën periudhë të marrë në analizë; (ii) aneks 02 – *metodika e analizës financiare*, ku është shpjeguar mënyra e përlllogaritjes të secilit zë të analizës financiare; si dhe (iii) aneks 03 – *tabela e detajuar e shpenzimeve të udhëtimit jashtë vendit*, ku është pasqyruar kostoja e përlllogaritur për secilin udhëtim. Konkretisht, referuar analizës financiare të vitit 2015, të ardhurat e subjektit dhe bashkëshortes kanë qenë në shumën 1.623.530 lekë; shpenzime totale në shumën 1.519.905 lekë (*përbërë nga shpenzime jetese sipas ILDKPKI (INSTAT) në shumën 897.104 lekë, shpenzime për pagesën e kredisë në “Alpha Bank”, në shumën 265.426 lekë; shpenzime për udhëtime nga sistemi TIMS në shumën 325.0256 lekë dhe shpenzime për automjete TPL në shumën 32.320 lekë*); shtesë e llogarive bankare në shumën 143.676 lekë<sup>110</sup>; si dhe shtesë e kursimeve *cash* në shumën 450.000 lekë si kursime nga pagat.

**10.6.** Për sa më sipër, diferenca midis të ardhurave dhe shpenzimeve është në shumën 103.625 lekë, e pamjaftueshme për të mbuluar me burime të ligjshme shtesën e kursimeve prej 593.676 lekësh, duke rezultuar kështu në një balancë negative në vlerën 490.051 lekë, për të cilën subjekti nuk paraqiti shpjegime konkrete në përgjigje të barrës së provës.

**10.7.** Lidhur me pretendimin rreth metodologjisë së përdorur në analizën financiare ku përlllogariten dy herë disa shpenzime, Komisioni çmon të theksojë se shpenzimet e përlllogaritura në zërin “shpenzime jetese sipas ILDKPKI (INSTAT)” janë shpenzime minimale. Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës përlllogarit shpenzime e minimumit jetik<sup>111</sup>, ndërkohë që për vitin 2007 dhe periudhës 2014 – 2018, të cilat mbështeten në Anketën e Buxhetit të Familjes, shpenzimet me peshën kryesore, pas zërit “ Shpenzime jetese sipas ILDKPKI (INSTAT), kanë të bëjnë me: (i) pagesën e kredive, zë i cili nuk përfshihet në anketa; (ii) shpenzimet e udhëtimit vendbanim - vendi i punës, të deklaruara nga vetë subjekti; (iii) shpenzime për udhëtime nga sistemi TIMS, shpenzim i cili në pjesën me të madhe është bazuar në deklaratimet e subjektit; dhe (iv) shpenzimet për automjetet (primi TPL), zë i cili nuk përfshihet në anketa.

**10.8.** Lidhur me pikat (ii) dhe (iii), vlerat e deklaruara nga subjekti, të cilat vlerësohet të jenë pranë vlerës faktike të shpenzuar, janë shumë herë më të larta së përqindja që zë zëri

---

<sup>110</sup> Diferenca midis gjendjes së llogarive bankare të subjektit dhe bashkëshortes në datë 31.12.2015 (24.406 lekë) me gjendjen e datës 31.12.2014 (-119.271 lekë).

<sup>111</sup> Referuar publikimit të INSTAT, ANKETA E MATJES SE NIVELIT TE JETESES – LSMS2002, Manuali i Anketuesit: “Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës (LSMS) do të kryhet në kuadrin e monitorimit të vazhdueshëm të varfërisë dhe krijimit të një sistemi të vlerësimit të politikave në kontekstin e Strategjisë së Qeverisë Shqiptare për Rritjen ekonomike dhe Reduktimin e Varfërisë”.

“transport” në peshën e shpenzimeve jetike dhe, për rrjedhojë, nuk mund të mos konsideroheshin në analizën financiare të subjektit.

**10.9.** Në vijim të arsytimit më lart, subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për kryerjen e shpenzimeve, blerjen e pasurive dhe për dhënien e huas, duke rezultuar me një mungesë burimesh të ligjshme në vlerën -490.051 lekë për vitin 2015, duke u gjendur në kushtet e parashikimit të germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

**10.10.** Lidhur me analizën financiare të vitit 2017 dhe 2018, bazuar në të cilën rezultuan balanca negative vjetore për kryerjen e shpenzimeve dhe blerjen e pasurive, konkretisht vlera negative -892.421 lekë për vitin 2017 dhe -276.048 lekë për vitin 2018, për të cilat subjekti i rivlerësimit kërkoi që të mos analizohen në vendimmarrje, fakte që kanë të bëjnë me të dhënat e pasurisë së subjektit pas deklaratës *Vetting*, Komisioni vlerëson se analiza financiare e këtyre viteve shërben për të krijuar një panoramë më të plotë dhe më të qartë të mundësive financiare të subjektit për të përballuar me burime të ligjshme financiare kryerjen e shpenzimeve dhe shtesën e kursimeve ndër vite.

**10.11. Në përfundim** të vlerësimit të kriterit të pasurisë, bazuar në konkluzionet për çdo pasuri, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe gjendet në kushtet e parashikuara në pikën 3 të nenit 61.

## **B. VLERËSIMI I FIGURËS**

**1.1** Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, si dhe ka dërguar raportin e arsyetuar nr. \*\*\*, datë 19.12.2019, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 27.12.2019, të K.D.Zh-së, duke konkluduar mbi “*papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Arben Allajbeu*”.

**1.2** Në këtë raport, përveç të tjerave, për subjektin e rivlerësimit, z. Arben Allajbeu, disponoheshin të dhëna në bazë të të cilave kishte dyshime në përfshirjen e subjektit në veprimtari të korrupsionit pasiv të prokurorit dhe ushtrimit të ndikimit të paligjshëm, gjatë ushtrimit të detyrës si prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Berat. Ka pasur kontakte të papërshtatshme, në vitet 2016 dhe 2018, me një person mbi të cilin kishte dyshime serioze për përfshirjen e tij në trafikun ndërkombëtar të lëndëve narkotike.

**1.3** Në vijim të informacioneve të mësipërme, në bazë të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në bashkëpunim me ONM-në, ka kryer disa aksese në dokumentacionin e klasifikuar të zotëruar nga institucionet verifikuese, për t’i studiuar, si dhe për të verifikuar bazueshmërinë e konkluzioneve në të cilat kishin arritur raportet e sipërpërmendura.



**1.4** Referuar *indicieve* të përcjella, Komisioni i është drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme<sup>112</sup> dhe Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda<sup>113</sup>, nëse në ngarkim të subjektit ka të regjistruar procedime penale, mosfillim ose pushim. Më tej, është hetuar dhe janë administruar procedime penale në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës<sup>114</sup>, Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat<sup>115</sup>, si dhe Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>116</sup>.

**1.5** Subjekti i rivlerësimit, gjithashtu, dha shpjegimet e tij në lidhje me konstatimin e DSIK-së dhe informacionin e administruar nga hetimit i Komisionit.

**1.6** Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e kontrollit të figurës; (ii) raportin e hollësishëm të DSIK-së; (iii) aksesin pranë organeve verifikuese të këtij informacioni; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe gjatë seancës dëgjimore, vlerëson se:

**1.7** Konstatimi i DSIK-së për papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës, nuk lidhet me saktësinë dhe vërtetësinë e plotësimit të deklaratës së figurës, pasi nga rrethanat e konstatuara, nuk rezulton të ketë bërë deklaram të pamjaftueshëm, sipas parashikimeve të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016.

**1.8** Në lidhje me kontaktin e papërshtatshëm, Komisioni nuk vërtetoi që subjekti i rivlerësimit të ketë apo të ketë pasur në mënyrë të drejtpërdrejtë apo indirekte kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar në krimin e organizuar, si dhe nuk u arrit të vërtetohet përfshirja e tij në veprimtari korruptive gjatë ushtrimit të detyrës.

**1.9** Trupi gjykues i Komisionit vlerëson se konstatimi i DSIK-së për papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës, nuk lidhet me saktësinë dhe vërtetësinë e plotësimit të deklaratës së figurës, pasi nga rrethanat e konstatuara nga Grupi i Punës së DSIK-së dhe nga Komisioni për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, nuk rezulton të ketë bërë deklaram të pamjaftueshëm, sipas parashikimeve të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016.

**1.10** Në përfundim, trupi gjykues i Komisionit vlerëson se nuk u provua që subjekti i rivlerësimit të jetë në kushtet e nenit 61, pikat 2 apo 3, të ligjit nr. 84/2016 dhe për këtë arsye vlerëson se ka kryer deklaram të saktë në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, nuk ka kontakte të papërshtatshme dhe subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm për kriterin e kontrollit të figurës.

## **C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

Sipas nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, relatori përgatit relacionin për vlerësimin e aftësive profesionale mbështetur në raportin e inspektorëve, informacionin e marrë nga burime të tjera,

---

<sup>112</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 5.6.2020.

<sup>113</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 21.10.2020.

<sup>114</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 2.10.2020.

<sup>115</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 2.10.2020.

<sup>116</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 21.10.2020.

si dhe në kriteret e vlerësimit, të parashikuara në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve dhe akteve e tjera ligjore.

## **1. Raporti i Këshillit të Lartë të Prokurorisë**

**1.1.** Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në rregulloren “Për vlerësimin etik e profesional të subjekteve në proces rivlerësimi”, ka miratuar këtë raport të hollësishëm dhe të arsyetuar të përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike për përshkrimin dhe analizën e dokumenteve të vlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit, z. Arben Allajbeu, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat. Ky raport ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit: (a) aftësitë profesionale; (b) aftësitë organizative; (c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; dhe (ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

**1.2.** Bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave dhe dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; (ii) pesë dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhëna nga burimet arkivore të Drejtorisë së Menaxhimit të Dokumentacionit, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse në Prokurorinë e Përgjithshme.

**1.3.** Në lidhje me saktësinë dhe afatin e dërgimit të Formularit të Vetëdeklarimit sipas nenit 41 të ligjit nr. 84/2016 – subjekti i rivlerësimit, z. Arben Allajbeu, në datën 26.1.2017, ka paraqitur në Prokurorinë e Përgjithshme formularin dhe dokumentet shoqëruese, nënshkruar dhe plotësuar sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Nuk rezulton të ketë mangësi nga pikëpamja formale. Subjekti ka deklaruar të dhënat duke referuar si periudhë të rivlerësimit 1.1.2014 - 31.12.2016.

**1.4.** Përvoja profesionale në 10 vitet e fundit - subjekti i rivlerësimit, z. Arben Allajbeu, në periudhën qershor 2014 – korrik 2015, ushtron funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, në periudhën korrik 2015 – janar 2016, ushtron funksionin e drejtuesit të komanduar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, në periudhën janar 2016 – nëntor 2016, ushtron funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, në periudhën nëntor 2016 e në vazhdim ushtron funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

## **2. Analiza e Komisionit**

**2.1.** Lidhur me kriteret e vlerësimit profesional sipas përcaktimeve të ligjit nr. 96/2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, tregon korrektësi në zbatimin e ligjit. Në tri aktet procedurale ligjore të paraqitura prej tij dhe në pesë dosjet e vëzhguara sipas shortit, është konstatuar se subjekti i rivlerësimit identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Për sa i përket vlerësimit në aspektin profesional, rezulton se ka shfaqur aftësi në interpretimin e ligjit, analizën e jurisprudencës dhe arsyetimit ligjor e logjik, duke marrë vendime dhe përpiluar akte të qarta dhe të plota. Gjithashtu, ka marrë pjesë në aktivitete profesionale për ngritjen e nivelit të tij profesional.

**2.2.** Bazuar në aktet e dorëzuara dhe në dosjet e shortuara, konstatohet se subjekti i rivlerësimit shfaq aftësi në pasqyrimin e rrethanave të faktit, analizën e provave dhe ballafaqimin e tyre me bazën ligjore të aplikueshme. Aktet e përpiluara prej tij paraqiten të qarta dhe të kuptueshme, niveli i arsytimit të vendimeve të vëzhguara është në përputhje me standardin e procesit të rregullt ligjor.

**2.3.** Referuar vërtetimit nr. \*\*\* prot., datë 19.11.2019, si dhe listës së statistikave, vënë në dispozicion të Komisionit në procedurën e shortimit të dosjeve, rezulton se nga subjekti i rivlerësimit janë trajtuar 361 çështje. Duke pasur parasysh statistikën e ngarkesës së punës, si dhe natyrën e çështjeve, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, është përballur me një ngarkesë të konsiderueshme pune duke treguar eficiencë në marrjen e vendimeve brenda një afati të arsyeshëm, referuar natyrës dhe shumëllojshmërisë së veprimeve hetimore.

**2.4.** Në rastin e vendimmarrjes mbi mosfillimin e procedimit penal, rezulton të ketë argumentuar mungesën e elementëve të veprës penale. Në procedimet penale për të cilat është vendosur pushimi i hetimeve, është realizuar drejtimi i hetimeve të kryera nga policia gjyqësore duke argumentuar vendimmarrjen për pushimin e procedimeve penale. Gjithashtu, ka shfaqur aftësitë e nevojshme edhe mbi kontrollin e hetimeve të kryera nga policia gjyqësore për të mbështetur akuzën në çështjet me të pandehur të dërguar për gjykim.

**2.5.** Nga vëzhgimi i akteve të analizuara, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka aftësi për të administruar dosjet dhe nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit.

**2.6.** Referuar të dhënave nga burimet arkivore të Drejtorisë së Menaxhimit të Dokumentacionit, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse pranë Prokurorisë së Përgjithshme, rezultoi se ndaj subjektit të rivlerësimit nuk janë marrë masa disiplinore. Në vlerësimet e punës të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, subjekti i rivlerësimit, për vitet 2014 dhe 2016, është vlerësuar në masën “shumë mirë”, mbështetur në treguesit vjetorë të punës.

**2.7.** Nga hetimi pranë strukturave përkatëse të Prokurorisë së Përgjithshme dhe të gjitha Prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë, rezultoi se në Prokurorinë e Përgjithshme është regjistruar praktika nr. \*\*\*, mbi bazën e ankesës së shtetasit P.Sh.

**2.8.** Komisioni hetoi lidhur me këtë ankesë dhe pas administrimit të dosjes së procedimit penal, rezultoi se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, mbi bazën e kallëzimit të shtetasit P.Sh., ka regjistruar procedimin penal për veprën penale “shpërdorim detyre” parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Subjekti i rivlerësimit, në datën 24.7.2017, ka vendosur “pushimin e çështjes penale nr. \*\*\*, e vitit 2017”, për veprën penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Mbi bazën e ankimit të ushtruar nga shtetasi P.Sh., Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 24.10.2017, ka vendosur prishjen e pushimit të vendimit për të kaluar në hetime më të thella, ndërkohë që subjekti e ka apeluar çështjen në Gjykatën e Apelit Tiranë.

**2.9.** Për sa më lart, Komisioni kërkoi shpjegime nga subjekti i rivlerësimit, i cili pasi u njoh me rezultatet e hetimit, ndër të tjera, deklaroi se ndaj vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, ndërkohë që nga kallëzuesi janë paraqitur disa ankesa, sipas të cilave subjekti është ndjerë i paragjykuar në ushtrimin e funksionit të tij. Në këto kushte, për të ruajtur figurën e prokurorit, për të respektuar parimin e

objektivitetit dhe paanësisë edhe në dukje në perceptimin e palëve në procedim, subjekti shpjegoi se ka vlerësuar me ndërgjegje se nuk duhet të ishte pjesë e vazhdimësisë së hetimit në këtë procedim penal në mënyrë që palët të mos perceptonin se procedimi penal po hetohej sipas një mendimi të paracaktuar. Pavarësisht se pas kthimit të çështjes nga Gjykata e Apelit, subjekti do të vijonte kryerjen e veprimeve hetimore të urdhëruara dhe vlerësimin tërësisht ligjor dhe objektiv të tyre. Kërkesa për heqje dorë, mbi argumentet e parashtruara, është pranuar dhe miratuar nga drejtuesi i prokurorisë. Subjekti në prapësime paraqiti vendimin nr. \*\*\*, datë vendimi 10.6.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nga ku rezulton se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka kërkuar pushimin e procedimit penal me argumentin se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Kjo kërkesë është gjetur e bazuar në ligj dhe është pranuar nga gjykata me të njëjtin argument. Pala e dëmtuar, kallëzuesi P.Sh., nuk ka ushtruar ankim dhe vendimi ka marrë formë të prerë në datën 27.6.2019.

**2.10.** Trupi gjykues konstaton se mosveprimi i subjektit të rivlerësimit pas dhënies së vendimeve gjyqësore që e urdhëronin atë të fillonte hetimet për materialin kallëzues të ankuesit, nëpërmjet heqjes dorë nga çështja për arsye tërësisht subjektive, të pambështetura në ligj, tregon mungesë angazhimi profesional, mosrespektim të autoritetit gjyqësor nga ana e subjektit të rivlerësimit, ndërkohë që urdhërimi i gjykatës për çështje të kësaj natyre është i detyrueshëm për prokurorin, mosrespektim të të drejtave të qytetarëve kallëzues, duke sjellë si pasojë zvarritjen e hetimit të çështjes, si dhe cenim të etikës dhe mosangazhim ndaj vlerave profesionale. Gjithsesi, problematika e këtij rasti nuk është e mjaftueshme për ta klasifikuar subjektin e rivlerësimit me “mangësi profesionale”, sipas nenit 44, pika b e ligjit nr. 84/2016.

### **3. Gjetjet nga shqyrtimi i dosjeve të shortuara**

**3.1.** Lidhur me procedimi penal nr. \*\*\*, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, me datë regjistrimi 15.6.2015, regjistruar për veprën penale “plagosje e rëndë me dashje, kryer në bashkëpunim”, parashikuar nga nenet 89 e 25 të Kodit Penal.

**3.2.** Nga hetimi i Komisionit, rezulton se subjekti i rivlerësimit në datën 15.9.2015, ka vendosur zgjatjen e afatit hetimor, duke konkluduar se për kryerjen e veprimeve hetimore të mëtejshme, është e nevojshme zgjatja e afatit të hetimeve për një periudhë kohe prej 2 muaj. Nga analizimi i dosjes nuk evidentohet të jenë njoftuar palët për zgjatjen e afatit të hetimeve, gjë që bie ndesh me parashikimet e pikës 3, të nenit 324, të Kodit të Procedurës Penale, ku përcaktohet se vendimi për zgjatjen e afatit të hetimeve u njoftohet të pandehurit dhe të dëmtuarit. Në nenin 34 përcaktohet se: *“Dispozitat, që zbatohen për të pandehurin, zbatohen edhe për personin nën hetim, me përjashtim të rasteve kur ky Kod parashikon ndryshe”*.

**3.3.** Komisioni vëren se në rast të shkeljeve procedurale dhe mos njoftimit të zgjatjes së afatit të hetimit referuar nenit 325 të Kodit të Procedurës Penale, personit nën hetim apo të dëmtuarit i mohohet e drejta që brenda dhjetë ditëve nga njoftimi, të bëjnë ankim në gjykatën e rrethit kundër vendimit të prokurorit për zgjatjen e afatit të hetimeve. Kur gjykata pranon ankesën, hetimet nuk mund të vazhdojnë ose vazhdojnë vetëm për një afat të caktuar nga gjykata. Provat e marra pas mbarimit të afatit nuk mund të përdoren.

**3.4.** Për sa më lart, Komisioni kërkoi shpjegime nga subjekti i rivlerësimit, i cili pasi u njoh me rezultatet e hetimit deklaroi se vendimi për zgjatjen e afatit të hetimit në datën 15.9.2015 është

nënshkruar vetëm nga dy prej subjekteve të këtij procedimi penal. Lidhur me konstatimin e Komisionit për mosnjoftimin e vendimit për zgjatjen e afatit të hetimit janë respektuar parashikimet pikave 1 dhe 2, të nenit 324, të Kodit të Procedurës Penale (sipas formulimit të dispozitës në fuqi në kohën e procedimit) dhe arsyet e zgjatjes së afatit janë pasqyruar dhe argumentuar në vendimin përkatës të administruar në dosje. Lidhur me njoftimin e vendimit të të dëmtuarit dhe të gjithë personave ndaj të cilëve zhvilloheshin hetime, referuar akteve të ndodhura në dosjen hetimore, konstatimi i Komisionit është i drejtë në lidhje me faktin se në dosje nuk administrohen aktet e njoftimit për të gjithë subjektet. Në momentin e disponimit për zgjatjen e afatit të hetimit, subjekti deklaroi se ka urdhëruar oficerin e policisë gjyqësore për njoftimin e vendimit të zgjatjes së afatit për të gjithë personat nën hetim dhe të dëmtuarit. Duke qenë se vetëm pak ditë (2 ditë) nga marrja e vendimit për zgjatjen e afatit të hetimit i dëmtuari ka paraqitur heqjen dorë nga ankimi, veprim i cili sjell si pasojë pushimin e procedimit penal në referim germës “c”, të nenit 328/1, të Kodit të Procedurës Penale, është disponuar për pushimin e procedimit penal, si pasojë e drejtpërdrejtë e heqjes dorë nga ankimi në raport me veprën për të cilën procedohej. Mos administrimi i njoftimeve/nënshkrimeve të të gjithë subjekteve të procedimit për vendimin e zgjatjes së afatit të hetimit në dosjen hetimore, është një mungesë e kujdesit maksimal për shkak të volumit të punës, por në rastin konkret nuk ka sjellë asnjë pasojë për procedimin apo për të drejtat e palëve në procedim deklaroi subjekti, pasi asnjë prej tyre nuk ka pasur kundërshtime apo ushtruar ankim qoftë mbi vendimin për zgjatjen e afatit të hetimit për të cilin ka ardhur në dijeni në momentin e njoftimit për pushimin e hetimeve, qoftë për vendimin e pushimit të procedimit të marrë pas zgjatjes së afatit të hetimit.

**3.5.** Në përfundim të analizimit të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se mos njoftimi i personit nën hetim dhe të dëmtuarin mbi zgjatjen e afatit të hetimeve, në kundërshtim me parashikimet e pikës 3, të nenit 324, të Kodit të Procedurës Penale, duke u mohuar të drejtën e ankimit ndaj vendimit të prokurorisë, nuk përbën shkak autonom për shkarkimin e subjektit të vlerësimit.

**3.6.** Lidhur me procedimi penal nr. \*\*\*, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, regjistruar për veprën penale “ndërtimi paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal.

**3.7.** Nga hetimi i Komisionit, rezulton se subjekti i rivlerësimit në datën 7.7.2016, ka vendosur zgjatjen e afatit hetimor me 3 muaj, duke konkluduar se rezultoni e domosdoshme kryerja edhe e veprimeve të tjera hetimore (administrimi i aktit të ekspertimit teknik dhe në varësi të tij kryerja e veprimeve të tjera hetimore). Nga analizimi i dosjes nuk evidentohet të jetë njoftuar personi nën hetim për zgjatjen e afatit të hetimeve, gjë që bie ndesh me parashikimet e pikës 3, të nenit 324, të Kodit të Procedurës Penale ku përcaktohet se vendimi për zgjatjen e afatit të hetimeve u njoftohet të pandehurit dhe të dëmtuarit. Në nenin 34 përcaktohet se: *“Dispozitat, që zbatohen për të pandehurin, zbatohen edhe për personin nën hetim, me përjashtim të rasteve kur ky Kod parashikon ndryshe”*.

**3.8.** Komisioni vëren se në rast të shkeljeve procedurale dhe mos njoftimit të zgjatjes së afatit të hetimit referuar nenit 325 të Kodit të Procedurës Penale, personit nën hetim apo të dëmtuarit i mohohet e drejta që brenda dhjetë ditëve nga njoftimi, të bëjnë ankim në gjykatën e rrethit kundër vendimit të prokurorit për zgjatjen e afatit të hetimeve. Kur gjykata pranon ankesën,

hetimet nuk mund të vazhdojnë ose vazhdojnë vetëm për një afat të caktuar nga gjykata. Provat e marra pas mbarimit të afatit nuk mund të përdoren.

**3.9.** Për sa më lart, Komisioni kërkoi shpjegime nga subjekti i rivlerësimit, i cili pasi u njoh me rezultatet e hetimit deklaroi se vendimi për zgjatjen e afatit të hetimit në datën 7.7.2016 është marrë për shkaqe tërësisht të përligjura në respektim pikave 1 dhe 2, të nenit 324, të Kodit të Procedurës Penale (sipas formulimit të dispozitës në fuqi në kohën e procedimit), duke pasqyruar dhe analizuar arsyet e zgjatjes së afatit për shkak të domosdoshmërisë së administrimit të aktit të ekspertimit teknik, provë e domosdoshme në rastet e veprës për të cilën procedohej. Lidhur me njoftimin e vendimit për personin ndaj të cilit zhvillohen hetime, referuar akteve të ndodhura në dosjen hetimore, konstatimi i Komisionit është i drejtë në lidhje me faktin që në dosje nuk administrohet marrja e njoftimit për vendimin e zgjatjes së afatit nga personi nën hetim. Subjekti sqaron se në momentin e disponimit për zgjatjen e afatit të hetimit është urdhëruar oficeri i policisë gjyqësore për njoftimin e vendimit të zgjatjes për personin nën hetim, dhe se nuk është treguar kujdesi i duhur për të ndjekur procedurën e zbatimit të urdhërimit të prokurorit nga ana e oficerit të policisë gjyqësore për njoftimin e vendimit. Mosadministrimi i njoftimit/nënshkrimit për marrjen dijani për vendimin e zgjatjes në rastin konkret nuk ka sjellë asnjë pasojë për procedimin apo për të drejtat e palëve në procedim, pasi në momentin që personi nën hetim ka ardhur në dijani të faktit, në përfundim të hetimit nëpërmjet vendimit të pushimit të këtij procedimi penal, nuk ka shfaqur pretendime dhe as ka ushtruar ankim si ndaj vendimit të zgjatjes së afatit të hetimit ashtu edhe ndaj vendimit të pushimit të procedimit penal.

**3.10.** Në përfundim të analizimit të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se mos njoftimi i personit nën hetim mbi zgjatjen e afatit të hetimeve, në kundërshtim me parashikimet e pikës 3, të nenit 324, të Kodit të Procedurës Penale nuk përbën shkak autonom për shkarkimin e tij.

#### **4. Denoncimet nga publiku**

**4.1.** Në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Arben Allajbeu, është administruar 1 denoncim nga publiku me nr. \*\*\* prot., datë 4.7.2019, i një shtetasi, i cili kërkon të mbetet anonim. Ky denoncues e akuzon subjektin për korrupsion dhe fshehje të pasurive, të regjistruara në emër të të afërmeve të tij. Më konkretisht, denoncuesi shprehet se: *“Arben Allajbeu ka qenë prokuror i rrethit Berat. Gjatë kohës që është bërë kryeprokuror i komanduar në rrethin Berat në 2014, ka ndërtuar dy kate të shtëpisë së tij në emër të babait të tij B.A., pa leje dhe kjo çështje është mbyllur shumë lehtë nga ai dhe kolegët e tij. Si ka mundësi që në si qytetar nuk bëjmë dot një gjysëm dhomë pa leje. Po ashtu, Arben Allajbeu, në vitin 2015 ka blerë shtëpi në emër të vëllait të gruas së tij në Berat dhe shtëpi në Berat në emër të kumatit dhe motrës së tij në Berat. Në vitin 2016, Arben Allajbeu ka marrë emërimin si prokuror në Tiranë dhe po atë vit ai ka blerë shtëpi me sip. 100 m<sup>2</sup> në emër të vjehrrës së tij në Tiranë, si ka mundësi këto prona në 2-4 vite pune si prokuror. Po atë vit, ka kërkuar të shkojë në prokurorinë e Durrësit ku dhe është aktualisht si i komanduar, pasi ka mbështetje nga ish-kryeprokurori P., që është djali i tezes së burrit të motrës. Po në Durrës, me ndihmën e këtij ish-prokurori ka blerë shtëpi atje në emër të kumatit dhe motrës së tij. Këtë vit ka ngritur*

*shtëpinë në fshatin P., të Beratit dhe po këtë vit ka blerë një garazh në pallatin ku ka shtëpinë e tij në emër të së vjehrrës. Disponon dhe 4 makina në emër të afërmve të tij. Ky është prokurori transparent me kaq shumë prona. Po këtë ankesë e kam dërguar dhe në Kryeministri të dokumentuar me materialet përkatëse. Kancelarinë që mbajnë të hapur në emër të babait të tij e bëjnë për të pastruar paratë”.*

**4.2.** Për sa më sipër, bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni verifikoi nëse informacioni është dhënë nga një person i njohur ose anonim dhe çmoi se pretendimet e paraqitura në denoncim përmbajnë shkaqe të mjaftueshme për fillimin e hetimit kryesisht. Më tej, hetoi lidhur me *indiciet* për apartamentin e ndodhur në Rr. “\*\*\*”, Tiranë, regjistruar në emër të vjehrrës së subjektit, si dhe ndërtimin e katit shtesë në apartamentin e prindërve të subjektit në qytetin e Beratit, dhe doli në konkluzionet dhe faktet e shtjelluara në pikën 5 dhe 10 të relacionit.

**4.3.** Nga hetimi i Komisionit pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat, rezultoi se sikundër është përmendur në denoncim, babai i subjektit, z. B.A., ka kryer një ndërtim, shtesë kati, në lagjen “\*\*\*”, Berat, pa qenë i pajisur me leje ndërtimi, fakt ky i referuar nga Policia Gjyqësore e Komisariatit Berat. Prokuroria ka regjistruar procedimin penal nr. \*\*\*, datë 3.11.2014, për veprën penale “ndërtim i paligjshëm”, të parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal.

**4.4.** Referuar materialit të administruar nga kjo prokurori, në deklaratimet e tij z. B.A., ka shpjeguar se ka në pronësi një ndërtesë dykatëshe dhe për ndërtimin e katit të tretë nuk ka qenë i pajisur me leje ndërtimi, por pasi ka kryer këtë ndërtim, ka aplikuar për legalizim. Nga informacioni i marrë riga ZVRPP-ja Berat, verifikohet se shtetasi B.A., është pronar i kësaj pasurie me nr. \*\*\*, në zonën kadastrale \*\*\*, lagja “\*\*\*”, Berat. Me qëllim përcaktimin e rrethanave të faktit që kanë të bëjnë me pronën ku është kryer ndërtimi dhe kohën e kryerjes së tij, është vendosur kryerja e ekspertimit teknik, ku konkludohet se shtetasi B.A., ka ndërtuar një shtesë kati, mbi kat ekzistues në pronën e tij dhe se ka 1.5-2 vjet që e ka ndërtuar këtë shtesë kati. Pra, në rastin konkret provohet se z. B.A., ka konsumuar figurën e veprës penale “ndërtimi i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a/1 i Kodit Penal, me ndërtimin e kryer në vitin 2013.

**4.5.** Sipas prokurorisë në datën 10.4.2014, ka hyrë në fuqi ligji nr. 22/2014 “Për dhënie amnistie”. Ky ligj në nenin 5, “Kushtet për dhënien e amnistisë nga ndjekja penale”, parashikon se: *“Amnistohen nga ndjekja penale të gjithë personat të cilët deri në datën 31 dhjetor 2013, kanë kryer vepra penale, të cilat parashikojnë një dënim në maksimum deri në dy vjet burgim ose çdo lloj dënimi tjetër më të lehtë, me përjashtim të veprave të parashikuara në pikën 2 të nenit 6 të këtij ligji”.* Më tej, në nenin 6 përcaktohet se: *“Nuk përfitojnë nga parashikimet e nenit 5 të këtij ligji personat që kanë kryer vepra penale të parashikuara nga paragrafi i parë i nenit 137, neni 182, neni 197, paragrafi i parë i nenit 197/a, paragrafi i parë i nenit 235, paragrafi i parë i nenit 236 dhe 291 të Kodit Penal , neni 199/a i Kodit Penal, “ndërtimi i paligjshëm”, në paragrafin e parë parashikon se: “Ndërtimi i paligjshëm i një objekti në tokën e vet dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit”.* Në përfundim, prokuroria shprehet se duke qenë se në rastin konkret ndodhemi para kryerjes se veprës penale “ndërtimi i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a/1 i Kodit Penal, dhe ndjekja penale për të shuhet për shkak të amnistisë, ky procedim penal duhet të pushohet.

**4.6.** Komisioni vëren se faktet e konstatuara nga ky denoncim janë analizuar në rivlerësimin e kriterit të pasurisë, ndërkohë lidhur me pretendimet e tjera të paraqitura çmohet se nuk ka *indicie* për hetime të mëtejshme.

**5.** Në **konkluzion**, trupi gjykues i Komisionit, pasi shqyrtoi kriteret e vlerësimit të aftësive profesionale, sipas përcaktimit të pikës 2, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale dhe bazuar në germën “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, konsiderohet “i aftë”, pasi ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve ose viktimave dhe është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme.

## **V. VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES**

### ✓ **Për vlerësimin e pasurisë**

Komisioni, bazuar në provat që disponon, në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe bindjen e brendshme, çmon se faktet në lidhje me kriterin e pasurisë nuk të krijojnë bindjen se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë pasuritë dhe ligjshmërinë e burimit të krijimit, për arsye se:

- 1. Për apartamentin me sip. 64 m<sup>2</sup>, në Durrës, në vlerën 15.000 euro** – subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklarimit të pasaktë të burimit të krijimit të kësaj pasurie në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, brenda parashikimeve të germës “a”, të pikës 5, të nenit 33, dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për blerjen e këtij apartamenti në datën 12.9.2007, duke u gjendur brenda parashikimeve germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016
- 2. Për huadhënien motrës, znj. A.P., në vlerën 10.000 euro** – subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për krijimin e shumës 10.000 euro, dhënë hua motrës në vitin 2014, duke u gjendur në parashikimet e germës “b”, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
- 3. Për të ardhurat e përdorura për huadhënie prindërve, në shumën 7.000 euro** – subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për dhënien e huas në shumën 7.000 euro në vitin 2016, duke u gjendur në këto kushte në parashikimet e germës “b”, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar dhënien e huas në vlerën 7.000 euro në vitin 2016
- 4. Për apartamentin në përdorim prej subjektit në Tiranë** – subjekti i rivlerësimit nuk arriti t’i provojë trupit gjykues të kundërtën e rezultateve të hetimit, duke pasur parasysh se subjekti i rivlerësimit nuk provoi se: (i) marrëdhënien e vjehrrës dhe kunatit të tij me apartamentin; (ii) burimet e ligjshme financiare të vjehrrës dhe kunatit për blerjen e këtij apartamenti; si dhe (iii) nevojën e vjehrrës dhe kunatit për të kryer këtë investim në Tiranë, duke u gjendur në parashikimet e pikës 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.
- 5. Për përdorimi i katit të dytë të banesës së prindërve në lagjen “\*\*\*\*”, Berat** – subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin, apartamentin në përdorim në katin e dytë të banesës së prindërve dhe personat e tjerë të lidhur/prindërit kanë mungesë të



burimeve financiare të ligjshme për ndërtimin e saj, duke u gjendur në parashikimet e germës “a” dhe “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

**6. Për analizën financiare të vitit 2015** – subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për kryerjen e shpenzimeve, blerjen e pasurive dhe për dhënien e huas, duke rezultuar me një mungesë burimesh të ligjshme në vlerën -490.051 lekë për vitin 2015, duke u gjendur në kushtet e parashikimit të germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

**7. Lidhur me analizën financiare për vitet 2017 dhe 2018** – bazuar në të cilën rezultuan balanca negative vjetore për kryerjen e shpenzimeve dhe blerjen e pasurive, konkretisht vlera negative -892.421 lekë për vitin 2017 dhe -276.048 lekë për vitin 2018, e cila shërbeu për të krijuar një panoramë më të plotë dhe më të qartë të mundësive financiare të subjektit për të përballuar me burime të ligjshme financiare kryerjen e shpenzimeve dhe shtesën e kursimeve, ndër vite, subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për kryerjen e shpenzimeve, blerjen e pasurive dhe për dhënien e huas, duke rezultuar me një mungesë burimesh të ligjshme në vlerën -490.051 lekë për vitin 2015, duke u gjendur në kushtet e parashikimit të germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

#### **Duke u gjendur në këtë mënyrë në plotësim të kushteve të parashikuara nga:**

Pika 1, e nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, parashikon se: *“Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklarimit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur”,* ndërkohë që subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë pasuritë në përdorim dhe pronësi.

Pika 3, e nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, parashikon se: *“Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj”,* ndërkohë që subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave të përmendura në këtë vendim.

Pika 5, e nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, parashikon se: *“Nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të fshehtë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën”,* ndërkohë që subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi dhe në përdorim të tij dhe është përpjekur të fshehtë këto pasuri.

Subjekti gjendet në kushtet e germave “a”, “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

#### **8. Në përfundim, të procesit të rivlerësimit:**

✓ **për kriterin e vlerësimit të pasurisë** – subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm.

✓ **Për kriterin e kontrollit të figurës** – subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm.

✓ **Për kriterin e aftësive profesionale** – subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues.

Mbështetur në konkluzionet e mësipërme, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, në kuptim të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

### **KONKLUZION PËRFUNDIMTAR**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në provat që disponon për vlerësimin e pasurisë, vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe bindjen e brendshme, vendosi që subjektit të rivlerësimit, z. Arben Allajbeu, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, t'i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neneve Ç, D, dhe Ë, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, si dhe në pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Arben Allajbeu, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 14.1.2021.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Xhensila PINE**

**Kryesuese**

**Etleda ÇIFTJA**

**Relatore**

**Pamela QIRKO**

**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*

*Olsida Goxhaj*